

REVISTA
STUDIME DEMOGRAFIKE

Nr. 1 Viti 2024

Tiranë, 2024

Botues Qendra për Studime Demografike

Kolegjiumi i redaksisë:

Msc. **Luan Shahollari** - *kryeredaktor*

Prof. Dr. **Nevruz Koçi** - *anëtar*

Prof. Dr. **Merita Xhumari** - *anëtare*

Dr. **Pasko Vako** - *anëtar*

Prof. Assoc. **Hasan Hoxha** - *anëtar*

Korrektore: Elsa Goga

Arti grafik: Edvin Ziso

Shtypi: Emal

Botimi i kësaj reviste është mbështetur nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA).

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të UNFPA-së.

Përmbajtja

SHPALLEN REZULTATET KRYESORE TË CENSIT TË POPULLSISË DHE BANESAVE 2023 NË SHQIPËRI	5
---	----------

EKUILIBRI NUMERIK I POPULLSISË, LIDHJA ME TRANZICIONIN DHE ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË SAJ ..	8
(Integrimi i popullsisë dhe zhvillimit)	

Prof. Dr. Nevruz KOÇI

lektor në Universitetin “Luarasi”, Tiranë

SFIDAT E GRUPMOSHAVE TË LARTA NË TREGUN E PUNËS NË KUSHTET E DIGJITALIZIMIT	37
--	-----------

Prof. Dr. Merita XHUMARI

Profesore e Politikave Publike, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës

meritax22@gmail.com

Lisian ROSENI, student doktrate në Shkenca Politike,

Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës

rosenilisian@gmail.com

ANALIZA E LLOGARIVE RAJONALE SI MJET PËR TË SHMANGUR THELLIMIN E SHPËRPPJESËTIMEVE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK RAJONAL	49
--	-----------

Luan SHAHOLLARI,

kryeredaktor i kolegjiut të revistës “Studime Demografike”, Tiranë

Robert ÇELO, zv/dekan i Fakultetit Ekonomik, Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër

**PRIRJE TË ZHVILLIMEVE BASHKËKOHORE SOCIO-
EKONOMIKE DHE OFERTA AKADEMIKE, SHKENCORE DHE E
SHËRBIMEVE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM NË NIVEL
RAJONAL, QENDROR DHE LOKAL..... 86**

*Prof. Dr. Irena NIKAJ, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
inikaj@unkorce.edu.al*

PROMOVIM: PASKO VAKO, NJË JETË ME STATISTIKËN 107

STATISTIKA EKONOMIKE DHE SOCIALE (SES) 109

*Dr. Pasko VAKO
Parashqevi AVDULAJ (VAKO)*

PËRVOJA JETËSORE 118

VITET E PARA TË DALJES NË JETË

STATISTIKA DEMOGRAFIKE NDËRKOMBËTARE..... 147

Renditja e vendeve në botë sipas popullsisë, 2024

**KRITERET E BOTIMIT TË REVISTËS “STUDIME
DEMOGRAFIKE” 157**

SHPALLEN REZULTATET KRYESORE TË CENSIT TË POPULLSISË DHE BANESAVE 2023 NË SHQIPËRI

Më datën 28 qershor 2024, **Instituti i Statistikave** shpalli rezultatet kryesore të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 në Shqipëri. Ky publikim -vuri në dukje Dr. Elsa Dhuli, Drejtor i përgjithshëm- do të vijojë me rishikimin e popullsisë nga viti 2011 deri në vitin 2023, si dhe projeksionet e popullsisë dhe strukturën demografike të saj në 20 vitet e ardhshme. Duke vijuar me një sërë publikimesh tematike të detajuara, si tendencat e migracionit, nivelet e arsimimit të fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimet socio-ekonomike, tipologjia e ndërtesave dhe banesave. Këto analiza do të jenë për përdoruesit një burim informacioni për të ndërtuar një të ardhme më të mirë, më të barabartë dhe të qëndrueshme për të gjithë shoqërinë.¹⁾

Në vijim po paraqesim gjetjet kryesore të censit të popullsisë dhe banesave 2023:

Popullsia

- Popullsia banuese në Republikën e Shqipërisë më 18 shtator 2023 rezultoi 2.402.113, me rënie prej 420 mijë persona, krahasuar me Censin e 2011.

- Dendësia e popullsisë së Shqipërisë është 83,6 banorë për km².

- Rënia e popullsisë ndjek trendin e konstatuar prej vitit 1990, i cili vjen si fenomen i emigracionit.

1) Censi i popullsisë dhe banesave në Shqipëri 2023 – Rezultatet kryesore. F.4.

- Raporti gjinor i popullsisë rezulton 98,2 meshkuj për 100 femra.
- Pesë në gjashtë persona të moshës njëqind vjeçare në Shqipëri janë gra. Përafërsisht, një e treta e popullsisë shqiptare (31,6 përqind) banon në qarkun e Tiranës.

Statusi martesor

- Shumica e popullsisë prej 54,9 përqind rezulton e martuar, 36.6 përqind beqar, ndërsa 7,0 përqind e popullsisë i/e ve dhe 1,4 përqind të divorcuar ose të ndarë.
- Midis popullsisë së ve, 82,3 përqind janë gra.

Migracioni

- Nga popullsia banuese gjithsej, 99,4 përqind kanë shtetësi shqiptare.
- Nga popullsia banuese gjithsej, 98,3 përqind janë të lindur në Shqipëri.
- Midis atyre të lindur jashtë vendit, afërsisht gjysma (46.2 përqind) kishin lindur në Greqi dhe 16.6 përqind në Itali.

Alfabetizmi dhe arsimi

- Shkalla e alfabetizmit për popullsinë e moshës 15 vjeç e lart është 97,7 përqind.
- Të dhënat e Censit tregojnë se 96,8 përqind e popullsisë së moshës 15 vjeç e lart kanë përfunduar ose janë duke ndjekur shkollën.
- Përqindja e femrave me arsim të lartë ka ardhur vazhdimisht në rritje, nga 41,1 përqind në Censin e 2001 në 51,0 në Censin e 2011 dhe 55,7 përqind në Censin e 2023.

Aftësia e kufizuar

- Prevalenca e aftësisë së kufizuar në popullsinë 5 vjeç e lart është 6,5 përqind.
- Prevalenca e aftësisë së kufizuar është më e lartë tek femrat (7,2 përqind) krahasuar me meshkujt (5,9 përqind).
- Nga popullsia me aftësi të kufizuar, 59,5 përqind janë të moshës 65 vjeç e lart.
- Lloji më i zakonshëm i kufizimit bazë të funksionimit i vlerësuar në Cens është vështirësia në 'Ecje ose ngjitje të shkallëve' (4,3 përqind) dhe në 'Shikim' (2,3 përqind).

Njësitë Ekonomike Familjare dhe banesat

- Numri gjithsej i NjEF është 755.950, rritur me 4,7 përqind, krahasuar me Censin 2011.

- Madhësia mesatare e NjEF është 3,2 anëtarë, krahasuar me 3,9 anëtarë për NjEF në Censin e 2011.

- Rreth një në katër NjEF - 24,3 përqind – kanë si person reference grua, personi i cili përgjithësisht merr vendimet kryesore në NjEF dhe njihet si i tillë nga të gjithë anëtarët e saj.

- Shumica e NjEF me 82,5 përqind janë pronarë të banesës ku jetojnë.

- 11,4 përqind e NjEF zotërojnë panele diellore, 8,7 pikë përqindje më shumë, krahasuar me Censin 2011.

- Përqindja e banesave të zakonshme të pabanuara është 32,9 përqind.²⁾

2) Censi i popullisë dhe banesave në Shqipëri 2023 – Rezultatet kryesore. F.13.

EKUILIBRI NUMERIK I POPULLSISE, LIDHJA ME TRANZICIONIN DHE ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË SAJ (INTEGRIMI I POPULLSISË DHE ZHVILLIMIT)

*Prof. Dr. Nevruz KOÇI,
lektor në Universitetin “Luarasi”, Tiranë*

ABSTRACT

*This paper deals with some problems of **population integration and its sustainable development**, trying to explain the relationship between population growth and sustainable economic development and the transition of its numerical development from the ancient natural balance to a balance of modern times at the end of the demographic transition of all the countries of the world.*

Just as economic and social factors affect the formation of population characteristics, the demographic structures also affect the economic trends of a country. In population structure according to age, gender, profession, branches, etc., is combined the action of a large complex factors, such as biological and socio-economic factors, depending on the level of development of each country. On the other hand, the engagement in productive activities and services of the workforce and the effective use of these resources play an important role in economic growth.

It is understandable that entire population of a country, and especially its active part, is involved in the economic and social life of the country. It is involved in both roles, as a producer of material goods and services, and as a consumer of them. In this sense, we can say that we distinguish a double role of the population, because at the same time she is both a producer and a consumer. Therefore, in the analysis of interrelationships between population and development, a special place is occupied by the analysis of structures such as the structure of the population according to working age, the structure of employment of the active population according to gender, according to productive sectors (primary and secondary), according to professions etc. This paper also deals with the stages through which population integration - development moves.

But population-development integration is also connected to another concept, which is the environment, the ecosystem. They are interdependent because a high level of development creates financial opportunities and favors a better quality of the environment. Ecosystem means resources and the space, while sociosystem means individuals and population on one hand, and on the other hand the organization of society in social, economic, cultural and technical terms. A special place in this presentation is occupied by the demographic transition, its stages and types in our country and in the world. As it is known, demographic transition means the transition from a traditional regime of demographic balance with high mortality and high birth rates to a modern balance regime with low mortality and low birth rates during the general modernization process. This is a process that the population of every country goes through. In the pre-transition period, both birth and death rates are high and generally independent of people's will. Being both high they tend to balance the demographic processes. The analysis of this problem is also related to the large numerical changes in the population in the world and the demographic balance on a national and global scale. Referring to the book of Dr. Hans Rosling "The Force of Fact", there are attempts to explain the erroneous perception of the incessant increase in the number of the population as well as the measures that should be taken to ensure a modern balance of the population.

The emphasis has been made on the extreme poverty, which produces a greater number of offspring. Therefore, the best way to keep population growth under control is to eradicate extreme poverty and improve people's quality of life by including education, education and especially increasing investments for the well-being of children. Most parents are choosing to have fewer children. This trend has spread throughout the world and has reduced child mortality everywhere.

These measures will realise the demographic transition as quickly as possible for each country, as well as on a global scale, moving the countries to new and modern population balances as well as to the overall balance of the world population, removing our "fear" from the unprecedented growth of the world's population.

PËRMBLEDHJE

Në këtë punim trajtohen disa probleme të integritit të popullsisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të saj, duke u përpjekur për të shpjeguar lidhjen e rritjes së popullsisë me zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe kalimin e zhvillimit numerik të saj nga ekuilibri natyror i lashtësisë në një ekuilibër të kohëve moderne në përfundim të tranzicionit demografik të mbarë vendeve të botës.

Ashtu si faktorët ekonomikë e socialë ndikojnë në formimin e veçorive të popullsisë, edhe strukturat demografike ndikojnë në rrjedhat ekonomike të një vendi. Në strukturën e popullsisë sipas moshës, gjinisë, profesionit, degëve etj. ndërthuret veprimi i një kompleksi të madh faktorësh, si faktorët biologjikë dhe ata socio-ekonomikë, në varësi me shkallën e zhvillimit të çdo vendi. Nga ana tjetër, angazhimi në veprimtari prodhuese e në shërbime i forcave të punës dhe përdorimi me efektivitet i këtyre burimeve luajnë rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike.

Është e kuptueshme se e gjithë popullsia e një vendi dhe sidomos pjesa aktive e saj përfshihet në jetën ekonomike e shoqërore të vendit. Ajo përfshihet në të dy rolet, si në atë të prodhuesit të të mirave materiale dhe shërbimeve, ashtu edhe në atë të konsumatorit të tyre. Në këtë kuptim mund të themi se dallojmë një rol të dyfishtë të saj, sepse njëherësh ajo është edhe si prodhuese edhe si konsumatore. Prandaj, në analizën e lidhjeve të ndërsjella popullsi-zhvillim, vend të veçantë zënë analizat e strukturave të tilla si, struktura e popullsisë sipas moshës së punës, struktura e zënies me punë të popullsisë aktive sipas gjinisë, sipas sektorëve prodhues (primar e dytësor), sipas profesioneve etj. Po ashtu, në material trajtohen edhe etapat nëpër të cilat kalon integrimi popullsi – zhvillim.

***Por integrimi popullsi – zhvillim** është i lidhur edhe me një koncept tjetër që është **mjedisi**, ekosistemi. Ato janë të ndërruarura sepse niveli i lartë i zhvillimit krijon mundësi financiare dhe favorizon një cilësi më të mirë të mjedisit. Ekosistemi nënkupton burimet dhe hapësirën, ndërsa socio-sistemi nënkupton individët dhe popullsinë nga njëra anë, dhe nga ana tjetër organizimin e shoqërisë në aspektin social, ekonomik, kulturor e teknik. Një vend të veçantë në punim zë **tranzicioni demografik, fazat dhe tipat e tij në vendin tonë dhe në botë**. Siç dihet, me tranzicion demografik kuptohet kalimi nga një regjim tradicional i ekuilibrit demografik me vdekshmëri e lindshmëri të lartë në një regjim ekuilibri modern me vdekshmëri e lindshmëri të ulët gjatë procesit të modernizimit të përgjithshëm. Ai është një proces që kalon popullsia e çdo vendi. Në periudhën para tranzicionit si koeficientet e lindjeve dhe ato të vdekjeve janë të larta dhe përgjithësisht të pavarura nga vullneti i njerëzve. Duke qenë të dyja të larta, ato kanë tendencë të baraspeshojnë proceset demografike. Analiza e këtij problemi lidhet edhe me ndryshimet e mëdha numerike të popullsisë në botë dhe ekuilibrat demografikë në shkallë vendi dhe në shkallë botërore. Duke iu referuar librit të dr. Hans Rosling “Forca e faktit”, bëhen përpjekje për të shpjeguar perceptimin e gabuar për rritjen e pandërprerë të numrit të popullsisë si dhe jepen masat që duhet të ndërmerren për të siguruar një ekuilibër modern të numrit të saj.*

Theksi vihet te varfëria e skajshme, e cila, siç dihet, prodhon një numër më të madh pasardhësish. Prandaj mënyra më e mirë për të mbajtur nën kontroll rritjen e popullsisë është të zhdukim varfërinë e skajshme dhe të përmirësojmë cilësinë e jetesës së njerëzve duke përfshirë edukimin, arsimimin dhe sidomos shtimin e investimeve për mirërritjen

e fëmijëve. Pjesa më e madhe e prindërve po zgjedhin të lindin më pak fëmijë, prirje e përhapur në të gjithë botën duke ulur ngado vdekshmërinë e fëmijëve.

Këto masa do të bëjnë që të realizohet sa më shpejt tranzicioni demografik për çdo vend, si dhe në shkallë botërore, duke i kaluar vendet në ekuilibra të rinj e modernë të popullsisë si dhe në ekuilibër të popullsisë botërore duke na e hequr "frikën" nga rritja e pareshtur e popullsisë së botës.

1. Ndërvarësia e popullsisë dhe zhvillimit

Shoqëria njerëzore është përballur me dëshmi të ndryshme mbi qenien dhe evoluimin e njeriut në tokë. Duke iu referuar periudhave që nga lashtësia e vazhdimisht, shohim se informacioni mbi numrin e popullsisë ka ardhur gjithnjë më i plotë dhe më i besueshëm. Dihet që të dhëna mbi numrin e popullsisë janë grumbulluar që në kohë të lashta. Madje statistika e popullsisë përbën degën më të vjetër të statistikës. Kështu, evidentimi dhe parashikimi i numrit të popullsisë ka shërbyer sidomos për qëllime ushtarake dhe fiskale. Ndërsa elemente të analizës demografike të bazuara në statistika administrative hasen në shekullin XVII. Ndër të parët që anglezi J. Graunt, i cili në vitin 1662 analizoi vdekshmërinë e popullsisë së Londrës në bazë të fletëregjistrimeve të vdekjeve. Më vonë fenomenet e lëvizjes së popullsisë dhe të efekteve ekonomike të saj tërhoqën vëmendjen e shumë ekonomistëve dhe sociologëve të njohur si A. Smith, T. Malthus, S. Simons, D. Rikardo, J. M. Kejns, J. B. Say etj.

Shoqërinë njerëzore e kanë shqetësuar vazhdimisht jo vetëm problemet e numrit të përgjithshëm të popullsisë, por edhe lëvizjet e saj natyrore, të brendshme dhe të jashtme, evoluimi i numrit në kohë, ndryshimet në strukturat social-ekonomike, ekuilibrat dhe dizekuilibrat numerikë, zhvillimi i saj i qëndrueshëm, modelet demo-ekonomike të zhvillimit të saj, tranzicioni demografik, etapat dhe tipat e tij etj. Në këtë trajtim mendojmë të ndalemi në problemet e **integritit të popullsisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm të saj**, duke u përpjekur të shpjegojmë lidhjen e rritjes së popullsisë me zhvillimin ekonomik dhe kalimin e zhvillimit numerik të saj nga ekuilibri natyror i lashtësisë në një ekuilibër të kohëve moderne në përfundim të tranzicionit demografik të mbarë vendeve të botës.

Integrimi i popullsisë dhe zhvillimit do të thotë që në studimet e ndryshme demografike të mbahen parasysh lidhjet e ndërsjella të zhvillimeve demografike dhe atyre social-ekonomike. Kjo, për faktin se zhvillimet ekonomike dhe strukturat prodhuese janë të lidhura me

zhvillimet demografike. Ato janë të lidhura p.sh. me lëvizjen natyrore të popullsisë, me lëvizjen migruese të saj, si dhe me fenomenin e ndryshimeve në strukturat social-ekonomike të popullsisë. Nga ana tjetër, edhe shkalla e ndryshimeve në strukturat sociale dhe ekonomike të popullsisë varet nga veçoritë dhe karakteristikat e strukturave prodhuese.

Përvojat e vendeve me prapambetje ekonomike dhe ku sektori ekonomik dominues është ai bujqësor dëshmojnë për një nivel të ulët të prodhimit të brendshëm bruto për banorë dhe për koeficiente të larta të lindshmërisë, rrjedhimisht edhe për nivel të ulët të jetesës së popullsisë. Këto dukuri shpjegohen jo vetëm pse kontrolli i lindjeve në këto vende është relativisht i ulët, por edhe pse ekonomia agrare e tyre kërkon që të angazhohen më shumë forca pune në veprimtaritë bujqësore, sepse praktikisht rendimenti i punës në këtë sektor është më i ulët.

Në këto vende ku treguesit e nivelit të jetesës janë të ulët, buxheti për konsum i familjes determinohet nga shpenzimet për ushqim. Si pasojë, ky tip i strukturës prodhuese është i shoqëruar me struktura të caktuara demografike, ku p.sh. fëmijët dhe të rinjtë përbëjnë një pjesë të rëndësishme të saj. Në këto vende me prapambetje ekonomike dallohen lehtë disa tipare të strukturave demografike, që mund të përmbliidhen si më poshtë:

Së pari, në vendet në zhvillim struktura e popullsisë *sipas moshës* ka si karakteristike që fëmijët dhe të rinjtë përbëjnë një pjesë të rëndësishme të saj. Pra, mbizotërojnë moshat e reja dhe popullsia e këtyre vendeve konsiderohet si popullsi e re në moshë.

Së dyti, në strukturën *sipas gjinisë* në këto vende dallon përqindja e lartë e meshkujve.

Së treti, në strukturën *sipas degëve* ku punojnë forcat e punës, peshën më të madhe e zënë forcat e punës në bujqësi, sepse në këto vende dega kryesore e punës është bujqësia.

Së katërti, në strukturën e popullsisë *sipas shkallës arsimore*, një peshë jo të vogël zënë analfabetët, madje për disa vende kjo pjesë është e konsiderueshme.

Së fundi, në këto vende është karakteristike zgjatja e jetës në lindje relativisht më e ulët.

E kundërta ndodh në vendet e zhvilluara. Në këto vende të ardhurat dhe prodhimi i brendshëm bruto për banorë janë mjaft më të larta. Treguesit e lindshmërisë dhe të vdekshmërisë janë në nivele pothuajse të qëndrueshme e me tendencë në rënie. Disa nga karakteristikat e strukturave të popullsisë në këto vende janë:

Në strukturën **sipas moshës** rritet pesha e personave të moshës së tretë.

Në strukturën **sipas veprimtarive** rritet përpjesa e forcave të punës të zëna me veprimtari jobujqësore.

Në strukturën **sipas shkallës arsimore** rritet pjesa e arsimuar, d.m.th. ajo me arsim të mesëm e të lartë, rritet numri i viteve të shkollimit të saj;

Në strukturën e popullsisë **sipas kualifikimit dhe profesioneve** rritet pesha e personave më të kualifikuar dhe ajo e profesioneve bazë të veprimtarive jobujqësore;

Ndërsa në strukturën e popullsisë **sipas vendbanimit** fshat–qytet rritet përqindja e popullsisë urbane; Në këto vende, ndryshe nga ato në zhvillim, është karakteristike një zgjatje e jetës në lindje relativisht më e lartë.

Në formimin e strukturave të popullsisë kanë ndikimin e vet faktorë të tillë si: përparimi i teknikës dhe teknologjisë, rritja e produktivitetit të punës dhe konkurrenca e suksesshme në prodhim e tregti, rritja e përpjekjeve për arsimin, kulturën dhe kujdesin shëndetësor e të tjerë faktorë demografikë, ekonomikë e socialë.

Ashtu si faktorët ekonomikë e socialë ndikojnë në formimin e veçorive të popullsisë, edhe strukturat demografike ndikojnë në rrjedhat ekonomike të një vendi. Në strukturën e popullsisë sipas moshës, gjinisë, profesionit, degëve etj. ndërthuret veprimi i një kompleksi të madh faktorësh, si faktorët biologjikë dhe ata socio–ekonomikë, në varësi me shkallën e zhvillimit të çdo vendi. Nga ana tjetër, angazhimi në veprimtari prodhuese e në shërbime i forcave të punës dhe përdorimi me efektivitet i këtyre burimeve luajnë rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike.

Është e kuptueshme se e gjithë popullsia e një vendi dhe sidomos pjesa aktive e saj e zënë me punë në sektorët e ndryshëm të ekonomisë përfshihet në jetën ekonomike e shoqërore të vendit. Ajo përfshihet në të dy rolet, në atë të prodhuesit të të mirave materiale dhe shërbimeve, si dhe në atë të konsumatorit të tyre. Në këtë kuptim mund të themi se dallojmë një rol të dyfishtë të saj, sepse njëherësh ajo është edhe si prodhuese edhe si konsumatore. Si përfundim, në analizën e lidhjeve të ndërsjella popullsi - zhvillim vend të veçantë zënë analizat e strukturave të tilla si struktura e popullsisë sipas moshës së punës, duke e ndarë atë sa është nën moshën e punës, në moshë pune dhe mbi moshën e punës, struktura e zënies me punë të popullsisë aktive sipas gjinisë, struktura e zënies me punë në sektorin prodhues (primar e dytësor) dhe sektorin e shërbimeve (terciar), struktura e punonjësve sipas profesioneve etj.

Është evidente që struktura e popullsisë në tërësi, me të gjitha veçoritë e saj ekonomike e sociale, ka një rol përcaktues në vëllimin dhe strukturën e nevojave për konsum. Kështu rritja e pjesës së grupmoshës 0-15 vjeç dikton nevoja të tjera specifike për konsum, në raport me grupmoshat e tjera të popullsisë, si në konsumin e artikujve ushqimorë e të veshmbathjes, investimeve për arsim e shëndetësi, si për çerdhe, kopshte, shkolla etj. Pra, popullsia luan rol të rëndësishëm në formimin e dimensioneve demografike të tregut të brendshëm. Po ashtu, ajo ndikon edhe në krijimin e tregut ekonomik dhe sektorëve të tjerë prodhues e joprodhues, pasi ajo me punën e saj siguron të ardhurat që nga ana e tyre ndikojnë në fuqinë blerëse si dhe në vëllimin dhe strukturën e blerjeve dhe të prodhimit.

2. Etapat e integritit popullsi – zhvillim

Integrimi popullsi – zhvillim mund të përmbledhë katër etapa, që konkretisht janë:

Etapa e parë ose **integrimi teknik**, i cili i përket përfshirjes së variablave demografikë në programet e planifikimit dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Etapa e dytë ose **integrimi shkencor** presupozon përfshirjen e studimeve të popullsisë dhe të kërkimeve shkencore dhe përputhjen e tyre me kushtet social-ekonomike të zhvillimit. Ky lloj integrimi bën të mundur nxitjen e debatit shkencor për mënyra të reja të analizës si dhe strategji të reja veprimi.

Etapa e tretë ose **integrimi politik** nënkupton integrimin e politikave demografike dhe të politikave ekonomike e sociale në strategjitë e zhvillimit. Ky lloj integrimi duhet të realizohet duke harmonizuar në nivelet më të larta interesat e të gjithë sektorëve.

Etapa e katërt ka të bëjë me **integrimin human** dhe **atë social kulturor**. Ajo nënkupton integrimin aktiv të popullsisë në procesin e zhvillimit, duke e lidhur këtë të fundit me zhvillimin e të gjithë sektorëve socialë, arsimorë e kulturorë.

Integrimi popullsi - zhvillim është një proces tërësor që lidhet me harmonizimin e të katër këtyre etapave. Ato veprojnë njëherësh, prandaj ato asnjëherë nuk duhen parë të shkëputura nga njëra-tjetra. Pra, integrimi i plotë popullsi - zhvillim nuk mund të ketë vend pa përfshirjen e të gjitha etapave të ndryshme të integritit në zhvillimin ekonomik e social të vendit.

Integrimi i ndërlidhjeve popullsi – zhvillim, në njëfarë mënyre, shpreh lidhjen demografi – ekonomi. Kjo lidhje ka përbërë një preokupim të hershëm për shumë studiues, duke filluar nga Malthus, Sauvy, Simons, Marksi etj., të cilët në veprat e tyre kanë shprehur konsiderata edhe për këtë integrim. Kështu, ata duke trajtuar këto probleme kanë dhënë shpjegime për koncepte të tilla si demografia ekonomike, ekonomia e popullsisë etj. Megjithatë, të para këto në kushtet konkrete të vendeve të veçanta, as demografia ekonomike, as ekonomia e popullsisë nuk kanë dhënë shpjegime të plota dhe nuk u janë përgjigjur plotësisht shpresave në këtë fushë. Këtë e provon fakti se kërkimet e thelluara rreth raporteve popullsi – zhvillim mungojnë ose janë shumë të rralla si në vendet e tjera ashtu edhe te ne.

Shpesh studimet demografike bëhen të ndara nga ato ekonomike. Kjo ndarje rrjedh dhe për shkak të veçorive që i largojnë këto disiplina nga njëra-tjetra. Kështu, demografët preferojnë individin më shumë se grupin, ata përdorin kryesisht moshën dhe gjininë si variabël diferencimi, më shumë se statusin socio-ekonomik dhe interesohen më shumë për dinamikën e popullsisë për një kohë të gjatë sesa për fluktuacionet afatshkurtra e afatmesme. Një pikë tjetër ndarëse midis demografëve dhe ekonomistëve është edhe horizonti kohor i studimit të fenomeneve. Demografi sheh më larg, ndërsa ekonomisti preokupohet më shumë për fenomenet që veprojnë në afate të shkurtra, dhe kjo jo nga dëshira e tyre, por nga domosdoshmëria e zgjidhjes së mjaft problemeve akute që shtron ekonomia. Ekonomisti interesohet kryesisht për probleme që e shtrijnë veprimtarinë e tyre brenda 1 viti ose më së shumti 5 vjet dhe rrallë herë 10 vjet, që është zakonisht afati maksimal i parashikimit. Në të kundërtën, shumica e parametrave si prodhimi, investimet, konsumi, çmimet ndryshojnë shpejt, nganjëherë në përmasa të papritura, jashtë çdo parashikimi.

Përgjithësisht individët i përcaktojnë vetë sjelljet e tyre demografike. Megjithatë sjelljet e individëve varen edhe nga vendimet e marra në familje. Familjet shpesh jo vetëm ndikojnë në sjelljen e anëtarëve të tyre, por ato janë njëherësh edhe qendra të marrjes së vendimeve të rëndësishme për sa i përket konsumit, kursimeve, aktivitetit ekonomik, lëvizjes migruese etj.

Për të shpjeguar mekanizmat e zhvillimit duhet të kuptohet se mbrapa dinamikës së popullsisë, që duket shpesh e thjeshtë, qëndron dinamika e lëvizjeve sociale, të cilat shpesh janë të pakapshme, shumë më të ndërlikuara dhe komplekse. Ata që ndërtojnë perspektivat guxojnë të bëjnë edhe studime afatgjata, në të cilat linearja vihet përballë jolineares,

e vazhdueshmja përballë jo së vazhdueshmes dhe ku dilemat e forta janë pjesë përbërëse e situatave normale. Megjithëse shkencat e demografisë dhe të ekonomisë kanë objektet e tyre të veçanta, mendojmë se nuk ka një ndarje të prerë të fenomeneve demo-ekonomike. Popullsia është një nga elementet e sistemit shoqëror që përmbledh njëherësh përshtatjen e saj në hapësirë, marrëdhëniet me mjedisin, riprodhimin dhe ndarjen e burimeve, këmbimet dhe strukturat sociale etj.

Lidhjet e popullsisë dhe zhvillimit kanë qenë objekt debati për studiues nga vende të ndryshme të botës. Por kur këto debate u thelluan për sa i përket ndërvarësisë së lidhjeve midis tyre, atëherë shtetet, politikanët, organizmat ndërkombëtarë u angazhuan edhe më shumë për instrumentalizimin e problematikës së kësaj fushe. Gjatë 50 vjetëve të fundit janë mbajtur 5 konferenca botërore për popullsinë dhe zhvillimin: në vitin 1974 në Bukuresht, në vitin 1984 në Meksiko, në vitin 1990 në Kajro dhe në vitin 1995 u zhvillua në Kopenhagë samiti botëror për zhvillimin social. Në këto konferenca ndërkombëtare kanë marrë pjesë mbi 170 shtete dhe janë hartuar një sërë programesh aksioni për popullsinë dhe zhvillimin për vitet e ardhshme. Ja disa nga mesazhet e dhëna nga konferencat:

Varfëria si dhe pabarazitë midis grupeve sociale kanë një ndikim të madh mbi parametra demografikë të tillë si rritja, ekuilibrat numerikë, struktura, shpërndarja e popullsisë dhe anasjelltas. Rritja ekonomike e pandërprerë në kuadrin e zhvillimit afatgjatë kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës për gjeneratat e sotme dhe të ardhme si dhe favorizon drejtësinë sociale dhe eliminon varfërinë.

Për të bërë të mundur realizimin e zhvillimit afatgjatë do të duhet që faktorët dhe të dhënat demografike të vihen në shërbim të përdorimit racional e të efektshëm të të gjitha burimeve, natyrore, materiale, monetare, mjedisore dhe ekosistemeve. Integrimi i faktorëve demografikë në zhvillim lehtëson vendosjen e ekuilibrave midis treguesve demografikë dhe objektivave socialë, ekonomikë dhe të ruajtjes së mjedisit.

Një mesazh tjetër i rëndësishëm i këtyre konferencave ka qenë krijimi i një klime të favorshme për vlerësimin e shërbimeve të planifikimit familjar dhe të shëndetit riprodhues të një cilësie të mirë. Masat që rekomandohen kanë pasur për qëllim të ndihmojnë çiftet dhe individët për të arritur objektivat e tyre lidhur me riprodhimin, për të penguar shtatzënitë e padëshiruara, për të vënë në dispozicion të atyre që kanë nevojë dhe dëshirojnë shërbime informimi e këshilla lidhur me programin e familjes etj.

Një nga shkaqet kryesore të vdekshmërisë amnore në shumë vende në zhvillim janë ndërlikimet gjatë shtatzënisë dhe lindjes. Për këtë shkak, rreth gjysmë milioni gra vdesin çdo vit, ku 99 për qind e tyre u përkasin vendeve në zhvillim. Moshë në shtatzëninë e parë e të fundit, intervali ndërmjet lindjeve, numri gjithsej i shtatzënive si dhe mungesa e interesimit për cilësinë e mjedisit social-kulturor dhe ekonomik ndikojnë në sëmundshmëri dhe koeficientet e larta të vdekshmërisë amnore.

Në konferenca është theksuar se aborti nuk duhet nxitur në asnjë rast si metodë e planifikimit familjar. Në të kundërtën, duhet të bëhen të qarta pasojat e abortit të praktikuar, veçanërisht në kushtet e një pasigurie shëndetësore. Aborti duhet trajtuar në kuadrin e sistemit të shëndetit dhe në përputhje me procedurat legislative të çdo vendi.

Procesi i urbanizimit ishte një fenomen tjetër që është trajtuar në konferenca. Ai është parë i pandarë nga zhvillimi ekonomik e social i çdo vendi. Ky proces duhet të arrijë objektivin për një shpërndarje të popullsisë në mënyrë të tillë që të nxisë zhvillimin afatgjatë, të qëndrueshëm e të pandërprerë si në zonat origjinë ashtu edhe në zonat destinacion, të favorizojë një zhvillim ekologjikisht racional, barazinë ekonomike e sociale. Vendet duhet të përshtatin strategji që favorizojnë rritjen e qendrave të vogla e të mesme urbane, si dhe zhvillimin e zonave rurale duke inkurajuar investimet që çojnë në integrimin urban dhe në rritjen e produktivitetit në këto zona.

Arsimi gjithashtu është trajtuar si një faktor çelës i zhvillimit afatgjatë e të pandërprerë për çdo vend. Njëpërmjet tij fitohen njohuritë dhe bëhet i mundur përmirësimi i nivelit të jetesës. Arsimimi i popullsisë kontribuon në përsosjen e kompetencave të popullsisë aktive, në rritjen e pjesëmarrjes së gruas në jetën sociale dhe ekonomike si dhe në zhvillimin e demokracisë së çdo vendi. Progresi në arsim ndikon gjithashtu në uljen e koeficienteve të fertilitetit, në uljen e sëmundshmërisë e vdekshmërisë, rrit pavarësinë dhe shkallën e emancipimit të shoqërisë në tërësi dhe të vajzave e grave në veçanti.

Në këto konferenca është theksuar me forcë se studimet në fushën e popullsisë e të zhvillimit është e nevojshme që të vihen në funksion të zhvillimit afatgjatë e të pandërprerë të çdo vendi. Për organizimin e tyre duhet të bashkëpunojnë dhe racionohen forcat shkencore, duke përfshirë në grupet e punës krahas demografëve edhe ekonomistë, sociologë, arkitektë etj. Konferenca e Kajros p.sh. transmetoi mesazhin se popujt e botës duhet të veprojnë së bashku për mirëqenien e brezave të sotëm e të ardhshëm.

Ndërsa samiti botëror për zhvillimin social që u zhvillua në Kopenhagë, me përfaqësues nga të gjitha vendet anëtare të OKB-së, duke u mbështetur edhe në orientimet e konferencës së Kajros, e vuri theksin në tri drejtime kryesore si: reduktimi i varfërisë, forcimi i solidaritetit human dhe krijimi i mundësive për punësim. Por që integrimi popullsi – zhvillim të përbëjë një realitet, është e nevojshme të ndërmerren studime të përbashkëta ku të bashkëpunojnë e bashkëveprojnë njëherësh demografë, ekonomistë dhe kërkues të tjerë sipas kritereve metodologjike e shkencore.

3. Popullsia, zhvillimi dhe lidhja e tyre me mjedisin

Zhvillimi dhe popullsia, për të cilat u fol në paragrafët e mëparshëm, ishin dy koncepte të rëndësishme. Por ato janë të lidhura pazgjidhshmërisht edhe me një koncept të tretë që është mjedisi. Ato janë të ndërvarura sepse niveli i lartë i zhvillimit krijon mundësi financiare dhe favorizon një cilësi më të mirë të mjedisit. Mjedisi është një eko-socio-sistem. Ekosistemi nënkupton burimet dhe hapësirën, ndërsa socio-sistemi nënkupton individët dhe popullsinë nga njëra anë, dhe nga ana tjetër organizimin e shoqërisë në aspektin social, ekonomik, kulturor e teknik.

Nuk mund të arrihet një shkallë e lartë zhvillimi pa rritjen ekonomike. Por rritja ekonomike dhe zhvillimi nuk janë koncepte të njëjta. Rritja ekonomike nënkupton rritjen e produktivitetit, të fitimeve dhe të rentabilitetit, pra një rritje sasiore që synon përmirësimin e nivelit të jetesës së njerëzve, por kurrë rritja ekonomike nuk përbën qëllim në vetvete. Përkundrazi, koncepti i zhvillimit ka një përmbajtje më sociale. Ai nënkupton një cilësi më të mirë jetese për të gjithë dhe për një kohë të gjatë. Kjo cilësi jetese është në funksion të shkallës së plotësimit të nevojave dhe aspiratave të njerëzve. Këto nevoja dhe aspirata janë të natyrës jo vetëm ekonomike, por dhe intelektuale e shpirtërore si arsimimi, drejtësia, liritë e individit, kënaqësia estetike, kultura, sporti, me një fjalë, gjithçka që është specifike për botën humane.

Disa autorë mendojnë se sa më i ulët të jetë niveli i zhvillimit, aq më shumë presion ushtrohet mbi mjedisin. Por presion mbi mjedisin bën edhe zhvillimi, i cili shoqërohet me më shumë mbetje teknologjike, me më shumë rrezatime etj. E rëndësishme është se niveli i lartë i zhvillimit ekonomik krijon edhe mundësi financiare për të marrë masa me investime për ruajtjen e mjedisit. Veçanërisht rritja demografike ushtron presion mbi

mjedisin në vendet me zhvillime më të ulëta. Në këto vende ushtrohet një presion më i fortë sidomos mbi burimet natyrore, si mbi pyjet, ujin, tokat e kultivueshme etj.

Popullsia e botës në vitin 1825 numëronte 1 miliard banorë, në vitin 1930 kalon në 2 miliardë dhe në vitin 1987 kaloi në 5 miliardë. Në vitin 2000 popullsia arriti më shumë se 6 miliardë dhe në vitin 2025, sipas hipotezës së rritjes mesatare nga OKB, parashikohet të jetë rreth 8,5 miliardë veta. Pra, për rreth 200 vjet popullsia e botës rritet në 8,5 herë.

Në sajë të progresit të teknikës e të teknologjisë, sot prodhohen 7 herë më shumë (L. Goffin) produkte industriale se në vitin 1950, gjë që do të thotë më shumë lëndë të para, më shumë energji, por edhe më shumë mbetje e më shumë ndotje. Rritja e prodhimit industrial është shoqëruar me një rritje të konsumit, ndonëse shkalla e konsumit nuk është e barabartë midis vendeve dhe as midis shtresave sociale. Në planin ndërkombëtar 20 për qind e popullsisë së vendeve të pasura të Veriut dhe të Perëndimit ndajnë më shumë se 80 për qind të të ardhurave botërore. Ndërsa në vitin 1960, 20 për qind e banorëve më të pasur të botës dispononin të ardhura 30 herë më të larta se 20 për qind e më të varfërve, në vitin 2020 këto të ardhura ishin 90 herë më të larta, d.m.th. tri herë më shumë.

Në kushtet e një rritjeje kaq të pabarabartë, ajo që del më shumë në dukje është keqzhvillimi sesa zhvillimi. Në fillim të viteve '70 u përpunua koncepti i eko-zhvillimit. Ky konceptim nënkuptonte një zhvillim të vetë popullsisë duke përdorur më mirë burimet natyrore dhe duke ia përshtatur një mjedisi, i cili duhet të transformohet, por pa e shkatërruar atë. Sot termi më i përhapur i përket zhvillimit afatgjatë, i qëndrueshëm e i pandërprerë. Sipas këtij koncepti, zhvillimi duhet t'u përgjigjet nevojave të sotme pa kompromentuar kapacitetet e nevojshme për gjeneratat e ardhshme.

Edhe për problemet e mjedisit dhe zhvillimit global të lidhura me etikën e zhvillimit janë mbajtur 3 konferenca botërore dhe dy mbledhje të Forumit Ndërkombëtar të Punës. Konferenca e parë e Kombeve të Bashkuara është mbajtur në Stokholm në vitin 1972, konferenca e dytë në vitin 1982 në Nairobi dhe konferenca e tretë e quajtur "Samiti i planetit Tokë" u mbajt në vitin 1992 në Rio-de-Zhaneiro në praninë e përfaqësuesve të 177 shteteve. Ndërsa konferenca II e Forumit Ndërkombëtar të Punës u mbajt në Delhi në vitin 2005. Në të gjitha këto konferenca është synuar:

Së pari, në rritjen ekonomike në funksion të një zhvillimi afatgjatë që garanton cilësinë e nivelit të jetesës dhe që respekton njëherësh pasuritë natyrore të planetit.

Së dyti, në solidaritet më konkret e më efikas ndërmjet vendeve të pasura e të varfra në vend të dominimit ekonomik e politik të të parave ndaj të dytave.

Disa nga objektivat e konferencave të mjedisit ishin:

- vëmendje e veçantë për rritjen ekonomike, duke e orientuar atë në plotësimin e nevojave bazë të popullsisë, si ushqim, shëndet, siguri, ujë, punësim.

- zotërim i rritjes demografike.
- ruajtje dhe përdorim racional i burimeve natyrore.
- trajtim i rreziqeve teknologjike dhe natyrore
- ulje sidomos e varfërisë ekstreme.
- realizimi i arsimit fillor dhe 8-vjeçar për të gjithë fëmijët.
- luftimi i disa sëmundjeve të rënda të shekullit të kaluar si sida, tuberkulozi, malaria etj.

Për të realizuar këta objektiva u tha se është e nevojshme të zbatohen disa strategji si vijon:

Në planin ekologjik dhe mjedisor. Zhvillimi dhe rritja e veprimtarive prodhuese, nëse nuk merren masa mbrojtëse, çojnë në ndotjen e mjedisit, në degradimin e ajrit, ujit dhe nëntokës nga hedhjet dhe mbetjet teknologjike e kimike, në mbishfrytëzimin e burimeve të mineraleve, pyjeve, shtretërve të lumenjve etj. Prandaj, në këtë kuadër, u kërkuar të merren masa për mbrojtjen e atmosferës, angazhimin e shoqërisë dhe bizneseve për përsosjen e mënyrave të shfrytëzimit të tokës e nëntokës, forcimin e luftës kundër shpyllëzimeve, aplikimin e masave nxitëse për zhvillimin rural e bujqësor, për mbrojtjen e zonave malore, për ruajtjen e diversitetit biologjik, kontrollin e veprimt të substancave kimike e toksike, pastrimin e ujërave të përdorura, kontrollin dhe trajtimin e hedhjeve dhe mbeturinave në tërësi dhe atyre radioaktive në veçanti, trajtimin e ujërave të ëmbla, deteve dhe oqeanëve etj.

Në planin ekonomik. Për vendet në zhvillim është shtruar problemi që ato të ndihmohen me qëllim që t'i përdorin vetë burimet e tyre natyrore, të marrin masa për të stabilizuar çmimet me vlerën e vërtetë të produkteve, për nxitjen e këmbimit të lirë, zvogëlimin e borxhit të jashtëm, krijimin e kompetencave teknike dhe decentralizimin e pushtetit etj. Për vendet e industrializuara shtrohet detyra që të përsosen mënyrat e konsumit dhe të prodhimit me qëllim që të kufizohen rreziqet e shterimit të burimeve natyrore të parikthyeshme, si burimet minerale dhe energjetike, tokat

e kultivueshme dhe uji. Nga ana tjetër, prej tyre kërkohet dhënia e një asistence teknike dhe ndihme të drejtpërdrejtë ndaj vendeve në zhvillim etj. Studiues të ndryshëm mendojnë se për ruajtjen e mjedisit produkti i brendshëm bruto duhet korrigjuar me një shumë monetare që u korrespondon degradimeve dhe tejshfrytëzimeve të burimeve. Mosmarrja parasysh e degradimit të ujërave ose të ajrit ka bërë që për një kohë të gjatë të mbivlerësohen rezultatet e rritjes ekonomike në vendet e zhvilluara. Në të kundërtën, nëse përpjekjet për të evituar degradimet nuk do të përfshihen si shumë monetare në produktin e brendshëm bruto, atëherë interesi për mbrojtjen e mjedisit do të ulet.

Ekonomistët janë të mendimit që degradimet e mjedisit të maten me terma monetarë dhe të përfshihen në buxhetet e vendeve të ndryshme. Në të kundërtën, disa mbrojtës të mjedisit e kundërshtojnë idenë e këtyre vlerësimeve, sepse, sipas tyre, bën që problemet e mjedisit të përfshihen në kornizën e diktaturës konceptuale “gjithçka në para”.

Për vendet e zhvilluara është e rëndësishme që të bëhet riciklimi, rikuperimi si dhe përdorimi i ekoprodukteve. Gjithashtu do të duhej që nga ana e tyre të realizohej transformimi dhe transferimi i teknologjive të përshtatshme edhe për situatat e vendeve në zhvillim, pasi kërkimi shkencor të jetë orientuar drejt objektivave të cilësisë së jetesës.

Në planin social. Në konferenca është theksuar që lufta kundër varfërisë ekstreme përbën një prioritet dhe si e tillë kërkohet të vihet theksi mbi kërkimet për sigurimin e produkteve bazë ushqimore. Për shumë vende, siç u vu në dukje nga Samiti i planetit Tokë, rritja demografike përbën një mbingarkesë të madhe për mundësitë e ruajtjes së ekosistemeve dhe për kapacitetet ekonomike dhe teknike të shoqërive. Prandaj në këto konferenca është theksuar vazhdimisht nevoja e planifikimit familjar, përdorimi i metodave të ndryshme për parandalimin e lindjeve të padëshiruara etj.

Në planin politik. Për arritjen e këtyre synimeve, krahas politikave të shëndetit, të punësimit, të arsimimit dhe të kushteve të urbanizimit, me rëndësi do të jetë edhe përfshirja e programit të politikave të planifikimit familjar si pjesë përbërëse e politikave të zhvillimit global. Politikanëve në pushtet u është kërkuar të favorizojnë pjesëmarrjen aktive të shtetasve në marrjen e vendimeve jo vetëm brenda familjes, por edhe në kuadrin e gjithë shoqërisë.

Veçanërisht e nevojshme është të tërhiqet mendimi i grupeve të caktuara sociale, si: gratë, të rinjtë, punëtorët e industrive, fshatarët, migrantët në zonat origjinë dhe zonat destinacion. Gjithashtu, një informim dhe edukim


relativ për mjedisin për të gjithë duhet të jetë në mënyrë të domosdoshme i vazhdueshëm dhe nxitës.

4. Tranzicioni demografik, fazat dhe tipat e tij në vendin tonë dhe në botë

Me tranzicion demografik kuptohet kalimi nga një regjim tradicional i ekuilibrit demografik me vdekshmëri e lindshmëri të lartë, në një regjim ekuilibri modern me vdekshmëri e lindshmëri të ulët gjatë procesit të modernizimit të përgjithshëm. Ai është një proces që e kalon popullsia e çdo vendi. Në periudhën para tranzicionit si koeficientet e lindjeve dhe ato të vdekjeve janë të larta dhe përgjithësisht të pavarura nga vullneti i njerëzve. Duke qenë të dyja të larta, ato kanë tendencë të baraspeshojnë proceset demografike.

Gjatë **fazës së parë të tranzicionit**, koeficientet e vdekjeve ulen, ndërsa ato të lindjeve qëndrojnë të larta. Si rrjedhojë, ka një rritje të shpejtë të koeficienteve të rritjes natyrore. Në **fazën e dytë**, koeficientet e vdekshmërisë dhe të lindshmërisë zvogëlohen, megjithatë këto të fundit janë akoma të larta. Për këtë rritja demografike vazhdon me një koeficient të lartë dhe relativisht të qëndrueshëm. Me avancimin e tranzicionit demografik koeficientet e vdekjeve ulen deri në një nivel të caktuar dhe nuk ndryshojnë më, ndërsa koeficientet e rritjes fillojnë të ulen.

Gjatë fazës së tretë, siç shihet edhe në *figurën 4.1*, koeficientet e vdekjeve e të lindjeve ulen më shumë dhe kanë tendencë të baraspeshojnë rishtas proceset demografike.

Figura 4.1 Paraqitja grafike e fazave të tranzicionit demografik

Burimi: Dumani B.; Stringa A. *Elemente të demografisë*, Tiranë, 1997, faqe 108

Midis dy regjimeve të ekuilibrit dallojmë fazën e rritjes natyrore e cila fillon në **Ta** dhe është aq më e shpejtë sa më e fortë të jetë ulja e vdekshmërisë, si dhe fazën e zvogëlimit të rritjes demografike që mund të fillojë në **Tb** ose më vonë në varësi nga rënia e koeficienteve të lindshmërisë dhe vdekshmërisë. Shtesa që pëson popullsia gjatë periudhës së tranzicionit lidhet me tre faktorë: nivelin e rritjes në fillim; evoluimin e lindshmërisë dhe vdekshmërisë midis dy uljeve (nga **Ta** në **Tb**); dhe shpejtësitë respektive të uljes së vdekshmërisë dhe lindshmërisë.

Praktika botërore ka kaluar shumë situata të tranzicionit demografik. Ajo njeh disa tipa të tij dhe konkretisht:

Në **tipin e parë** bëjnë pjesë vendet e zhvilluara europiane. Përgjithësisht këto vende kanë një evoluim të ngjashëm e klasik, që grafikisht kanë formën e një kambane. Karakteristike për to janë: Koeficienti i rritjes natyrore është nën 2 për qind për çdo vit dhe tranzicioni demografik zgjat nga 75 deri 200 vjet. Në këtë tip dallohen tri modele: modeli nordik, modeli perëndimor dhe modeli jugor. Këto modele dallohen nga njëri-tjetri nga ritmet e rritjes (brenda 2-përqindëshit). Kështu modeli nordik ka ritmet më të ulëta të rritjes natyrore, modeli perëndimor ritmet mesatare dhe ai jugor ritmet më të larta.

Në **tipin e dytë** përfshihen vendet me popullsi të imigruar si SHBA-ja, Kanadaja, Australia, Zelanda e re, Argjentina, Uruguai. Profili i tranzicionit

demografik të këtyre vendeve nuk është i formës klasike (kambanë), por i një vije në rënie që nga ana formale paraqet një gjysmëtranzicion (nga që migrimet mbartin në vetvete një seleksionim të moshave). Ky seleksionim çon në njëfarë vjetrimi të strukturave demografike. Kjo sepse migracioni lidhet më shumë me të rinj në moshë pune.

Në **tipin e tretë** bëjnë pjesë vendet në zhvillim, të cilat karakterizohen nga një koeficient i lartë i rritjes natyrore nga 2-4 për qind në vit dhe nga një tranzicion relativisht i shkurtër që zgjat nga 40-80 vjet.

Duke qenë se ndryshimi i popullsisë si rezultat i lindjeve, vdekjeve dhe migrimet konsiderohet i vazhdueshëm, herësi i tranzicionit zakonisht llogaritet si raport i numrit të popullsisë në fazën e fundit të tranzicionit (P_{Tn}) me numrin e saj në fillim të fazës së parë (P_{Ta}), me formulën që vijon:

$$H = \frac{P_{Tn}}{P_{Ta}} = e^{rn}$$

Ku: H- është herësi i tranzicionit;

r - është koeficienti i rritjes natyrore;

n - është periudha midis rënies së koeficientit të vdekshmërisë e të lindshmërisë.

Në botë tranzicioni demografik ka kaluar nëpërmjet dy revolucioneve demografike. Kështu, vlerësohet se revolucion i parë demografik ka ndodhur midis viteve 800 dhe 600 p.e.s., që përkon me kohën kur njerëzit filluan të merreshin me bujqësi. Punimi i tokës dhe rritja e bagëtive çoi në vendosjen e popullsisë me banim të qëndrueshëm në rajone të caktuara dhe filloi në njëfarë mënyre organizimi i jetës, gjë që shënoi edhe premisa për rritjen e numrit të popullsisë. Kjo periudhë karakterizohej me një lindshmëri e lartë (rreth 45-50 lindje për 1000 banorë) dhe vdekshmëri po ashtu tepër të lartë (40-45 për 1000 banorë).

Revolucioni i dytë demografik, i cili lidhet edhe me ndryshimet e mësipërme të evolucionit të popullsisë, ka filluar rreth vitit 1700. Ai lidhet me revolucionin industrial, mendohet të ketë filluar në Francë e Angli dhe karakterizohet nga të tria fazat klasike të tranzicionit demografik që shpjegojmë në fillim të këtij paragrafi.

Në Shqipëri, tranzicioni demografik ka disa karakteristika. Ecuria e tij për nga forma përkon me profilin më tipik (në formë kambane) si dhe me mjaft vende të Europës, por këndi demografik është i ndryshëm dhe

ngjason me atë të vendeve në zhvillim. Ai është një tranzicion i shkurtër dhe i shpejtë.

Faza e parë e tranzicionit demografik në Shqipëri, që mund të konsiderohet periudha 1920-1955, shënon një fazë të gjatë për rreth 35 vjet. Gjatë kësaj faze vihet re një rritje e koeficienteve të rritjes natyrore të popullsisë. Kështu, ritmi mesatar vjetor i rritjes së popullsisë për periudhën 1920-1940 ka qenë 1,5 për qind, ndërsa në periudhën 1940-1950 ai zbriti në 1.1 për qind dhe pastaj filloi të rritej në vitet 1950-1955 e më vonë edhe mbi 2 për qind. Në tërësi ritmi mesatar vjetor i rritjes së popullsisë në këtë fazë (1920-1955) ka qenë 1,7 për qind.

Faza e dytë përfshin periudhën 1956-1970, kur koeficienti i vdekjeve ulet në mënyrë sistematike dhe koeficientet e lindshmërisë, megjithëse kanë filluar të ulen, përsëri vazhdojnë të jenë në nivele të larta. Në këtë fazë koeficienti vjetor i rritjes së popullsisë ka qenë 2,96 për qind.

Faza e tretë përfshin periudhën 1970 e në vazhdim. Pas viteve 1970, koeficientet e lindjeve dhe të vdekjeve janë ulur vazhdimisht, pothuajse pa rimarrje të vlerave të tyre. Kështu, në 10-vjeçarin 1970-1980 ritmi mesatar vjetor i rritjes së popullsisë u ul në 2.5 për qind dhe në vitet 1980-1990 ai ra në 2.1 për qind. Në vitin 2010 ai ka arritur në 1.6 për qind. Ndërsa në vitet 2011-2023 ai ul edhe më tej. Madje si rezultat edhe i emigracionit në këtë periudhë u ndeshëm me rënien e numrit absolut të popullsisë. Evoluimet demografike në këtë fazë shpjegohen në kuadrin e të gjitha zhvillimeve sociale dhe ekonomike të vendit.

Numri i popullsisë së dalë nga procesi i tranzicionit varet jo vetëm nga zgjatja e periudhës, por edhe nga “lartësia”, d.m.th., nga koeficienti i rritjes natyrore të popullsisë. Kështu, popullsia e Shqipërisë për rreth 100 vjet tranzicion demografik parashikohet të rritet 5 herë, ndërkohë që popullsia e Meksikës për 80 vjet tranzicion demografik rritet 7 herë, ndërsa popullsia e Suedisë për 150 vjet tranzicion është rritur vetëm 3,8 herë etj.

Nga shfaqja e tij në tokë njeriu ka jetuar dy hope të mëdha demografike që u korrespondojnë dy revolucioneve të mësipërme, që përbëjnë faza vendimtare të evoluimit dhe formimit të tij. Deri nga fundi i mijëvjeçarit të tetë p.e.s. (d.m.th., 10.000 vjet më parë) popullsia e botës kishte një zhvillim shumë të ngadaltë, ajo mezi arriti deri në 5 milionë banorë. Ndërsa deri nga fundi i mijëvjeçarit të pestë p.e.s, megjithëse ajo u 3-fishua, vazhdoi të kishte një zhvillim shumë të ngadaltë, ajo arriti në 15 milionë banorë. Si rezultat i zhvillimit të bujqësisë në fund të mijëvjeçarit të 4-t d.m.th. pas 1000 vjetësh, ajo u rrit 10 herë dhe arriti në 150 milionë banorë. Ky qe hopi

I i zhvillimit demografik, që lidhet me revolucionin e parë demografik. Dinamika e saj tregohet në *tabelën 4.1* si më poshtë:

Tabela 4.1 Rritja e popullsisë së botës

Vitet e vlerësimit	Gjithsej (në milionë)
Fundi i mijëvjeçarit VIII (p.e.r.) d.m.th. 10.000 vjet më parë	5
Fundi i mijëvjeçarit V (p.e.r.)	15
Fundi i mijëvjeçarit IV (p.e.r.)	150
0	252
200	275
800	224
1600	578
1700	771
1750	830
1800	912
Viti 1800 ndaj fundit të mijëvjeçarit IV (në %)	150-912 608

Burimi: Përpunim i të dhënave nga botimi i prof. Fiqiri Sherit ‘Popullsia e botës’, Tiranë, më 2006.

Rritja e popullsisë së botës pas erës sonë sipas kontinenteve paraqitet në *tabelën 4.2* që vijon:

Tabela 4. 2. Popullsia e botës prej viteve 14 deri në vitin 1600 të epokës sonë

Viti	Bota Gjithsej	a) Afrika	b) Amerika	c) Azia	d) Europa	Oqeania
14	256	23	3	189	39.5	1
350	254	30	5	190	27.6	1
600	237	37	7	173	19.3	1
800	261	43	10	178	29.2	1
1000	280	50	13	177	39.2	1
1200	384	61	23	248	51.5	1
1500	461	87	42	245	84	3
1600	578	113	13	338	111	3

- a) Përfshin të gjithë Egjiptin
- b) Amerika Veriore dhe Jugore
- c) Azia pa pjesën e ish-BS-së
- d) Europa me ish-BS-në

Burimi: Përpunim i të dhënave të nxjerra nga botimi i prof. F. Sherit ‘Popullsia e botës’, Tiranë, më 2006, faqe 36-37.

Duke filluar që prej fundit të shekullit të 18 me revolucionin industrial, popullsia po përjeton hopin II. Këtë herë 10-fishimi i popullsisë u arrit për 250 vjet dhe jo për 1000 vjet siç u arrit në hopin I, pra 4 herë më shpejt. Popullsia e botës në vitin 1800 numëronte mbi 900 milionë banorë dhe dyfishimi i saj u bë në vitin 1920. Rritja e popullsisë në vitet 1800-2100 paraqitet në tabelën 4.3.

Tabela 4.3 Rritja e numrit të popullsisë në vitet 1800-2100 (në milionë)

Vitet evlerësimit	Bota Gjithsej	Vendet e zhvilluara 1)	Vendet në zhvillim 2)
1800	912	200	712
1850	1.131	302	829
1900	1.590	510	1.079
1950	2.521	812	1.709
2000	6.056	1.370	4.630
2011	7.000	1.330	5.670
2030	8.000	...	...
2050	9.150	1.275	7.875
2075	11.000	...	...
2100	12.000	...	...

Burimi: Përpunim i të dhënave nga botimi i prof. F. Sherit “Popullsia e botës”, Tiranë, më 2006, f. 46 si dhe studimi i dr. Hans Rosling, i paraqitur në librin “Forca e faktit”.

Në vitin 1950, nga 2.5 miliardë banorë që kishte bota, rreth 800 milionë jetonin në Europë, Amerikën e Veriut, Japoni, Rusi, Australi e Zelandën e Re, të cilat kishin ritmet më të ulëta të rritjes së popullsisë. Krahastuar me pjesën tjetër të botës, popullsia e tyre ishte afërsisht në raport 1 me 2.

Ndërkohë që janë dashur shumë miliona vjet që njerëzimi të arrinte në një miliard banorë, nuk u deshën as 250 vjet për të arritur miliardin e dytë, 40 vjet për miliardin e tretë, 15 për miliardin e katërt, 13 për të pestin dhe 12 për miliardin e gjashtë në vitin 2000. Miliardi i shtatë është arritur në vitin 2011 dhe i teti pas 11 vjetësh të tjerë, d.m.th. në vitin 2022.

Sipas parashikimeve të bëra, në vitin 2050 popullsia e botës mendohet të kalojë mbi 9 miliardë banorë. Rritja e popullsisë së botës e në veçanti e asaj të Europës në shekullin e 19 i lejoi kontinentit të vjetër të rrisë mjaft peshën specifike të tij në popullsinë botërore e të shtrihet gjerësisht edhe tej kontinentit, veçanërisht në Amerikën e Veriut dhe atë të Jugut si pasojë e emigracionit. Sot, kur në disa vende të Europës Perëndimore

dhe Amerikës së Veriut po arrihet në rritjen zero dhe në disa prej tyre në pakësimin e numrit të popullsisë, popullsia e vendeve në zhvillim vazhdon të rritet me ritme të larta.

Rritja demografike është veçanërisht e dukshme në qytete, popullsia e të cilave shtohet jo vetëm nga shtesa natyrore, por edhe si pasojë e emigracionit të popullsisë fshatare drejt qytetit, një fenomen masiv ky për shumë vende të botës. Kështu, sot ka një kontrast të madh ndërmjet vendeve të industrializuara dhe atyre që janë në zhvillim. Në vitin 1900 popullsia ishte e ndarë në raportin 1/3 me 2/3 midis vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim. Procesi i diferencimit të popullsisë u bë sidomos në 50 vjetët e fundit. Në vitin 2000 ajo arriti në 1/4, ndërsa në vitin 2050 mendohet të përbëjë rreth 1/7 e popullsisë së botës.

Urbanizimi i popullsisë në vitin 2011 arriti në 54 për qind, nga 31 për qind që ishte në vitin 1960 dhe në vitin 2050, parashikohet të arrijë në mbi 2/3, pra për 90 vjet ajo rritet 2,5 herë.. Në vendet e industrializuara është arritur pothuajse plotësisht procesi i urbanizimit duke arritur në vitin 2011 mbi 80 për qind popullsi qytetare. Në vitin 2023 janë 10 vende që e kanë këtë tregues mbi 90 për qind. Në vitin 1950 në grupin e qyteteve të mëdha me mbi 10 milionë banorë numëroheshin vetëm 2, Nju Jorku dhe Londra kurse 1985 numërohen 18 si: Tokio, Nju Jorku, Meksiko, Los Anxhelos, Kalkutë etj. Në fund të shekullit (viti 2000) ishin 25 qytete të tillë të kryesuar nga Meksiko (me më tepër se 30 milionë banorë), San Paulo, Shangai, Pekini, Tokio, Nju Jorku me mbi 20 milionë banorë etj. Ndërsa tani numri i tyre ka arritur në mbi 30 të tillë.

Lëvizjet e popullsisë nga fshati në qytet me përmasa të mëdha krijojnë anomali në strukturat demografike të këtyre qyteteve, aq më tepër që popullsia e shpërngulur përbëhet kryesisht nga moshë të reja, të afta për punë. Kjo çon në një mbipopullim të këtyre moshave, shton të papunët dhe krijon shpërpjesëtime ndërmjet gjinive sidomos në grupmoshat 20-29 vjeç.

Proceset aktuale të integritimit popullsi-zhvillim për popullsinë e vendeve të Europës Perëndimore kanë sjellë edhe një shkallë të lartë të plakjes së saj. Një tregues i plakjes së popullsisë së këtyre vendeve është raporti i popullsisë nën moshën 20 vjeç me atë mbi 60 vjeç, i cili aktualisht është 1 me 3. Kjo situatë kushtëzon pakësimin e ofertës së krahut të lirë të punës, fëmijëve dhe punëtorëve të pakualifikuar, duke nxitur tërheqjen e emigrantëve nga vendet e tjera.

Në botë rreth 55 për qind e popullsisë ose 2.7 miliardë banorë jetojnë aktualisht me më pak se 2 dollarë në ditë, ndërsa 22 për qind e saj ose 1.3 miliardë banorë me më pak se 1 dollar. Rritja e shkallës së analfabetizmit është një dukuri tjetër, sidomos në vendet në zhvillim. Është shumë shqetësuese, sot në botë janë mbi 1,5 miliardë analfabetë. Pra, $\frac{1}{4}$ e popullsisë nuk di shkrim e lexim, ndërsa mbi 100 milionë fëmijë s'kanë mundësi ekonomike të shkollohen.

5. Ndryshimet e mëdha numerike të popullsisë në botë dhe ekuilibrat demografikë në shkallë vendi dhe në shkallë botërore


E vërteta është se popullsia e botës është rritur dhe vazhdon të rritet. Madje me ritme shumë të shpejta. Sipas studimeve të OKB-së, në 15 vitet e ardhshme pritet që asaj t'i shtohen edhe 1 miliard njerëz të tjerë. Ndërsa në fund të shekullit mendohet që ajo të arrijë në 12 miliardë banorë. Ky është një fakt i vërtetueshëm dhe jo një perceptim i gabuar. Megjithatë, nuk mund të themi se popullsia e botës vetëm po rritet. Fjala “vetëm” nënkupton se nëse nuk marrim ndonjë masë drastike, popullsia do të rritet pambarimisht. Pyetjet që mund të shtrohen janë: A duhet të ketë njëfarë caku numri i njerëzve që mund të jetojnë në këtë planet, apo jo? Kështu do të vazhdojë rritja e popullsisë edhe në të ardhmen? Vetëm rritje do të regjistrohen në numrin e saj?

Përgjithësisht njerëzit kanë frikë kur shohin një rritje kaq të vrullshme, ngaqë e dinë se burimet e planetit janë të kufizuara. Mirëpo nga sa duket, popullsia e botës vetëm po rritet me një shpejtësi shumë të lartë. Madje njerëzit, siç thotë dr. Hans Rosling në librin e tij “Forca e faktit”, e perceptojnë këtë rritje të paraqitur grafikisht me një **zgjatim drejtvizor**, siç paraqitet në *figurën 5.1*.

Sigurisht, ai është shqetësues. Megjithatë, në jetën moderne nuk është mirë t'i besojmë verbërisht kësaj intuete drejtvizore. Parashikimi intuitiv i rritjes drejtvizore është dukshëm i gabuar në këtë rast. Është dukshëm i gabuar sepse të gjithë e kemi shumë të qartë ritmin e rritjes, sepse e dimë që rritja nuk vazhdon pareshtur, si në *figurën 5.1*.


Megjithatë, kur kemi të bëjmë me një temë të panjohur, është shumë e vështirë të mos biem pre e instinktit të rritjes drejtvizore. Specialistët e popullsisë të OKB-së parashikojnë një rritje si në *figurën 5.2* që vijon:

Figura 5.1 Rritja e popullsisë së botës në 800 vitet e fundit dhe parashikimi i rritjes së saj deri në vitin 2100 (duke e perceptuar si zgjatim drejtvizor)



Burimi: Hans Rosling, libri 'Forca e faktit', botim Prishtinë -Tiranë, 2019, faqe 96.

Figura 5.2 Parashikimi i rritjes së popullsisë së botës deri në vitin 2100 (sipas llogaritjeve të specialistëve të popullsisë së OKB-së)



Burimi: Hans Rosling, libri 'Forca e faktit', botim Prishtinë -Tiranë, 2019, faqe 98.

Numri i popullsisë së botës në vitin 2019 ishte 7.6 miliardë banorë dhe po ndryshon me shpejtësi. Më 15 nëntor 2022 ajo arriti në 8 miliardë banorë.¹⁾ Megjithatë, ritmi i kësaj rritjeje ka filluar të ngadalësohet. Specialistët e OKB-së janë shumë të sigurt se do të vazhdojë të ngadalësohet në dekadat në vazhdim. Ata besojnë se vija do të rrafshohet nga fundi i shekullit, kur

popullsia të ketë arritur 11 miliardë banorë. Për ta kuptuar më mirë trajtën e vijës së numrit të popullsisë, duhet të kuptojmë burimin e rritjes së saj, që siç dihet është numri i fëmijëve.


Kombet e Bashkuara kanë parashikuar se në vitin 2100 popullsia e botës do të jetë rritur me 4 miliardë banorë. Por si do të rritet, do të ketë më shumë fëmijë (nën moshën 15 vjeç), do të ketë më shumë të rritur: (mosha 15-74 vjeç), apo do të ketë më shumë të moshuar: (mosha 75 vjeç e lart).

Sot në botë numërohen 2 miliardë fëmijë të moshës nga 0 në 15 vjeç. Sipas studimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, po aq mendohet të jetë numri i fëmijëve edhe në vitin 2100. Pra, **nuk pritët ndonjë rritje e mëtejshme e tyre.**

Numri i fëmijëve që do të lindin në të ardhmen është e dhëna më e rëndësishme për të bërë parashikime mbi popullsinë e botës. Për këtë arsye, ky numër ka rëndësi jetike për çdolloj debati lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm. Nëse gabojmë me këtë numër, atëherë do të gabojmë në shumë llogaritje të tjera.

Është e kuptueshme, ekspertët janë të bindur se popullsia do të vazhdojë të rritet kryesisht ngaqë do kemi më shumë të rritur (mosha 15-74 vjeç), pra, do të shtohet disi popullsia në moshë madhore. Nuk do të shtohen fëmijët dhe as të moshuarit. Në *figurën 5.3* paraqitet e njëjta rritje e popullsisë që pamë në *figurën 5.2*. Ndryshimi qëndron vetëm sepse në *figurën 5.3* është bërë ndarja e numrit ndërmjet fëmijëve dhe të rriturve:

Figura 5.3 Parashikimi i rritjes së popullsisë së botës deri në vitin 2100
(sipas llogaritjeve të specialistëve të popullsisë të OKB-së)



Burimi: Hans Rosling, libri 'Forca e faktit', botim Prishtinë -Tiranë, 2019, faqe 99.


Po të shihet me kujdes vija që paraqet numrin e fëmijëve në moshën 0-14 vjeç pas rritjes që kanë pësuar në shkallë botërore në vitet 1950-2000, pas kësaj periudhe ai fillon përsëri të rrafshohet. Kjo tashmë, pas viti 2000, ka filluar të ndodhë. Specialistët e OKB-së raportojnë një fakt që po ndodh. Ndryshimi rrënjësor që nevojitet për frenimin e shtimit të vrullshëm të popullsisë është ndalimi i rritjes së numrit të fëmijëve. Në të vërtetë kjo është ajo që po ndodh, numri i fëmijëve nuk po rritet dhe kjo ndodh sepse ka një rënie të pabesueshme të numrit të foshnjave të lindura nga çdo grua. Nëse në vitin 1948 një grua sillte në jetë mesatarisht pesë fëmijë, pas vitit 1965 ky numër filloi të binte si kurrë më parë. Gjatë 50 viteve në vazhdim ra pa pushim derisa arriti mesataren 2.5.

Ky ndryshim drastik ndodhi edhe pse miliarda njerëz dolën nga varfëria e skajshme. Shumica e tyre vendosën të bënin më pak fëmijë. Ata nuk kishin më nevojë për të pasur shumë fëmijë për të punuar ngastrën e tokës së familjes. Përveç kësaj, vdekshmëria e fëmijëve nuk përbën më kërcënim serioz për çiftet, që të mbeteshin pa fëmijë. Nga ana tjetër, si gratë ashtu edhe burrat tani janë më të arsimuar. Ata synojnë që fëmijët e tyre të ushqehen dhe të shkollohen më mirë, pra, të investojnë më shumë për ta. E vetmja rrugëzgjdhje për ta ishte të bënin më pak fëmijë. Në praktikë ky synim nuk ishte i vështirë për t'u realizuar, falë shpikjes së kontraktivëve modernë që u jepnin prindërve mundësinë të kishin më pak fëmijë, pa qenë e nevojshme të bënin ndryshime në marrëdhëniet seksuale.

Rënia e numrit të foshnjave të lindura për çdo grua do të vazhdojë edhe në të ardhmen, për sa kohë që njerëzit të vazhdojnë të dalin nga varfëria e skajshme. Gratë e arsimuara dhe përdorimi i kontraktivëve bashkë me edukatën seksuale do të vazhdojnë të përhapen edhe më gjerësisht. Nuk ka nevojë për asnjë masë drastike. Mjafton të qëndrojmë në këtë rrugë që ka nisur. Por, sidoqoftë, nuk është e mundur të parashikohet me saktësi rënia e lindshmërisë në të ardhmen. Kjo varet nga shpejtësia me të cilën do të ndodhin ndryshimet që përmendëm. Gjithsesi, numri i lindjeve në vit në shkallë botërore ka reshtur së rrituri. Kjo do të thotë se periudha e rritjes së popullsisë do të mbarojë shpejt. Atëherë shtrohet pyetja tjetër, si do të rritet popullsia e botës me 4 miliardë banorë?

Le t'i referohemi një grafiku tjetër të ndërtuar nga studiuesi Hans Rosling, i cili në librin e tij "Forca e faktit" e paraqet popullsinë e botës të ndarë në disa grupmosha në vitin 2015 dhe çdo 15 vite, për 60 vjet më pas.

Figura 5.4: Parashikimi i rritjes së popullsisë së botës sipas grupmoshave deri në vitin 2075 (sipas llogaritjeve të specialistëve të popullsisë të OKB-së)



Burimi: Hans Rosling, libri 'Forca e faktit', botim Prishtinë -Tiranë' 2019, faqe 101.

Në anën e majtë të grafikut shohim moshat e 7 miliardë njerëzve që jetojnë në vitin 2015. Prej tyre, 2 miliardë u përkasin moshave nga 0 në 15 vjeç; 2 miliardë në moshat nga 15 në 30 vjeç dhe nga 1 miliard i gjejmë në grupmoshat 30-45 vjeç, 45-60 vjeç dhe 60-75 vjeç.

Në vitin 2030 do të ketë 2 miliardë njerëz në grupmoshën 0-15 vjeç. Të gjithë të tjerët do të kenë ecuar në moshë. Ata që sot janë në grupin 0-15, do t'i gjejmë në grupin e 15-30-vjeçarëve në vitin 2030. Ndërsa personat që sot ndodhen në grupin 15-30 do të jenë 2 miliardë 30-45-vjeçarët e vitit 2030. Për momentin në botë jetojnë vetëm 1 miliard persona të moshës 30-45.

Kështu pra, pa qenë e nevojshme rritja e numrit të fëmijëve të lindur dhe e jetëgjatësisë në përgjithësi, do të kemi 1 miliard të rritur më shumë.

Për tre breza me radhë ky model do të përsëritet. Në vitin 2045, 2 miliardë personat e grupmoshës 30-45 do të jenë tashmë 45-60-vjeçarë dhe do të kemi 1 miliard të rritur më shumë. Në vitin 2060, 2 miliardë personat e grupmoshës 45-60 do të jenë nga 60-75 vjeç. Përsëri do të kemi 1 miliard të rritur. Vini re çfarë ndodh. Që prej 2060-s çdo brez, të cilit i përkasin 2 miliardë njerëz, do të zëvendësohet me një tjetër brez që numëron po 2 miliardë. Duke ndodhur kjo, rritja e vullshme e popullsisë do të ndalojë.

Rritja e lartë e popullsisë nuk do të ndodhë për shkak të rritjes së numrit të fëmijëve, por sepse të moshuarit do të jetojnë më gjatë. Në të vërtetë, specialistët e OKB-së parashikojnë se në vitin 2100 pritsshmëria e jetëgjatësisë në botë do të jetë rritur me rreth 11 vjet. Në këtë kohë 1 miliard banorë do t'i shtohen numrit të të moshuarve duke e shpënë atë

në 11 miliardë. Rritja e popullsisë do të ndodhë kryesisht sepse fëmijët e sotëm do të rriten dhe do ta “mbushin” grafikun me 3 miliardë të rritur shtesë. Efekti i “mbushjes” do të shtrihet në tre breza. Sigurisht ky është një lloj shpjegimi në një këndvështrim të përgjithshëm. Sepse shumë njerëz vdesin para moshës 75-vjeçare dhe shumë prindër bëhen me fëmijë pas moshës 30-vjeçare. Megjithatë, edhe përfshirja e këtyre fakteve nuk e ndryshon tablonë e përgjithshme.


Kjo ndodh sepse sigurohet **një ekuilibër me natyrën**. Kur një popullsi e caktuar nuk rritet për një periudhë të gjatë kohe, do të thotë se çdo brez është i barabartë për nga përmasat me brezin paraardhës. Për mijëra vjet deri në vitin 1800 vija e rritjes së popullsisë ka qenë e rrafshët dhe popullsia jetonte në ekuilibër me natyrën. Deri në vitin 1800 gratë lindnin mesatarisht nga 6 fëmijë. Kjo do të thotë që popullsia duhej të ishte rritur nga brezi në brez. Por shohim se ajo ka pësuar një rritje të vogël ose pothuajse ka qëndruar në vend. *“Kujtoni eshtrat e fëmijëve nëpër varret e vjetra, - theksonte dr. Hansi, - mesatarisht katër nga gjashtë fëmijë vdisnin para se ta arrinin moshën për t’u bërë vetë prindër. Vetëm dy mbijetonin për ta shtuar brezin pasardhës. Nëse kishte një ekuilibër, kjo nuk do të thotë se njerëzit jetonin në ekuilibër me natyrën. E vërteta është shumë më ndryshe dhe shumë më e shëmtuar, njerëzit vdisnin në ekuilibër me natyrën”*.

“Sot njerëzimi, - thekson Hansi më tej, - po i afrohet dalëngadalë ekuilibrit. Numri i prindërve ka reshtur së rrituri. Ky lloj ekuilibri është shumë më ndryshe nga ai i hershmi. Është shumë më i mirë. Zakonisht prindërit bëjnë nga dy fëmijë dhe asnjëri nuk u vdes. Për herë të parë në historinë e njerëzimit ne jetojmë në ekuilibër”.²⁾

Popullsia është rritur nga 1.5 miliardë që ishte në vitin 1900 në 6 miliardë në vitin 2000. Kjo ka ardhur si rezultat i ndryshimit shumë të madh nga njëri skaj i peshores në tjetrin, gjatë shekullit të njëzetë. Kjo është e vetmja periudhë në historinë e njerëzimit gjatë së cilës një çift prindërisht lundrin mesatarisht dy fëmijë, të cilët jetojnë aq sa për t’u bërë vetë prindër.

2) Hans Rosling, libri “Forca e faktit”, botim Prishtinë -Tiranë, 2019, faqe 103.

Figura 5.5 Parashikimi i rritjes së popullsisë së botës dhe ekuilibrat e saj sipas dy grupmohave në vitin 1800-2100
(sipas llogaritjeve të specialistëve të popullsisë të OKB-së)



Burimi: Hans Rosling, libri 'Forca e faktit', botim Prishtinë -Tiranë, 2019, faqe 104.

Periodha e prishjes së ekuilibrit është arsyeja që dy brezat më të rinj sot janë shumë më të lartë në numër se të tjerët. Periodha e mosbalancimit të ekuilibrit është arsyeja e mbipopullimit. Megjithatë, mund të thuhet se ekuilibri i ri është arritur me rritjen e ngadalësuar të numrit të lindjeve. Nëse niveli i varfërisë vazhdon të ulet, ndërkohë që edukata seksuale dhe përdorimi i kontraktivëve fitojnë gjithnjë e më shumë terren, popullsia e botës do të vazhdojë të rritet me shpejtësi deri në momentin që pasoja e pashmangshme e mbipopullimit të ketë përfunduar.

Le të shohim shkurt se si ka ndikuar varfëria e skajshme në numrin e madh të anëtarëve në një familje. Prindërit që jetojnë në varfëri të skajshme kanë nevojë për shumë fëmijë pikërisht për arsyet që u përmenden më sipër, d.m.th. për të punuar dhe për të mos mbetur pa fëmijë, nëse disa sëmuren dhe vdesin. Pikërisht në vendet me vdekshmërinë më të lartë të fëmijëve: Somali, Çad, Mali dhe Nigeri shënohet lindshmëria më e lartë, me pesë deri në tetë fëmijë për çdo grua. Kur prindërit janë të sigurt që fëmijët e tyre do të mbijetojnë, kur fëmijët nuk u nevojiten më për të punuar dhe kur gratë janë të arsimuara dhe kanë njohuri dhe mundësi për përdorimin e kontraktivëve, pavarësisht besimit dhe veçorive kulturore, si gratë ashtu edhe burrat parapëlqejnë të kenë më pak fëmijë që të mund t'i shkollojnë dhe edukojnë.

Çdo brez i mbajtur në varfëri të skajshme do të prodhojë një numër më të madh pasardhësish. E vetmja mënyrë e provuar për të mbajtur nën

kontroll rritjen e popullsisë është të zhdukim varfërinë e skajshme dhe ta përmirësojmë cilësinë e jetesës së njerëzve duke përfshirë arsimimin dhe aplikimin e masave mbrojtëse ndaj shtatzënisë së padëshiruar, si përdorimin e kontraceptivëve etj. Pjesa më e madhe e prindërve në mbarë botën po zgjedhin të lindin më pak fëmijë. Kjo prirje është përhapur në të gjithë botën dhe ka ulur ngado vdekshmërinë e fëmijëve.

Këto masa do të bëjnë që të realizohet sa më shpejt tranzicioni demografik për çdo vend të veçantë, si dhe në shkallë botërore, duke i kaluar vendet në ekuilibra të rinj e modernë të popullsisë si dhe kalimin në ekuilibër të popullsisë botërore duke na e “larguar frikën” nga rritja e pareshtur e popullsisë së botës. Kështu do të luftohet koncepti që “popullsia e botës vetëm rritet e rritet pareshtur”, perceptim i cili krijohet nga grafiku i një vije të drejtë, që siç e ka përcaktuar dr. Hans Rosling, është “grafiku më i frikshëm që kam parë ndonjëherë”,³⁾ duke e quajtur atë thellësisht të gabuar.

Literatura:

1. Sheri, Fiqri - *Popullsia e botës. Botim i albPAPER, Tiranë, 2006.*
2. Telo, Ilia- *Demografia-Tiranë, 2008.*
3. Hans Rosling libri “*Forca e faktit*”, botim Prishtinë -Tiranë, 2019.
4. Dumani B.; Stringa A. *Elemente të demografisë, Tiranë, 1997.*
5. Koçi, Nevruz - *Demografia, Tiranë, 2008.*
6. *World Population Ageing 2007, Unitet National New York, 2007.*
7. Hana L.& Telo I. *Tranzicioni në Shqipëri: Arritje dhe sfida. Tiranë, 2005.*
8. Telo, Ilia - *Moshimi, shteti dhe shoqëria. Tiranë, 2016.*
9. *Rezultatet e censusit të popullsisë dhe banesave 2011. Botim Instat, Tiranë, 2012.*
10. *Rezultatet e studimit për prognozimin e popullsisë së Shqipërisë për vitet 2011-2060.*
11. *Revista - “Demografia”, vitet 1998-2023, botim i Shoqatës së Demografëve të Shqipërisë.*
12. *UNFPA - State of World population - 2022.*
13. *UNDP - National Human Development Report - 2022.*
14. *Vjetarë statistikorë të OKB-së, EUROSTAT-it, INSTAT-it etj.*

3) Hans Rosling, libri “Forca e faktit”, botim Prishtinë -Tiranë, 2019, faqe 90.

SFIDAT E GRUPMOSHAVE TË LARTA NË TREGUN E PUNËS NË KUSHTET E DIGJITALIZIMIT

*Prof. Dr. Merita XHUMARI, Professore e Politikave Publike,
Fakulteti i Shkencave Sociale
Universiteti i Tiranës
meritax22@gmail.com*

*Lisian ROSENI, student doktrate në Shkenca Politike,
Fakulteti i Shkencave Sociale
Universiteti i Tiranës
rosenilisian@gmail.com*

ABSTRAKT

Artikulli synon të evidentojë një nga sfidat aktuale që ndeshin grupmoshat e larta në tregun e punës në kushtet e ndryshimeve demografike, sociale, kulturore dhe të avancimit të teknologjisë. Në këto fenomene dinamike e komplekse po rritet pesha specifike e grupmoshave të larta në tregun e punës, prandaj del domosdoshmëria e politikave aktive të tregut të punës përmes targetimit të punëtorëve të grupmoshave të larta në agjendën e digjitalizimit. Sot rreth 15 për qind e grupmoshës 65+ vazhdojnë të jenë aktivë në tregun e punës dhe ky nivel po vjen në rritje. Punësimi në këtë grup pati një rritje vjetore me gati 50 për qind në tetor-dhjetor 2023, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Përballë këtij fakti dhe rritjes graduale të moshave të daljes në pension, sistemet tradicionale të arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri kanë nevojë të përshtaten për të përmbushur nevojat e këtij grupi për sa i përket mësimin të aftësive digjitale dhe trajnimit gjatë gjithë jetës.

Pyetja është se si po i përgjigjen politikat publike ndikimit të digjitalizimit te punëtorët e moshuar; për t'i mbështetur ata në tregun digjital të punës dhe për të siguruar që ata të mund të përfitojnë nga mundësitë që sjell transformimi digjital? Hyrja në rrugën drejt integritit me Bashkimin European e ka vendosur Shqipërinë drejt rritjes

ekonomike të qëndrueshme dhe digjitalizimit. Politikat e zhvillimit të kapitalit njerëzor në kushtet e digjitalizimit po rriten nga strategjitë e zhvillimit të burimeve njerëzore në nivel organizate apo biznesi deri te strategjitë në nivel kombëtar e global. Shqipëria po zbaton Planin Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale, Broadband 2020-2025, i cili përmban mundësi të mëdha edhe për punëtorët e moshuar për të mësuar dhe praktikuar aftësitë digjitale, duke siguruar përdorimin e WiFi në 50 për qind të mjediseve publike në qytet dhe fshat. Përdoruesit e internetit po rriten në vendin tonë nga 73.5 për qind në 2019 në 76.3 për qind të popullsisë në 2022. Strategjia “Axeenda Digjitale e Shqipërisë, 2022-2026” shërben si bazë për integrimin e teknologjive inovative si blockchain, inteligjencën artificiale dhe mësimin e makinerive. Kjo politikë synon gjithashtu të promovojë përfshirjen e punëtorëve të moshuar në epokën digjitale.

ABSTRACT

The article aims to highlight one of the current challenges faced by older workers in the labor market in terms of demographic, social, cultural changes and technological advancement. In these dynamic and complex phenomena, the specific weight of older workers in the labor market is increasing, therefore the necessity of an active labor market policy through the targeting of older workers in the digitalization agenda emerges. Today, about 15 percent of the 65+ age group continues to be active in the labor market, and this level is increasing. Employment in this group had an annual increase of almost 50 percent in October-December 2023, compared to the same period a year ago. Faced with this fact and the gradual increase in retirement ages, the traditional education and vocational training systems in Albania need to be adapted to meet the needs of this group, especially in terms of learning digital skills and lifelong training.

The question is, how are public policies responding to the impact of digitization on older workers to support them in the digital labor market that they can benefit from the opportunities that digital transformation brings? Entering the path towards integration with the European Union has set Albania towards sustainable economic growth and digitization. Human capital development policies in the conditions of digitalization are growing from human resource development strategies at the micro organizational level to the macro national and global strategies. Albania is implementing the National Plan for Sustainable Development of Digital Infrastructure, Broadband 2020-2025, a plan that holds great potential for older workers to learn and practice digital skills by prioritising the provision of free WiFi in 50 percent of the largest public spaces in all cities and villages. Meanwhile, the internet users are increased from 73.5 percent in 2019 to 76.3 percent of the population in 2022. Moreover, the “Digital Agenda of Albania, 2022-2026” Strategy serves as the foundation for simultaneously increasing the integration of innovative technologies like blockchain, artificial intelligence, and machine learning. This policy aims also will promote the inclusion of older workers in the digital era.

1. Hyrje

Aktualisht në qendër të debatit publik është vendosur përsëri reforma e sistemit të pensioneve për t'u garantuar grupmoshave të larta një jetë dinjitoze. Ndërkohë që një nga komponentët e reformës ka qenë prirja për të zgjatur jetën e punës duke rritur moshën ligjore të daljes në pension, sfidat sesi do ta përballojnë konkurrencën e tregut këta punëtorë të grupmoshave të larta që të mbijetojnë deri në moshën 65-vjeçare e më vonë 67-vjeçare, kjo mbetet një politikë që nuk ka marrë vëmendjen e duhur nga shoqëria. Deri më sot, sipas shifrave të INSTAT-it, rreth 15 për qind e grupmoshës 65+ vazhdojnë të jenë aktivë në tregun e punës për rrethana sa individuale, familjare aq edhe profesionale. Referuar teorive mbi ciklin e jetës, ky fakt lidhet si me kërkesën e sektorëve të caktuar të ekonomisë, eksperiencat e jetës, profesionin, rezidencën, ku zakonisht Tirana ofron mundësi më të mëdha, krahasuar me qytetet e tjera të vendit, po aq edhe me nivelin e edukimit. Ka ardhur koha që këto përpjekje individuale të përkthehen në politika publike për të nxitur qëndrimin sa më të gjatë aktiv në një treg që ka dinamika të shpejta.

Europa ka vite që i shtron paralelisht këto alternativa zgjidhjesh për të përballuar sfidat e moshimit aktiv, duke lidhur politikat e pensioneve me politikat aktive të tregut të punës. Në këto 10 vitet e fundit, vetëm nga fondet për kërkim shkencor të BE-së ka pasur disa projekte si COST Action IS1409 “Gender and Health Impact of Policies on Extending Working Life”, apo “Cost Action 21107 “Work inequalities in later life redefined by digitalization” (DIGI-net) ku edhe kërkuesit shqiptarë janë bërë pjesë e këtyre iniciativave për shkëmbimin e përvojave mes studiuesve europianë. Aktualisht këto politika të moshimit aktiv mund të kenë një integrim më të mirë edhe në vendin tonë, përfshirë aspektet e politikave të pensioneve, të tregut të punës, të edukimit dhe formimit profesional etj., pasi ato ndodhen sot nën të njëjtën ombrellë institucionale, atë të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Në këto fenomene dinamike e komplekse të tregut të punës fleksibël, ku po rritet pesha specifike e grupmoshave të larta, edhe për shkak të ndryshimeve të strukturës demografike të popullsisë, del domosdoshmëria që të sigurohet krahas rritjes së moshës ligjore të daljes në pension, edhe një qëndrueshmëri e këtyre forcave aktive në tregun e punës përmes targetimit të punëtorëve të grupmoshave të larta në agjendën e digjitalizimit.

2. Rritja e grupmoshës së lartë në tregun e punës

Për shkak të plakjes së popullsisë dhe nevojave në rritje të tregut të punës për fuqi punëtore, numri i pensionistëve që punojnë është duke u rritur nga viti në vit. Në 2023, INSTAT-i raporton se ka një tkurrje të numrit të të rinjve të punësuar dhe një rritje të punësimit të personave në moshë pensioni mbi 65 vjeç. Punësimi në këtë grup pati një rritje vjetore me gati 50 për qind, me pothuajse 82 mijë persona që ishin në punë në tetor-dhjetor 2023. Në të njëjtën periudhë të një viti më parë, në tetor-dhjetor 2022 ishin 54,5 mijë persona të punësuar, pra 27 mijë persona më shumë në moshë pensioni mbi 65 vjeç (INSTAT, 2023). Sipas të dhënave nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, në vitin 2023 ishin 1,484 pensionistë të vetëpunësuar në sektorin privat, të cilët paguanin çdo muaj kontribute të sigurimeve shoqërore (Ministria e Financës dhe Ekonomisë, 2023.)

Në vitin 2020, kur tregu i punës u vu në vështirësi për shkak të pandemisë COVID-19, numri i pensionistëve që punonin u rrit me 1.2 për qind krahasuar me tremujorin e parë të 2019. Arsytet për këtë rritje janë të shumta që nga pensionet e ulëta, rritja e jetëgjatësisë, puna përmes internetit, përdorimi i teknologjisë deri tek emigrimi i vazhdueshëm i të rinjve, të cilat të gjitha së bashku po ndikojnë në zgjatjen e qëndrimit aktiv në tregun e punës të grupmoshave të larta në Shqipëri.

Sipas një projeksioni të popullsisë, në 30 vitet e ardhshme grupmosha mbi 65 vjeç do të rritet me 48 për qind; nga 420 mijë në 2020 në 623 mijë në vitin 2050, ndërsa popullsia e moshës 80 vjeç e lart do të rritet me 2.6 herë nga 82 mijë në 2020 në 214 mijë në 2050 (ILO, 2022.) Fluksi i individëve të moshuar në tregun e punës do të ushtrojë presion mbi burimet ekzistuese të trajnimit dhe arsimit. Aktualisht sistemet tradicionale të arsimit në Shqipëri nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e këtij grupi, veçanërisht për sa i përket mësimi të aftësive digjitale dhe trajnimit përgjatë gjithë jetës.

Përmirësimi i aftësive të punëtorëve është një element kyç në përmirësimin e perspektivave të tyre të punësimit në të tashmen dhe të ardhmen. Për këtë qëllim zbatohen politika të zhvillimit të burimeve njerëzore si strategji e brendshme e çdo organizate, si programe trajnimi për grupmoshat e larta, ndarje e përvojave në vendin e punës etj., deri te strategjitë në nivel kombëtar dhe global. Një nga synimet e Planit Kombëtar të Veprimit mbi Moshimin 2020-2024 në Shqipëri ka qenë “Promovim i rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, punësim dhe

punë për të gjithë” (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 2019).

Grupmoshat e larta janë ndër grupet më të rrezikuara në tregun e punës, veçanërisht kur ka një sërë faktorësh ndikues, si niveli i ulët i arsimit, mungesa e aftësive dhe kompetencave që janë në ndryshim të vazhdueshëm për shkak të avancimit të teknologjive, kompleksitetit të proceseve të punës, rritjes së konkurrencës etj. Shpesh koncepti i të mësuarit të vazhdueshëm, së bashku me vitet e edukimit apo llojin e aftësive përkatëse, e bën një individ të moshës së tretë më të aftë për t’u përshtatur ndaj ndryshimeve teknologjike. Prosesi i të mësuarit afatgjatë krijon një ndjesi kualifikimi dhe vetëmjaftueshmërie sociale që gjenden jashtë një sistemi tradicional shkollor/universitar (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 2021.)

3. Ndikimi i digjitalizimit te punëtorët e moshuar

Shqipëria ka krijuar ekiye të centralizuara përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe koordinimin e të gjithë ciklit jetësor të zhvillimit dhe zbatimit të zgjidhjeve inovative GovTech (Banka Botërore, 2021; 2022). Megjithatë, ajo ka përqindjen më të ulët të personave të grupmoshës 16 - 74 vjeç me aftësi bazë digjitale në Europë, me vetëm 24 për qind të popullsisë që zotëron këto aftësi (Eurostat, 2022). Kjo përbën një sfidë të rëndësishme për punëtorët e moshuar, veçanërisht për gratë e moshuara, të cilat janë një pjesë e rëndësishme e fuqisë punëtore dhe mund të kontribuojnë ndjeshëm në ekonomi. Është thelbësore të pranohet se ekzistojnë barrierat strukturore që i pengojnë këto grupe të fitojnë akses dhe aftësi digjitale, duke përfshirë çmimin e rrjetëzimit dhe boshllëqet fizike në infrastrukturën e rrjeteve digjitale. Këto mospërputhje në aksesin dhe përdorimin e teknologjisë në shkollë dhe shtëpi krijojnë pabarazi që fillojnë herët në jetë.

Për shkak se shumë punëtorë të moshuar thjesht nuk u rritën duke përdorur dhe përshtatur teknologjitë më të reja, mungesa e besimit në teknologji është një arsye e përmendur shpesh pse punëtorët e moshuar priren të kenë aftësi më të ulëta digjitale (Burnay et al., 2022). Pandemia e COVID-19 detyroi shumë punëtorë të moshuar shqiptarë të përdorin teknologjinë për të bashkëvepruar me familjen dhe për t’u përfshirë në ngjarje të tjera sociale. Megjithatë, kur bëhet fjalë për punësimin (aktual ose të ardhshëm), ka të ngjarë që individët e moshuar mund të përballen me izolim si rezultat i njohurive të pamjaftueshme të TI-së, mungesës së

aksesit në TI dhe çështjeve të lidhjes, veçanërisht në rajone të largëta dhe malore. Për më tepër, nëse nismat e automatizimit dhe kompjuterizimit nuk marrin parasysh nevojat e punonjësve të moshuar, ata mund të bëhen edhe më të marginalizuar. Për të zhbllokuar potencialin e tyre, punëtorët e moshuar, qoftë burra, qoftë gra, kërkojnë fleksibilitet dhe mbështetje më të madhe për të përshtatur profilet e tyre profesionale me kërkesat e tregut në zhvillim.

Mbarëvajtja e tregut të punës është një faktor i rëndësishëm makroekonomik, ndaj ekonomitë e zhvilluara në vendet e BE-së i kanë kushtuar vëmendje përzgjedhjes së politikave të tregut të punës në vendet e tyre, me qëllim që ato të jenë sa më efektive. Arsimi dhe formimi profesional është një nga pasuritë më të vlefshme në vendet e zhvilluara të BE-së në fushën e politikave aktive të tregut. Në procesin për hartimin e këtyre politikave aktive të punësimit pasqyrohen elementet kryesorë që parashikohen në Strategjinë e Rishikuar të Kohezionit Social të Këshillit të Europës. Në këtë Strategji theksohet qasja për punësim për të gjithë dhe nxitja e një punësimi të denjë (punësim që respekton njeriun), si elemente thelbësore për kohezionin social.

4. Politikat ndaj përjashtimit social në tregun e punës

Me një kornizë të fortë dhe të qëndrueshme politikash, së bashku me mundësitë e digjitalizimit, Shqipëria ka mbështetur me sukses liderшипin e saj rajonal në ofrimin e shërbimeve dhe transformimin digjital (Raporti i Monitorimit Sigma, 2021.) Megjithatë, përfshirja digjitale e punëtorëve të moshuar shpesh anashkalohet, me mungesë të strategjive specifike të fokusuara në nevojat e tyre. Politikat e bazuara në evidenca kërkojnë studime të detajuara të tregut, krahas atyre tremujore që ofron INSTAT-i, që të dalin në pah sfidat e ndryshme me të cilat përballen punëtorët e moshuar, duke marrë parasysh faktorë të tillë si arsimi, njohuritë kompjuterike, kapaciteti njohës dhe të ardhurat. Për më tepër, ka ende nevojë për të adresuar rreziqet e reja që lidhen me dezinformimin, krimet kibernetike, sigurinë dhe privatësinë vetëm për këtë grup. Duke ofruar akses të përballueshëm në internet, pajisje dhe programe të edukimit digjital të përshtatura për punëtorët e moshuar, mund të mundësohet pjesëmarrja e tyre në botën digjitale, që ata të ruajnë pavarësinë e tyre, të përfshihen në aktivitete sociale dhe të përqafojnë mundësi të reja në tregun dinamik të punës.

Vala e digjitalizimit, e përshpejtuar nga pandemia, ka nxjerrë në pah nevojën për përfshirje digjitale për punëtorët e moshuar. Megjithatë, ka mungesë të strategjive specifike digjitale që synojnë punëtorët e moshuar në Shqipëri. Për të siguruar përfshirjen e punëtorëve të moshuar në transformimin digjital të Shqipërisë, është thelbësore që jo vetëm qeveria, por punëdhënësit, sindikatat dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile të kenë prioritet përmirësimin e njohurive të tyre digjitale. Strategjia tjetër për tregun e punës që do të ndjekë Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2019-2022 mund të ketë prioritet iniciativat e financimit për të mbështetur të moshuarit që të bëhen qytetarë digjitalë të aftë, duke u mundësuar atyre të përdorin internetin në mënyrë efektive, të angazhohen në shoqëri dhe të mbeten produktivë.

Sipas strategjisë së mëparshme, një fond i konsiderueshëm nga buxheti i shtetit ishte parashikuar për të mbështetur punëdhënësit që organizonin trajnime në vendin e punës. Ky fond synonte të nxiste rritjen e aftësive të nevojshme për punëkërkesit, me fokus të veçantë në grupmoshën mbi 50 vjeç. Gjithashtu, një tjetër synim ishte krijim i “universitetit të moshës së tretë”, që ishte një bashkëpunim mes institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile ku përgatiteshin kurse njëditore mbi tema të ndryshme me qëllim rritjen e pjesëmarrësve të grupmoshave të larta (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 2019). Megjithatë, ende nuk është e qartë nëse këto politika janë realizuar plotësisht dhe në çfarë mase popullsia e grupmoshave të mëdha ka përfituar nga këto trajnime për të fituar aftësi të reja teknologjike. Evaluimi i efektivitetit të këtyre politikave mbetet një çështje e rëndësishme për të ardhmen.

Përveç kësaj, ndërkohë që po vazhdojnë të rriten nivelet e aftësive të rinjve për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut digjital të punës, politikat e fundit duhet të përqendrohen gjithashtu në trajnimin real të punëtorëve të grupmoshave të larta. Duke njohur nevojat unike të punëtorëve të grupmoshave të larta dhe duke zbatuar strategji gjithëpërfshirëse që përfshijnë lidhje të përbalueshme, arsim digjital dhe mbështetje, Shqipëria mund të krijojë një të ardhme digjitale më gjithëpërfshirëse për të gjithë qytetarët e saj.

Në Samitin Social për Punë të Ndershme dhe Rritje në 17 nëntor 2017, institucionet e BE-së shpallën Shtyllën Europiane të Drejtave Sociale, e cila përcakton 20 parime dhe të drejta kryesore për të mbështetur konkurrencën e drejtë të tregut dhe mirëfunksionimin e tregut të punës, të strukturuar rreth tri çështjeve kryesore: mundësi të barabarta dhe qasje

në tregun e punës, kushte të drejta të punës dhe mbrojtje dhe përfshirje sociale.

5. Politikat e digjitalizimit në Shqipëri

E ardhmja e tregut të punës varet nga disa faktorë, duke përfshirë konkurrencën afatgjatë, zhvillimet demografike etj., por sot digjitalizimi është një nga shtytësit kryesorë të ndryshimeve në të ardhmen e parashikueshme. Në qendër të këtij zhvillimi është prodhimi dhe përdorimi i qarqeve logjike digjitale dhe teknologjive të tjera që rrjedhin prej tyre. Transformimi digjital është shfaqur si një faktor vendimtar në tregun e punës edhe në Shqipëri, duke sjellë ndryshime të rëndësishme në peizazhin e punësimit. Automatizimi inteligjent ndoshta do të shkaktojë humbje të përgjithshme të vendeve të punës. Megjithatë, ajo mund të çojë në ndryshime të rëndësishme në strukturën e punësimit, p.sh. në lidhje me industrinë, profesionet, aftësitë dhe rolet, konkretisht në rastin tonë për grupmoshat e larta (50+) në vendin e tyre në tregun e punës në Shqipëri.

Ndërsa këto ndryshime sjellin shumë mundësi, ato paralelisht krijojnë edhe sfida të reja për fuqinë punëtore, veçanërisht punëtorët e moshuar, duke përfshirë rrezikun e rritjes së pabarazisë dhe përjashtimit social. Pyetja është se si po i përgjigjen politikat publike ndikimit të digjitalizimit te punëtorët e moshuar për t'i mbështetur ata në tregun digjital të punës dhe për të siguruar që ata të mund të përfitojnë nga mundësitë që sjell transformimi digjital?

Hyrja në rrugën drejt integritit me Bashkimin Europian ka vendosur drejtimin për nxitjen e rritjes ekonomike dhe digjitale të vendit (Komisioni Europian, 2022). Si rezultat, politika dhe iniciativa të shumta u zbatuan gjatë periudhës së anëtarësimit në BE, të cilat çuan në përmirësime të rëndësishme në aspektin e aksesueshmërisë, infrastrukturës dhe kosto-efektivitetit (Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit, 2021). Strategjia Ndërsëktoriale për Agjendën Digjitale 2015-2020 dhe Plan i Veprimit i Shqipërisë parashtrojnë një udhërrëfyes gjithëpërfshirës dhe synime për përmirësimin e infrastrukturës së digjitalizimit në të gjithë vendin. Për të adresuar sfidat ekzistuese, qeveria shqiptare në qershor 2020 miratoi dhe po zbaton Planin Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale, Broadband 2020-2025. Ky plan i përditësuar ka potencial të madh për punëtorët e moshuar, të cilët shpesh përballen me

vështirësi për shkak të aksesit të kufizuar në shërbime dhe mungesës së teknologjisë në shtëpitë e tyre, duke penguar aftësinë e tyre për të mësuar dhe praktikuar aftësitë digjitale, duke i dhënë përparësi ofrimit të WiFi në 50 për qind të hapësirave më të mëdha publike, si parqet, bibliotekat dhe sheshet në të gjitha qytetet dhe fshatrat. Sipas INSTAT-it (2023), individët e grupmoshës 65 - 74 vjeç, të cilët nuk kanë përdorur asnjëherë internetin përbëjnë 32.3 për qind, edhe pse ky tregues është zvogëluar me 4.6 pikë përqindje krahasuar me vitin 2022, përsëri mbetet shqetësues.

Nevoja për digjitalizim u bë edhe më e dukshme për shkak të pandemisë së Covid-19, e cila vuri në dukje nevojën urgjente për mekanizma, mjete dhe rregullore të adaptuara për një organizim më të mirë dhe për një shoqëri plotësisht funksionale. Programet dhe financimet fokusohen më shumë në punësimin dhe arsimimin e të rinjve, duke thelluar më tej të ashtuquajturin “hendek digjital”, ku dalin në pah dallimet midis qytetarëve për sa i përket qasjes së tyre në internet, qasjes në pajisjet elektronike, dhe për pasojë edhe dallimet në nivelet e aftësive/njohurive të tyre digjitale.

Tabela 1. Depërtimi i internetit në vendet e Ballkanit Perëndimor, 2019 - 2020

Vitet	Shqipëria ⁱ	Kosova ⁱⁱ	Mali i Zi ⁱⁱⁱ	Maqedonia e Veriut ^{iv}	Serbia ^v
2019	73.5%	93.2%	74.3%	81.8%	80.1%
2020	75.2%	96.4%	80.3%	79.9%	81%

Ndërkohë, përdoruesit e internetit kanë vazhduar të rriten në vendin tonë nga 73.5 për qind në 2019 në 76.3 për qind të popullsisë në 2022. Strategjia “Agjenda digjitale e Shqipërisë 2022-2026” shërben si bazë për programin e ri të qeverisë që paraqet fazën tjetër të transformimit digjital të vendit, nisur me strategjinë ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2015-2020”. Qëllimi i strategjisë është të përmirësojë cilësinë e ofrimit të shërbimit duke rritur njëkohësisht integrimin e teknologjive inovative si blockchain, inteligjencën artificiale dhe mësimin e makinerive.

1) Depërtimi i internetit në Shqipëri. Qasur: <https://bit.ly/2Xvc2cp>

2) Depërtimi i internetit në Kosovë. Qasur: <https://bit.ly/3tJTl0d>

3) Depërtimi i internetit në Mal të Zi. Qasur: <https://bit.ly/3CdihAl>

4) Depërtimi i internetit në Maqedoninë e Veriut. Qasur: <https://bit.ly/3tPLwXa>

5) Depërtimi i internetit në Serbi. Qasur: <https://bit.ly/2Z0hSDd>

Kjo politikë synon gjithashtu të promovojë përfshirjen e punëtorëve të moshuar në epokën digjitale. Ndërkohë, që brezi i të rinjve të mos ndeshet me të njëjtat sfida si grupmoshat e larta, Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar 2022-2026 ka shpallur prioritet mësimin e kodimit dhe programimit që në arsimin bazë.

6. Reflektime të politikave publike

Shumica e programeve, strategjive dhe instrumenteve të qeverisë për tregun e punës kanë prioritet ndihmën e të rinjve në përmirësimin e aftësive të tyre digjitale, nxitjen e inovacionit dhe më shumë (ITU, 2021; 2022). Kjo ka reflektuar statistikën e tregut të punës ku prej dekadash dominon një shkallë e lartë e papunësisë tek të rinjtë, edhe kur këta kanë arsim të lartë. Moshën dhe supozimet rreth daljes në pension shpesh rezultojnë që këta punëtorë të anashkalohen në programe dhe burime. Për të adresuar këtë, fonde dhe burime të dedikuara duhet të ndahen për të ofruar udhëzime dhe mbështetje të synuar për punëtorët e moshuar, duke marrë parasysh nevojat dhe sfidat e tyre unike në epokën digjitale.

Për më tepër, sigurimi i aksesit në mjetet dhe aftësitë digjitale është thelbësor. Janë ndërmarrë hapa për të mundësuar e-governance duke bërë digjitalizimin e shumë shërbimeve publike në të gjithë Shqipërinë. Megjithatë, më shumë fonde duhet të ndahen për të ofruar pajisje, edukim dhe trajnim për punëtorët e moshuar, duke i lejuar ata të mësojnë dhe të praktikojnë aftësitë digjitale. Për më tepër, këto politika duhet të marrin në konsideratë kapacitetin lokal dhe të përfshijnë edhe komunitetin e biznesit lokal për të mbështetur efektivisht punëtorët e moshuar në kalimin e tyre në epokën digjitale. Duke i dhënë përparësi dhe duke investuar në përfshirjen digjitale të punëtorëve të moshuar, Shqipëria mund të zhbllokojë potencialin e tyre dhe t'u mundësojë atyre të marrin pjesë aktive dhe të përfitojnë nga epoka digjitale.

Krahas rolit strategjik të shtetit, punëdhënësit dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë civile, mbetet i padiskutueshëm edhe në këtë rast roli i familjes. Në shqiptarët kemi avantazhin e një shoqërie ku familja është ruajtur si një vlerë e shenjtë dhe solidariteti mes anëtarëve të familjes ka qenë kyçi i suksesit dhe kapërcimit të sfidave të tranzicionit. Avancimi i brezave të rinj në përdorimin e teknologjive moderne, internetit e programeve kompjuterike përbën një aset që duhet të shfrytëzohet për asistimin e prindërve të tyre për përdorimin e instrumenteve digjitale.

Si përfundim, në strategjitë e ardhshme lidhur me agjendat digjitale dhe tematikat e lidhura me to, si edukimi digjital, pjesëmarrja elektronike, mbrojtja e të dhënave duhet të pasqyrohen posaçërisht nevojat e punëtorëve të grupmoshave të larta që të kenë qëndrueshmëri dhe zgjatje të qëndrimit aktiv në tregun e punës. Nevoja për fuqi punëtore me arsimim digjital më të mirë është evidente në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe në të gjitha profesionet. Nevojitet një qasje strategjike dhe e përbashkët nga të gjitha palët, si shteti, punëdhënësi, sindikatat dhe grupet e interesit në procesin e përhapjes së edukimit digjital. Intensifikimi i procesit të integritimit europian shton presionin dhe përgjegjësinë e Shqipërisë për të siguruar një fuqi punëtore konkurruese në tregun rajonal dhe europian. Investimi në burime njerëzore është një nga fushat më të rëndësishme të investimit për rritjen ekonomike për të ardhmen.

Referenca

1. Burnay, N., Ogg, J., Krekula, C., & Vendramin, P. 2022. *Older Workers and Labour Market Exclusion Processes: A Life Course perspective*. Springer. <https://library.oapen.org/bitstream/handle/20.500.12657/59386/1/978-3-031-11272-0.pdf#page=85>
2. European Commission. 2022. "Albania's digital transformation of public services delivery" <https://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=25935&langId=sl>
3. European Commission. 2021. *Staff Working Document, Albania 2021 Report, Communication on EU Enlargement Policy*. <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/6e2fcf17-30ea-11ec-bd8e-01aa75ed71a1/language-en>
4. Eurostat. 2022. *Database - Digital economy and society*. <https://ec.europa.eu/eurostat/web/digital-economy-and-society/data/database>
5. Eurostat. 2022. *Database available at* https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=isoc_sk_dskl_i21&lang=en
6. Internet World Stats. 2022. *Usage and Population Statistics*, available at: *Europe Internet Users and Population Statistics (internetworldstats.com)*
7. INSTAT. 2023 *Anketa Tremujore e Forcave të Punës, T4 - 2023*. <https://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe-papun%C3%ABsia/#tabl>
8. INSTAT. 2023. *Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje*. <https://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/teknologjis%C3%ABs%C3%AB-informacionit-dhe-komunikimit-tik-n%C3%AB-familje-dhe-nga-individ%C3%ABt/#tabl>
9. ITU Office for Europe. 2022. "Albania Digital Development Country Profile" https://albania.un.org/sites/default/files/2022-05/Digital%20Development%20Country%20Profile_Albania_final_02.22.pdf

10. ITU Regional Forum for Europe on Digital Skills Development. 2021. Digital Skills in Albania, https://www.itu.int/en/ITU-D/Regional-Presence/Europe/Documents/Events/2021/Digital%20skills/1_Florensa_Haxhi_Albania.pdf

11. Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022, Aksesuar në: https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/10/Publikim_EN_Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Pun%C3%ABsim-dhe-Aft%C3%ABsi-2019-2022.pdf

12. Ministria e Financës dhe Ekonomisë. 2023. Relacion. https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_622_Relacion-pligji-per-sigurimet-shoqerore.docx

13. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës. Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale 2020 - 2025. Aksesuar në: <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/National-Plan-BBAnd-EN.pdf>

14. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. 2019. Plani kombëtar i veprimtari mbi moshimin 2020-2024.

15. https://extranet.who.int/ncdccs/Data/ALB_B27_s21_PLANI-KOMB%C3%8BTAR-I-VEPRIMIT-shq.pdf

16. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. 2021. Republika e Shqipërisë. Zbatimi i planit ndërkombëtar të veprimtari të Madridit për plakjen dhe strategjia e tij rajonale e zbatimit (MIPAA/RIS). Cikli i katërt i rishikimit dhe vlerësimit 2018-2022

17. <https://unece.org/sites/default/files/2021-10/mipaa20-report-albania.pdf>

18. Organizata Botërore e Punës (ILO), 2022. Kujdesi afatgjatë për të moshuarit në Shqipëri: Sfidat dhe çështjet kryesore të politikave. <https://www.ilo.org/publications/long-term-care-elderly-albania-challenges-and-key-policy-issues>

19. Sigma. 2021. Monitoring Report "The Principle of Public Administration, Albania". <https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf>

20. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 370, datë 01.06.2022, "Strategjia ndërsektoriale "Agjenda digjitale e Shqipërisë" dhe Plani i Veprimtari 2022–2026". Aksesuar në <https://akshi.gov.al/ep-content/uploads/2022/06/vendim-2022-06-01-370.pdf>

21. World Bank. 2022. "Improving Equitable Access to High Standard Public Services through GovTech- The Republic of Albania." <https://documents1.worldbank.org/curated/en/099200502132320227/pdf/P17784509582f20a08d6809bad6a214427.pdf>

22. World Bank. 2021. Guidebook for Accessible GovTech, <https://thedocs.worldbank.org/en/doc/3fcff7a44bd530a0413e23245ace2f03-0350012021/related/EFI-Insight-Accessible-GovTech-4-1.pdf>

ANALIZA E LLOGARIVE RAJONALE SI MJET PËR TË SHMANGUR THELLIMIN E SHPËRPPJESËTIMEVE NË ZHVILLIMIN EKONOMIK RAJONAL

Luan SHAHOLLARI,

kryeredaktor i kolegjiut të revistës “Studime Demografike”, Tiranë

Robert ÇELO,

zv/dekan i Fakultetit Ekonomik, Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër

ABSTRACT

Regional statistics are a cornerstone of the EU statistical system and form the basis for the definition of regional indicators. At the heart of regional statistics is NUTS – the EU’s classification of territorial units for statistics. This regional classification for EU countries is based on a hierarchy of regions and subdivides each country into regions that are classified according to NUTS levels 1, 2 and 3 (from larger to smaller). The NUTS classification plays a crucial role in ensuring consistent and comparable regional statistics across the EU, creating conditions for more deep socio-economic analyses. For non-EU countries – EFTA and candidate countries – where Albania included – the concept of ‘statistical regions’ is used instead of NUTS. This applies the same principles like NUTS classification but is based on bilateral agreements between the countries concerned and Eurostat.

Since 2011, based in the metodological criteria of the EU institutions, in parallel of the national indicators, INSTAT is publishing the statistical regional accounts, too. In 2021, toward 2016 the national GDP has grown by 26%, in the northern region’s by 18.5%, the central region by 35%, and the southern region by 17.7%. In 2021, the highest GDP level at current prices was recorded in the Central region with 50.5% of the national level, approximately 2.3 times higher than in the northern region and 85.6% higher compared to the southern region. The GDP level of the Tirana County has reached 87% of the total region, while 13% belongs to the Elbasan County. The GDP per capita in purchasing

power standards (PPS) has shown a relatively low increase over the study years from 29.4% in 2016 to 32.73 % in 2021. GDP per capita in PPS relative to the EU 27 average increased from 29.4% in 2016 to 32.73% in 2021. The Central region had the highest weight: from 35.1% in 2016 to 38.19% in 2021.

In the paper are presented statistical data for the performance of the GDP during years 2017-2021 in the country and region level, in total and per capita. These data reflect the dynamics of different regions within Albania and provide valuable insights for policymakers and businesses.

Key words: EU, NUTS, Albania, INSTAT, Statistical regions, Regional Account, GDP.

PËRMBLEDHJE

Statistikat rajonale janë një gur themeli i sistemit statistikor të BE-së dhe formojnë bazën për përcaktimin e treguesve rajonalë. Në themel të statistikave rajonale është NUTS – klasifikimi i BE-së i njësive territoriale për statistikë. Ky klasifikim rajonal për shtetet anëtare të BE-së bazohet në një hierarki të rajoneve dhe nënvizon secilin shtet anëtar në rajone të klasifikuara sipas niveleve NUTS 1, 2 dhe 3 (nga më të mëdhatë te më të voglat), krijon kushte për analiza më të thella socio-ekonomike. Për vendet jashtë BE-së - EFTA dhe vendet kandidate – ku përfshihet edhe Shqipëria - në vend të NUTS përdoret koncepti i 'rajoneve statistikore'. Ky përdor të njëjta parime si në klasifikimin e NUTS, por bazohet në marrëveshjet e dyanshme të vendeve përkatëse me Eurostatin.

Nga viti 2011, bazuar në kriteret metodologjike të institucioneve të BE-së, krahas treguesve në shkallë vendi, INSTAT-Albania publikon llogaritë statistikore rajonale. Në vitin 2021 ndaj vitit 2016 PBB në shkallë vendi është rritur 26 %, PBB i rajonit Veri 18.5 %, rajoni Qendër 35 % dhe rajoni i Jugut 17.7 %. Niveli më i lartë i PBB me çmime korrente gjatë kësaj periudhe është shënuar në rajonin Qendër në vitin 2021, ku arriti 50.5 për qind e nivelit në shkallë vendi, rreth 2.3 herë më shumë se në rajonin e Veriut dhe 85.6 për qind më shumë se rajoni i Jugut. Qarku i Tiranës ka dhënë 87 për qind të rajonit Qendër, kur qarku Elbasan llogaritet për 13 për qind. PBB për frymë në PPS në raport përqindjeje me BE 27=100, ka shënuar një rritje relativisht të ulët në vitet në studim, nga 29.4 % më 2016 në 32.73 % më 2021. Në raportin mesatar të PBB ndaj BE, peshën më të madhe e jep rajoni Qendër, nga 35.1 % më 2016, në 38.19 % në vitin 2021.

Në artikull prezantohen të dhënat për ecurinë e GDP gjatë viteve 2017-2021 në nivel vendi si dhe për rajonet statistikore, gjithsej dhe për frymë. Këto të dhëna reflektojnë dinamikën e rajoneve të ndryshme në Shqipëri dhe sigurojnë perceptime të vlefshme për politikëbërësit dhe bizneset.

Fjalë kyçe: BE, NUTS. Shqipëria, INSTAT, Rajone statistikore, Llogari rajonale, PBB.

Hyrje

Statistikat e rajoneve në BE – klasifikimi NUTS

Klasifikimi NUTS është bazuar në Rregulloren (EC) No. 1059/2003 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të 26 majit 2003 për vendosjen e një klasifikimi të përbashkët të njësive territoriale për statistikën (NUTS).¹⁾ Klasifikimi NUTS është një sistem hierarkik për ndarjen e territorit ekonomik të BE-së me qëllim:

- mbledhjen, zhvillimin dhe harmonizimin e statistikave rajonale evropiane,
- kryerjen e analizave socio-ekonomike të rajoneve,
- përcaktimin e politikave rajonale të BE-së,
- përcaktimin e rajoneve të mbështetura nga politika e kohezionit në nivelin NUTS 2,
- përgatitjen e raportit të kohezionit, i cili është përgatitur kryesisht në nivelin NUTS 2.

Klasifikimi NUTS e ndan çdo vend anëtar në tri nivele: NUTS 1, NUTS 2 dhe NUTS 3. Nivelet e dytë dhe të tretë janë nënndarje përkatësisht të nivelit të parë dhe të dytë. Shtetet anëtare mund të zgjedhin të shtojnë nivele të tjera duke ndarë nivelin NUTS 3.2

Tabela 1 përmban numrin e rajoneve për secilin vend anëtar të BE-së dhe jo anëtar të përfshirë në vjetarin rajonal të Eurostat-it. Klasifikimi NUTS ka pësuar ndryshime në vite, të cilat prej 1 janarit 2024 paraqiten në vijim. Sipas kësaj table, NUTS përfshin 92 rajone në nivelin NUTS 1, 244 rajone në nivelin NUTS 2 dhe 1 165 rajone në nivelin NUTS 3.²⁾

1) [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Glossary:Nomenclature_of_territorial_units_for_statistics_\(NUTS\)](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Glossary:Nomenclature_of_territorial_units_for_statistics_(NUTS))

2) Overview - Eurostat (europa.eu)

Table 1: Numri i NUTS dhe rajoneve statistikore sipas shteteve për vitin 2024

	NUTS nivel 1	NUTS nivel 2	NUTS nivel 3
BE	92	242	1 166
Belgjika	3	11	44
Bullgaria	2	6	28
Çekia	1	8	14
Danimarka	1	5	11
Gjermania	16	38	401
Estonia	1	1	5
Irlanda	1	3	8
Greqia	4	13	52
Spanja	7	19	59
Franca	14	27	101
Kroacia	1	4	21
Italia	5	21	107
Qiproja	1	1	1
Letonia	1	1	6
Lituania	1	2	10
Luksemburgu	1	1	1
Hungaria	3	8	20
Malta	1	1	2
Holanda	4	12	40
Austria	3	9	35
Polonia	7	17	73
Portugalia	3	7	25
Rumania	4	8	42
Sllovenia	1	2	12
Sllovakia	1	4	8
Finlanda	2	5	19
Suedia	3	8	21
	Nivel 1	Nivel 2	Nivel 3
Islanda	1	1	2
Lihtenshtajni	1	1	1
Norvegjia	1	7	13
Zvicra	1	7	26
Mali i Zi	1	1	1
Maqedonia e Veriut	1	1	8
Shqipëria	1	3	12
Serbia	2	4	25
Turqia	12	26	81

Source: Eurostat regional yearbook 2023. F.9.

Parimet kryesore të klasifikimit të NUTS

Parimi 1: NUTS përcakton kufijtë minimum dhe maksimum për madhësinë e rajoneve individuale NUTS (Tabela 2) për të siguruar një shkallë bazike të krahasueshmërisë. Luhatjet nga këta kufij janë të mundshme vetëm kur ekzistojnë kushte gjeografike, socio-ekonomike, historike, kulturore apo mjedisore.

Parimi 2: NUTS përshtatet sipas ndarjeve administrative. Nëse është e mundur, strukturat administrative përdoren për nivele të ndryshme të NUTS. Në ato vende të BE-së ku nuk ka ndarje administrative që i korrespondojnë një niveli të veçantë të NUTS, rajonet janë krijuar nga mbledhja e rajoneve administrative më të vogla.³⁾

Tabela 2: Madhësia e popullsisë e detyrueshme për rajonet NUTS 2024 (numër i banorëve)

	Popullsia minimale	Popullsia maksimale
Rajonet NUTS nivel 1	3 000 000	7 000 000
Rajonet NUTS nivel 2	800 000	3 000 000
Rajonet NUTS nivel 3	150 000	800 000

Një kod NUTS fillon me me dy shkronja që i referohet vendit, i shkurtuar në udhëzuesin e BE-së. Më pas nënndarja e vendit referohet me një numër. Një nivel i nënndarjes së dytë ose të tretë referohet secili me një numër tjetër. Çdo numërim fillon me 1, pasi 0 përdoret për nivelin e sipërm. Nën tri nivelet NUTS janë njësitë administrative vendore (LAU).

Rajonet NUTS përgjithësisht bazohen në nënndarjet ekzistuese administrative kombëtare. Në vendet ku ekzistojnë vetëm një ose dy nënndarje rajonale, ose ku popullsia e nënndarjeve ekzistuese është shumë e vogël ose shumë e madhe, krijohet një nivel i dytë dhe/ose i tretë. Kjo mund të jetë në nivelin e parë (p.sh. Franca, Italia, Greqia dhe Spanja), në nivelin e dytë (Gjermania) dhe/ose nivelin e tretë (Belgjika). Në vendet me popullsi të vogël, ku i gjithë vendi do të vendosej në nivelin NUTS 2 apo edhe NUTS 3 (p.sh. Luksemburgu, Qiproja), rajonet në nivelet 1, 2 dhe 3 janë identike me njëri-tjetrin (dhe gjithashtu për të gjithë vendin), por janë të koduara me kodet e duhura të gjatësisë, nivelet 1, 2 dhe 3.

3) Eurostat regional yearbook 2023. F.10.

Sistemi NUTS favorizon njësitë administrative ekzistuese. Udhëzimet specifike bazohen në popullsinë, duke lënë pak ose aspak mundësi për llojet e tjera të variablave si zona, distanca, topografia, nivelet e juridiksionit ose historia, të cilat mund të merren parasysh vetëm në raste të veçanta të paspecifikuara.

Klasifikimi NUTS ndihmon politikën e kohezionit të BE-së të nxisë zhvillimin harmonik territorial brenda BE-së përmes shpërndarjes së investimeve që mbështesin krijimin e vendeve të punës, konkurrencën e biznesit, rritjen ekonomike, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo politikë do të vazhdojë të luajë një rol kyç në të ardhmen, duke kaluar një të tretën e buxhetit afatgjatë të BE-së nën kornizën financiare shumëvjeçare 2021-2027, që kap shumën rreth 60 miliardë euro mesatarisht në vit.⁴⁾

I. LLOGARITË RAJONALE NË SHQIPËRI

1. Struktura rajonale e Shqipërisë sipas ndarjes NUTS

Llogaritë rajonale në Shqipëri mbështeten në klasifikimin sipas rajoneve statistikore në nivel 1, 2 dhe 3, i cili bazohet në Nomenklaturën e Njërive Territoriale për Statistikat (NUTS) të BE-së. NUTS është një klasifikim i përbashkët, i cili përdoret për:

- Mbledhjen, zhvillimin dhe harmonizimin e statistikave në nivel rajonal;
- Analizat socio-ekonomike të rajoneve;
- Për shpërndarjen e fondeve strukturore për zhvillim.

Llogaritë Rajonale janë një specifikim rajonal i llogarive korresponduese të ekonomisë kombëtare. Këto llogari ofrojnë ndarje rajonale për agregatet më të rëndësishme, si Produkti i Brendshëm Bruto e Vlera e Shtuar Bruto sipas degëve kryesore të ekonomisë.⁵⁾

Më 28 prill 2011 EUROSTAT-i konfirmoi propozimin e INSTAT-it të miratuar nga Këshilli i Ministrave në dhjetor 2010 për ndarjen e vendit në 3 rajone statistikore: niveli 1-Shqipëria (Kodi AL), niveli 2 –Veri, Qendër, Jug (Kodi 01,02,03) dhe niveli 3, që përfaqëson 12 qarqet e vendit (*Tabela 3*)⁶⁾.

Tabela 3: Struktura rajonale e Republikës së Shqipërisë sipas ndarjes NUTS

Rajoni statistikor Niveli 1	Rajoni statistikor Niveli 2	Rajoni statistikor Niveli 3	Kodi
Republika e Shqipërisë (RSh) (Kodi AL)	Veri (Kodi 01)	Dibër	AL011
		Durrës	AL012
		Kukës	AL013
		Lezhë	AL014
		Shkodër	AL015
	Qendër (Kodi 02)	Elbasan	AL021
		Tiranë	AL022
	Jugë (Kodi 03)	Berat	AL031
		Fier	AL032
		Gjirokastrë	AL033
		Korçë	AL034
		Vlorë	AL035

Numri i popullsisë për çdo njësi joadministrative në nivel NUTS II është i harmonizuar me kriterin e vendosur nga BE-ja: nga 800 mijë deri në 3 milionë banorë. Rajonet statistikore niveli 3 janë njësitë administrative (qarqet). Numri mesatar i popullsisë për nivelin 3 ishte 266,201 banorë për vitin 2009 (brenda intervalit 150 në 800 mijë banorë), 240.058 banorë në vitin 2015 dhe 239.454 banorë në vitin 2017.

“Llogaritë Rajonale në Shqipëri” u publikuan për herë të parë nga INSTAT-i në vitin 2011, përfshirë edhe llogaritjen e PBB-së për frymë, sipas NUTS II të BE-së.

Publikimi i parë i vitit 2011 përmbante rezultate të llogaritjeve të PBB dhe përbërësve të tij për vitet 2001-2010 sipas 3 rajoneve statistikore niveli 2 dhe 12 rajoneve statistikore niveli 3. Të dhënat janë shprehur në lekë, në euro, dollarë (usd) si dhe në Standardin e Fuqisë Blerëse) për efekte të krahasimeve të njësuara ndërkombëtare.⁷⁾

4) Eurostat regional yearbook 2023.F.11.

5) Instat. Llogaritë Rajonale në Shqipëri, 2010.

6) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1037, datë 15.12.2010, “Mbi Implementimin e Nomenklaturës “Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II” sipas nomenklaturës mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të BE”.

7) Standardi i Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Standard-PPS) është një njësi monedhe artificiale që merr parasysh ndryshimet në nivelet kombëtare të çmimeve. Kjo njësi lejon krahasime të mirëfillta të vëllimit të treguesve ekonomikë për vendet. Agregatet e shprehura në PPS dalin duke pjesëtuar agregatet (treguesit) e vlerësuara me

Vlerësimi i Llogarive Rajonale bazohet në të dhënat e Llogarive Kombëtare, të cilat janë burime statistikore dhe administrative. Burimet statistikore përmbajnë të dhëna nga Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve (ASN), Anketat e Bujqësisë e të Peshkimit, Anketa mbi Forcat e Punës (AFP), Statistikat e Çmimeve, Regjistri i Ndërmarrjeve etj. Kurse burimet administrative përmbajnë të dhëna nga shitjet (TVSh), pasqyrat financiare vjetore, raportet vjetore të sistemit bankar, të sigurimeve, të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit etj.

Llogaritë rajonale janë një detajim i llogarive përkatëse të ekonomisë kombëtare. Me vlerësimin e Llogarive rajonale bëhen më të qarta diferencat e zhvillimit ekonomik rajonal.

Parimi kryesor për llogaritjen e VShB-së është ai i rezidencës (vendndodhjes), pra, në rajonin ku ajo krijohet. Parimi i rezidencës është i rëndësishëm për t'u aplikuar sidomos në disa degë si energjia, transporti etj. VShB dhe PBB rajonal u publikuan për herë të parë në Shqipëri në vitin 2011 për vitin 2009. Vlerësimet e VShB dhe PBB sipas rajoneve statistikore janë në përputhje me Sistemin European të Llogarive Kombëtare (ESA).⁸⁾

Llogaritë Rajonale publikohen çdo vit, 19 muaj mbas muajit të referencës. Publikimi i Llogarive Rajonale pason publikimin e Llogarive Kombëtare Vjetore.

Botimi i përvitshëm “Llogaritë Rajonale në Shqipëri” i INSTAT-it përmban një përshkrim plotësues të Llogarive Rajonale sipas degëve kryesore të ekonomisë, duke përfshirë këto tabela: VShB sipas Rajoneve Statistikore Nivel 1, 2, 3; PBB në çmime korrente; PBB në çmime të vitit të mëparshëm; PBB në Euro; PBB në PPS; Rritja Reale e PBB; Popullsia mesatare në Shqipëri sipas Rajoneve Statistikore; PBB për frymë në Lekë, në Euro, në PPS sipas Rajoneve Statistikore Nivel 2; PBB për frymë, AL=100; PBB për frymë, EU28=100 sipas Rajoneve Statistikore Niv.2; Struktura e VShB sipas rajoneve dhe degëve të ekonomisë; VShB për 3

çmimet aktuale dhe me monedhën kombëtare përkatësisht me Paritetin e Fuqisë Blerëse (Purchasing Power Parity-PPP). Indeksi i volumit të PBB-së për frymë i shprehur në Standardin e Fuqisë Blerëse.

PPS - Purchasing Power Standards) është dhënë në raport me mesataren e BE-së (BE28=100). INSTAT, maj 2019. <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-datasets/-/tec00114>.

8) [esa95terminology.cso.ie/en/media/csoie/methods/nationalaccountsoutputandvalueaddedbyactivity/ methodology](https://esa95terminology.cso.ie/en/media/csoie/methods/nationalaccountsoutputandvalueaddedbyactivity/methodology).

rajonet statistikore niveli 2 dhe për 12 rajonet statistikore niveli 3 (qarqe).

Më 19 maj 2019 INSTAT-i publikoi Llogaritë Rajonale në Shqipëri (Indikatorët Rajonalë), rezultatet sipas klasifikimit NUTS 1, 2, 3 për vitet 2012-2017. Bazuar në të dhënat e këtyre viteve, në revistën “Demografia” është botuar artikulli me temë: “Llogaritë rajonale në Shqipëri: më shumë mundësi për analiza të thelluara të PBB dhe treguesve të tjerë socio-ekonomikë sipas qarqeve”.⁹⁾

2. Produkti i Brendshëm Bruto dhe Vlera e Shtuar Bruto deri më 2017

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) përbën një matës bazë të ekonomisë së një vendi, përfaqëson vlerën monetare të të gjitha të mirave dhe shërbimeve të prodhuara brenda vendit në një periudhë të caktuar kohore, zakonisht në një vit. Si një matës i agreguar i prodhimit, PBB është i barabartë me shumën e Vlerës të Shtuar Bruto (VShB) të të gjitha njësive në prodhim, plus taksat e minus subvencionet mbi produktet. Kurse VShB është diferenca ndërmjet prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm.

Në vijim kemi një përmbledhje të ecurisë së këtij treguesi deri në vitin 2017 sipas rajoneve statistikore. PBB me çmime korrente në rajonin statistikor nivel 1 (RSh) është vlerësuar 1,551,281 milionë lekë.¹⁰⁾ Rajoni statistikor i Veriut vlerësohej në 361,089 milionë lekë ose 23.3 për qind të shumës gjithsej, rajoni statistikor i Qendrës me 758,134 milionë lekë ose 48.9 për qind dhe rajoni statistikor i Jugut me 420.147 milionë lekë ose 27.8 për qind.

VShB në vitin 2017 është llogaritur në 1,355,126 milionë lekë kundrejt 1,154,747 milionë lekë më 2012, 200,379 milionë lekë më shumë ose 17.4 për qind. Niveli më i lartë i VShB për këtë vit është arritur në rajonin statistikor të Qendrës me 662,270 milionë lekë, 48.8 për qind e shumës gjithsej në shkallë vendi, 2.1 herë më shumë se rajoni i Veriut dhe 1.74 herë më shumë se rajoni statistikor i Jugut.

9) Luan Shahollari, kryeredaktor i kolegjiut të revistës “Demografia”. Llogaritë rajonale në Shqipëri: Më shumë mundësi për analiza të thelluara të PBB-së dhe treguesve të tjerë socio-ekonomikë sipas qarqeve. Revista “Demografia”, nr.1, viti 2019, f. 17-40.

10) Vlerësimet për vitin 2017 bazohen në të dhëna gjysmëfinale të publikuara nga INSTAT-i më 2019.

PBB i llogaritur sipas rajoneve statistikore nivel 3 tregon që qarku i Tiranës zinte vendin e parë në vend me 42 për qind të PBB gjithsej. Në vijim renditej qarku i Fierit me rreth 11 për qind, qarku i Durrësit 10 për qind, qarku i Elbasanit 7 për qind, qarku i Korçës dhe i Vlorës me 5.5 për qind, duke përfunduar me qarkun e Kukësit me 1.7 për qind.

Analiza tregon që peshën më të madhe specifike ndaj PBB në shkallë vendi pas Tiranës e zinte qarku i Fierit, me rreth 11 për qind, qarku i Durrësit me 10 për qind, qarku i Elbasanit me 7 për qind, qarku i Korçës dhe Vlorës me rreth 5.5 për qind etj.

Rritja reale e PBB për vitet 2012-2017 paraqet ndryshime të ndjeshme sipas niveleve statistikore. Në shkallë vendi kjo rritje ka kaluar nga minimale në vitet 2012-2015 në rritje të moderuar në vitet 2016 dhe 2017, përkatësisht 3.3 dhe 3.8 për qind. Rritja në shkallë vendi ka ardhur nga niveli statistikor Qendër, nga 2.6 për qind më 2014, në 4.9 për qind më 2015, 3.3 për qind më 2016 dhe sidomos me 7.4 për qind më 2017.

Brenda këtij niveli kontributin kryesor e ka dhënë qarku i Tiranës, me një rritje të ndjeshme sidomos në vitet 2015 dhe 2017, përkatësisht 6.7 dhe 8.5 për qind. Ndryshe nga Tirana, qarku i Elbasanit ka pasur luhatje, madje në disa vite ka pasur edhe rritje negative të PBB (-4.6 % më 2015) dhe rritje minimale më 2017 (0.7%).

Niveli statistikor i Veriut paraqitej me rritje të moderuar të PBB në vitet 2015-2016 (4.3% dhe 3.8%), me rritje minimale në vitet 2012 dhe 2017 (1.8% dhe 1.7%) dhe rritje negative në vitet 2013 dhe 2014 (-0.5% dhe -1.1%).

Në vitin 2017, sipas rajoneve statistikore në nivel 3, rritjen më të lartë e ka shënuar qarku Tiranë me një rritje në terma realë prej 8,54 %, i ndjekur nga qarku Durrës me një rritje në terma realë prej 4,09 % dhe qarku Berat me një rritje në terma realë prej 1,92 %. Rritja ekonomike është ngadalësuar në qarkun Vlorë, duke shënuar një rënie në terma realë prej 3,26 % dhe në qarkun Korçë me një rënie në terma realë prej 2,22 %.¹¹⁾

Në shkallë vendi, PBB për frymë në lekë ka shënuar rritje nga 459,528 lekë më 2012 në 539,866 lekë më 2017 ose 17.5 për qind. Krahasuar me vitin 2016, kjo rritje është 5.4 për qind. Rajoni statistikor i Veriut është me tregues më të ulët krahasuar me mesataren në shkallë vendi. Ky nivel në

11) INSTAT. Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistikore në Shqipëri, 2017. 29 maj 2019.

vitin 2017 është 18.8 për qind më pak se mesatarja në shkallë vendi, 33 për qind më pak se rajoni Qendër dhe 9.1 për qind më pak se rajoni Jug.

Një veçori pozitive për këtë rajon statistikor mund të konsiderohet prirja e rritjes së këtij treguesi në vitet 2012-2017. Në vitin 2017, kundrejt vitit 2012, PBB për frymë është rritur 17.7 për qind. Me tregues më të ulët në këtë rajon paraqitet qarku i Kukësit me 326,756 lekë për frymë, qarku i Shkodrës me 389,247 lekë për frymë etj.

Rajoni i Qendrës paraqitet me tregues më të lartë të PBB për frymë në vitin 2017 me 656,755 lekë kundrejt 547,560 lekë më 2012, me një rritje prej 19.9 për qind. Por këtu duhet veçuar fakti që ky nivel i PBB për frymë vjen nga treguesi i qarkut të Tiranës prej 746,780 lekë, kundrejt 377,195 lekë që regjistrohet në qarkun e Elbasanit. Pra, qarku i Tiranës ka një nivel të PBB për frymë rreth 2 herë më të lartë se qarku i Elbasanit.

Rajoni i Jugut më 2017 ka regjistruar një nivel të PBB për frymë prej 482,345 lekë ose 10 për qind më të lartë se më 2012. Nivelet më të larta të këtij treguesi janë regjistruar në qarkun e Fierit dhe Gjirokastrës, përkatësisht 555,840 lekë dhe 547,816 lekë dhe më i ulët në qarkun e Korçës me 402,597 lekë.

Më 2017 rajonet statistikore të Veriut dhe të Jugut janë nën nivelin mesatar në shkallë vendi prej 100 për qind, përkatësisht 81 dhe 89 për qind. Kurse, në të njëjtin vit, rajoni statistikor i Qendrës rezulton rreth 122 për qind. Ky rezultat pasqyron ecurinë e PBB gjithsej me ndonjë rregullim që lidhet me ndryshimin e numrit të popullsisë.

Të dhënat sipas qarqeve nxjerrin në pah që treguesi më i lartë i PBB për frymë në raport me mesataren në shkallë vendi është regjistruar në qarkun e Tiranës me 138 për qind, pasuar nga qarku i Fierit me 103 për qind, i Gjirokastrës 101.5 për qind, i Durrësit 99 për qind etj. Kurse treguesi më i ulët është regjistruar në qarkun e Kukësit (60.5%), të Elbasanit (70%), të Shkodrës (72%), të Lezhës (74%) etj.

PBB për frymë në PPS për vitet në studim 2012-2017 ka zënë mesatarisht 30 për qind të nivelit të BE28=100. PBB për frymë në PPS për vitin 2017 rezultoi 30,4 % e mesatares së BE28 = 100 kundrejt 29.4 për qind në vitin 2016. Sipas rajoneve statistikore në nivel 2, në rajonin Qendër PBB për frymë në PPS për vitin 2017 ishte 37,0 %, në rajonin Veri 24,7 % dhe në rajonin Jug 27,2 %. Në qarkun e Tiranës ky tregues vlerësohet në 42 për qind të nivelit mesatar të PBB për frymë në BE28=100.

II. NDRYSHIMET E PBB GJATË VITEVE 2017-2021

1. PBB me çmime korrente 2017-2021

Niveli më i lartë i PBB me çmime korrente gjatë kësaj periudhe është shënuar në rajonin Qendër në vitin 2021, ku arriti në 936.419 milionë lekë ose 50.5 për qind e nivelit në shkallë vendi, rreth 2.3 herë më shumë se në rajonin e Veriut dhe 85.6 për qind më shumë kundrejt rajonit të Jugut.¹²⁾

Nga analiza e të dhënave të dy viteve anësore 2016 dhe 2021 del se PBB në shkallë vendi është rritur 26 për qind, PBB i rajonit Veri 18.5 për qind, rajoni Qendër 35 për qind dhe rajoni i Jugut 17.7 për qind. Pra, rritja më e ndjeshme e PBB është shënuar në rajonin e qendrës. Qarku i Tiranës ka arritur në 811.443 milionë lekë ose rreth 87 për qind e rajonit; pjesa prej 13 për qind i përket qarkut të Elbasanit.

Tabela 1: PBB me çmime korrente 2016-2021 (milionë Lekë)

Kodi	Niveli statistikor 2/3	PBB çmime korrente (milionë Lekë)					
		2016	2017	2018	2019	2020	2021
AL	RSH	1.472.479	1.550.645	1.636.731	1.691.903	1.647.431	1.856.172
AL01	Veri	350.156	363.145	377.010	389.330	370.849	415.188
AL011	Dibër	48.940	49.260	52.106	51.112	48.039	53.504
AL012	Durrës	144.605	156.857	162.378	171.576	163.631	186.709
AL013	Kukës	25.475	26.474	27.936	27.362	27.178	29.027
AL014	Lezhë	51.183	50.557	50.972	53.262	50.065	54.831
AL015	Shkodër	79.953	79.997	83.618	86.017	81.936	91.117
AL02	Qendër	693.770	756.614	807.331	835.124	820.379	936.419
AL021	Elbasan	104.100	105.598	110.379	111.830	112.749	124.976
AL022	Tiranë	589.670	651.015	696.952	723.294	707.631	811.443
AL03	Jug	428.554	430.887	452.391	467.450	456.202	504.565
AL031	Berat	56.964	58.833	58.547	57.883	57.835	62.201
AL032	Fier	163.484	165.990	178.368	188.442	179.915	201.532
AL033	Gjirokastrë	34.469	34.491	35.572	37.087	36.207	38.674
AL034	Korçë	86.429	84.713	87.837	90.725	88.767	96.586
AL035	Vlorë	87.207	86.859	92.067	93.312	93.479	105.571

2016-2020 -të dhëna përfundimtare. Viti 2021-gjysmëpërfundimtare.

12) Të dhënat në këtë artikull janë nxjerrë nga botimet e përvitshme të INSTAT-it për Prodhimin e Brendshëm Bruto sipas rajoneve statistikore në Shqipëri. Të dhënat më të fundit janë ato të vitit 2021, të publikuara në maj 2023 me shënimin “gjysmëfinale”. <http://www.instat.gov.al/>

2. Rritja reale e PBB-së me bazë vjetore 2017-2021

Nga pesë vite të analizuara (2017-2021), del se rritje reale e PBB-së është shënuar në katër prej tyre (2017, 2018, 2019, 2021) dhe vetëm në një vit (2020) ka pësuar rënie.

Viti 2020 ka qenë një vit i plotë i pandemisë së Covid 19, i cili ndikoi në rënien ekonomike kudo në botë, edhe në Shqipëri. Për rrjedhojë, në këtë vit kemi një rënie të PBB-së në shkallë vendi prej -3.48 për qind, nga e cila, -5.25 për qind në rajonin Veri, -2.80 në rajonin Qendër dhe -3.23 për qind në rajonin Jug.

Të dhënat e tabelës 2 tregojnë se kontributi ndaj rritjes reale të PBB-së në shkallë vendi është ndikuar nga kontributi i rajonit Qendër, ku peshën më të madhe e mban qarku i Tiranës. Kështu në vitin 2017 kundrejt vitit 2016, ndërsa në shkallë vendi rritja ka qenë 3.82 për qind, kontributi i rajonit Qendër ka qenë 3.47 për qind ose 90.8 për qind. Më pas vjen rajoni Veri me 0.41 për qind, kurse rajoni Jug ka pësuar rënie me -0.06 për qind.

Në vitin 2018/2017 rritja në shkallë vendi është 4.07 për qind, kurse kontributi i rajonit Qendër është 2.43 për qind. Por në këtë rast kemi një kontribut në rritje prej 1.01 për qind nga rajoni Jug dhe 0.63 për qind nga rajoni Veri.

Në vitin 2019/2018 rritja reale e PBB-së ka rezultuar 2.11 për qind, ku vërehet një rritje më e ulët e rajonit Qendër (1.12 për qind) dhe një kontribut prej 0.50 për qind secili nga rajonet Veri dhe Jug.

Në vitin 2021/2020, për shkak që pasojat e pandemisë në ekonomi erdhën duke u zbutur dhe baza e krahasimit me një vit më parë ishte më e ulët, rritja e PBB-së rezultoi më e lartë: 8.91 për qind. Rajoni Veri ka shënuar një rritje prej 8.43 për qind, rajoni Qendër 10.84 për qind dhe rajoni Jug 5.83 për qind.

3. Kontributi ndaj rritjes reale të PBB-së në përqindje

Të dhënat e tabelës 3, referuar vitit 2021, tregojnë që rritja mesatare në shkallë vendi vlerësohet në 8.91 për qind, rajoni Veri ka kontribuar me 1.90 për qind, rajoni Qendër 5.40 për qind, që shpreh edhe peshën më të madhe të kontributit në shkallë vendi dhe rajoni Jug 1.61 për qind, pra më pak se rajonet e tjera. Nga këto të dhëna del se rajoni Qendër është vendimtar në uljet apo ngritjet reale të PBB-së.

Tabela 2: Rritja reale e PBB-së me bazë vjetore 2017-2021

Kodi	Niveli statistikor 2 / 3	Rritja reale e PBB-së me bazë vjetore 2017-2021				
		2017** /2016*	2018* /2017	2019* /2018	2020* /2019	2021* /2020
AL	RSH	3,82	4,07	2,11	-3,48	8,91
AL01	Veri	1,72	2,69	2,16	-5,25	8,43
AL011	Dibër	1,92	3,78	-2,89	-6,14	6,24
AL012	Durrës	4,09	2,45	4,37	-5,83	10,74
AL013	Kukës	-0,29	4,43	-2,80	-0,10	4,36
AL014	Lezhë	-0,77	-0,17	2,63	-6,28	5,87
AL015	Shkodër	-0,46	3,71	2,39	-4,55	8,03
AL02	Qendër	7,36	4,98	2,28	-2,80	10,84
AL021	Elbasan	0,70	3,68	0,87	0,30	6,76
AL022	Tiranë	8,54	5,19	2,50	-3,28	11,49
AL03	Jug	-0,19	3,64	1,78	-3,23	5,83
AL031	Berat	1,42	-1,30	-2,06	0,33	3,03
AL032	Fier	1,60	5,40	3,26	-5,24	6,09
AL033	Gjirokastrë	1,45	1,46	3,99	-3,59	3,56
AL034	Korçë	-2,22	2,59	2,02	-3,42	4,29
AL035	Vlorë	-3,26	5,52	0,27	-1,05	9,42

4. Struktura ndaj PBB-së, në përqindje

Peshën më të madhe ndaj PBB-së gjithsej në shkallë vendi në vitet 2016-2021 e zë rajoni Qendër nga 47.1 për qind më 2016 në 50.45 për qind më 2021. Brenda rajonit, qarku i Tiranës ka zënë nga 40.0 për qind më 2016, në 43.73 për qind më 2021. Por ndërsa ka ardhur duke u rritur pesha e PBB-së në qarkun e Tiranës, ndërkohë ka ardhur duke rënë në qarkun e Elbasanit nga 7.1 për qind më 2016 në 6.73 për qind më 2021.

Më pas renditet rajoni Jug, nga 27.17 për qind të PBB-së në shkallë vendi më 2021 në 29.1 për qind më 2016, që shpreh një prirje rënëse midis viteve 2016-2021, përkatësisht 29.1, 27.8, 27.64, 27.63, 27.69, 27.18 për qind.

Brenda këtij rajoni peshën më të madhe e ka zënë qarku i Fierit, nga 10.7 për qind më 2017 në 11.14 për qind më 2019, me luhaje të lehta midis viteve 2016-2021.

Tabela 3. Kontributi ndaj rritjes reale të PBB-së në %

Kodi	Niveli statistikor 2 / 3	Kontributi ndaj rritjes reale në %				
		2017/** 2016*	2018*/ 2017	2019* /2018	2020*/ 2019	2021*/ 2020
AL	R.SH	3,82	4,07	2,11	-3,48	8,91
AL01	Veri	0,41	0,63	0,50	-1,21	1,90
AL011	Dibër	0,06	0,12	-0,09	-0,19	0,18
AL012	Durrës	0,40	0,25	0,43	-0,59	1,07
AL013	Kukës	-0,01	0,08	-0,05	-0,002	0,07
AL014	Lezhë	-0,03	-0,01	0,08	-0,20	0,18
AL015	Shkodër	-0,02	0,19	0,12	-0,23	0,40
AL02	Qendër	3,47	2,43	1,12	-1,38	5,40
AL021	Elbasan	0,05	0,25	0,06	0,02	0,46
AL022	Tiranë	3,42	2,18	1,06	-1,40	4,93
AL03	Jug	-0,06	1,01	0,49	-0,89	1,61
AL031	Berat	0,06	-0,05	-0,07	0,01	0,11
AL032	Fier	0,18	0,58	0,36	-0,58	0,66
AL033	Gjirokastrë	0,03	0,03	0,09	-0,08	0,08
AL034	Korçë	-0,13	0,14	0,11	-0,18	0,23
AL035	Vlorë	-0,19	0,31	0,02	-0,06	0,53

Pas Fierit renditen qarku i Korçës dhe i Vlorës, me përqindje të përafërta, përkatësisht 5.20 për qind dhe 5.69 për qind në vitin 2021.

Në vendin e tretë renditet rajoni i Veriut, pesha e të cilit ka ardhur në rënie nga 23.8 për qind më 2016 në 22.37 për qind më 2021. Brenda rajonit peshën më të madhe e zë qarku i Durrësit nga 9.8 për qind më 2016 në 10.14 për qind më 2019 dhe 10.06 për qind më 2021.

Tabela 4. Struktura ndaj PBB-së, në përqindje


Kodi	Niveli Statistikor 2/3	Struktura ndaj PBB-së, në përqindje					
		2016	2017	2018	2019	2020	2021
AL	RSH	100.0	100,0	100,00	100,00	100,00	100,00
AL01	Veri	23,8	23,4	23,03	23,01	22,51	22,37
AL011	Dibër	3,3	3,2	3,18	3,02	2,92	2,88
AL012	Durrës	9,8	10,1	9,92	10,14	9,93	10,06
AL013	Kukës	1,7	1,7	1,71	1,62	1,65	1,56
AL014	Lezhë	3,5	3,3	3,11	3,15	3,04	2,95
AL015	Shkodër	5,4	5,2	5,11	5,08	4,97	4,91
AL02	Qendër	47,1	48,8	49,33	49,36	49,80	50,45
AL021	Elbasan	7,1	6,8	6,74	6,61	6,84	6,73
AL022	Tiranë	40,0	42,0	42,58	42,75	42,95	43,72
AL03	Jug	29,1	27,8	27,64	27,63	27,69	27,18
AL031	Berat	3,9	3,8	3,58	3,42	3,51	3,35
AL032	Fier	11,1	10,7	10,90	11,14	10,92	10,86
AL033	Gjirokastrë	2,3	2,2	2,17	2,19	2,20	2,08
AL034	Korçë	5,9	5,5	5,37	5,36	5,39	5,20
AL035	Vlorë	5,9	5,6	5,63	5,52	5,67	5,69

5. Struktura ndaj PBB-së, në përqindje sipas qarqeve

Nëse analizojmë vetëm peshën që zënë qarqet ndaj PBB-së në shkallë vendi për vitin 2021, do të kemi paraqitjen në grafikun 1.

Kështu, vendin e parë, me 43.72 për qind e mban qarku i Tiranës, i cili është mjaft i larguar nga qarqet e tjera. Në vendin e dytë renditet qarku i Fierit me 10.86 për qind, por që pasohet shumë ngushtë nga qarku i Durrësit, me 10.06 për qind.

Më pas vijnë: qarku i Elbasanit 6.73 për qind, i Vlorës 5.69 për qind, i Korçës 5.20 për qind, i Shkodrës 4.91 për qind, i Beratit 3.35 për qind, i Dibrës 2.88 për qind, i Gjirokastrës 2.08 për qind. Renditja mbyllet nga qarku i Kukësit me 1.56 për qind.



6. PBB për frymë sipas rajoneve statistikore

PBB për frymë sipas rajoneve statistikore në lekë në shkallë vendi gjatë viteve 2017-2021 ka shënuar rritje nga 539.644 milionë lekë më 2017 në 660.168 lekë më 2021. Kjo rritje është prej 22 për qind, por nuk mban parasysh ndryshimin e inflacionit. Në këtë periudhës PBB ka pësuar një rënie në vitin 2020 në 580.521 lekë nga 592.779 lekë.

Nivele më të larta të këtij treguesi janë shënuar në rajonin Qendër nga 655.438 lekë për frymë më 2017, në 794.566 lekë në vitin 2021. Niveli i vitit 2021 në këtë rajon është 20.4 për qind më i lartë se më 2017. Brenda këtij rajoni niveli më i lartë është arritur në qarkun e Tiranës në shumën 886.000 lekë ose 31.2 për qind më shumë.

Referuar vitit 2021, pas rajonit Qendër vjen rajoni Jug me mesatarisht rreth 600 mijë lekë, pasuar nga rajoni Veri me rreth 525 mijë lekë.

Nga analiza e të dhënave të qarqeve del se pas Tiranës renditet qarku i Fierit me 714 mijë lekë, i Gjirokastrës me 682.6 mijë lekë, qarku i Durrësit me 640 mijë lekë etj.

Tabela 6. PBB për frymë sipas rajoneve statistikore

Kodi	Niveli Statistikor 2 / 3	PBB për frymë sipas rajoneve statistikore milionë lekë				
		2017	2018	2019	2020	2021*
AL	RSH	539.644	571.011	592.779	580.521	660.168
AL01	Veri	441.059	461.583	481.109	462.795	524.916
AL011	Dibër	399.580	434.333	435.332	418.566	479.281
AL012	Durrës	546.111	560.172	590.809	561.607	640.121
AL013	Kukës	337.354	362.850	359.970	362.811	394.511
AL014	Lezhë	395.256	404.529	429.699	411.413	460.846
AL015	Shkodër	387.474	410.005	426.986	412.583	467.045
AL02	Qendër	655.438	692.197	711.842	696.812	794.566
AL021	Elbasan	375.548	398.818	410.346	420.453	475.775
AL022	Tiranë	745.570	783.474	803.070	778.323	886.000
AL03	Jug	481.037	512.178	536.208	530.968	599.120
AL031	Berat	453.658	463.561	468.395	479.056	530.503
AL032	Fier	552.699	601.683	644.650	624.823	714.125
AL033	Gjirokastrë	535.193	571.991	614.081	616.749	682.622
AL034	Korçë	399.122	420.198	439.636	436.173	483.539
AL035	Vlorë	459.480	486.367	493.411	496.438	566.629

7. PBB për frymë sipas rajoneve

PBB për frymë sipas rajoneve ... Indeksi ndaj PBB-së (%) Al=100 në vitet 2016-2021 paraqitet më i lartë në rajonin Qendër, që fillon me 119 % më 2016, 121.5 % më 2017, 121.2 % më 2018 dhe bie në 120 % në dy vitet që pasojnë dhe 120.36 % më 2021. Indeksi më i lartë pas rajonit të Qendrës paraqitet në rajonin e Jugut, 90.75 për qind më 2021, por që gjithsesi nën 100.

Në nivele qarqesh, tregues më të lartë të indeksit janë shënuar në qarkun e Tiranës 134.21 për qind, Fier 108.17 për qind, Gjirokastrë 103.40 për qind etj.

Tabela 7. PBB për frymë sipas rajoneve ... Indeksi ndaj PBB-së (%) $AI=100$

Kodi	Niveli Statistikor 2/3	Indeksi ndaj PBB-së (%) $AI=100$					
		2016*	2017	2018	2019	2020	2021*
AL	RSH	100.0	100,0	100,0	100,00	100,00	100,00
AL01	Veri	82,5	81,7	80,8	81,16	79,72	79,51
AL011	Dibër	75,1	74,0	76,1	73,44	72,10	72,60
AL012	Durrës	100,0	101,2	98,1	99,67	96,74	96,96
AL013	Kukës	61,9	62,5	63,5	60,73	62,50	59,76
AL014	Lezhë	77,1	73,2	70,8	72,49	70,87	69,81
AL015	Shkodër	74,7	71,8	71,8	72,03	71,07	70,75
AL02	Qendër	119,0	121,5	121,2	120,09	120,03	120,36
AL021	Elbasan	71,2	69,6	69,8	69,22	72,43	72,07
AL022	Tiranë	135,1	138,2	137,2	135,48	134,07	134,21
AL03	Jug	92,1	89,1	89,7	90,46	91,46	90,75
AL031	Berat	83,2	84,1	81,2	79,02	82,52	80,36
AL032	Fier	105,1	102,4	105,4	108,75	107,63	108,17
AL033	Gjirokastër	100,5	99,2	100,2	103,59	106,24	103,40
AL034	Korçë	78,2	74,0	73,6	74,17	75,13	73,24
AL035	Vlorë	90,4	85,1	85,2	83,24	85,52	85,83

* Të dhëna gjysmëfinale.

8. PBB për frymë në PPS në raport përqindjeje me BE 27=100

PBB për frymë në PPS në raport përqindjeje me BE 27=100 ka shënuar një rritje relativisht të ulët në vitet në studim, nga 29.4 për qind më 2016 në 32.73 për qind më 2021, 30.4 për qind më 2017, 31.1 për qind 2018, 30.7 për qind më 201, 30.5 për qind më 2020.

Si edhe në treguesit e tjerë, edhe në raportin mesatar të PBB-së ndaj BE-së peshën më të madhe e jep rajoni Qendër, nga 35.1 për qind më 2016, në 38.19 në vitin 2021. Më pas renditen rajoni Jug dhe rajoni Veri, me tregues të përafërt midis tyre.

Tabela 8. PBB për frymë në PPS (BE28=100)

	Rajonet statistikore	PBB për frymë në PPS (BE28=100)					
Kodi		2016	2017	2018	2019	2020	2021
	Republika e Shqipërisë	29,4	30,4	31,1	30,7	30.5	31,73
	Rajone statistikore Nivel 2						
AL01	Veri	24,3	24,7	25,1	24,9	24.4	25,23
AL02	Qendër	35,1	37,0	37,7	36,9	36.6	38,19
AL03	Jug	27,1	27,2	27,8	27,8	27.7	28,80

II. STRUKTURA E VLERËS SË SHITUAR BRUTO (VSHB) SIPAS DEGËVE TË EKONOMISË DHE RAJONEVE STATISTIKORE

1. Vlera e Shtuar Bruto në bujqësi, pyje dhe peshkim

Vlera e Shtuar Bruto në bujqësi, pyje dhe peshkim ka zënë nga 21.1 për qind të VSHB 100 për qind në shkallë vendi (2018, 2021) në 22 për qind më 2020.

Rajoni Jug paraqitet me nivel më të lartë të VSHB në këtë degë të ekonomisë nga 39.1 për qind më 2019, në 42.1 për qind më 2020. Tregues më i lartë është shënuar në qarkun e Beratit, nga 45.2 për qind më 2019, në 50.2 për qind më 2020. Afërsisht në këto nivele paraqitet edhe qarku i Fierit, nga 44.2 për qind më 2018, në 48.3 për qind më 2020. Më pas renditet qarku i Korçës me një VSHB prej 39.8 për qind më 2019, në 43.2 për qind më 2021. Me këto përqindje të VSHB në bujqësi rajoni i Jugut mund të cilësohet si një qark me orientim bujqësor.

Rajoni i Veriut ka tregues më të ulët, që ndryshojnë shumë pak në vite, nga 25.4 për qind më 2021 në 26.6 për qind më 2017. Por brenda këtij rajoni ka qarqe si ai i Dibrës që VSHB në bujqësi arrin mbi 40 për qind dhe 44 për qind më 2020. Ky qark pasohet nga qarku i Lezhës dhe i Shkodrës që arrijnë në rreth dhe mbi 30 për qind.

Nivelin e ulët të VSHB të rajonit Qendër e sjell qarku i Tiranës (rreth 4 për qind), pasi qarku Elbasan arrin në rreth 40 për qind.

2. Vlera e shtuar bruto në industrinë nxjerrëse, përpunuese dhe të ujit

Industria nxjerrëse, përpunuese, energjia, uji jep nga 12.6 për qind të VSHB në shkallë vendi në 14.1 për qind më 2018 dhe 2019.

Nivel më i lartë është shënuar në qarkun e Veriut, nga 15.6 për qind më 2020 në 18 për qind më 2019 e 2020 dhe 17.4 për qind më 2021.

Në qarkun e Dibrës, ku është përqendruar industria e kromit, ky tregues arrin nga 19 për qind më 2020 në 27.1 për qind më 2017. Më pas renditet qarku i Durrësit me 18-19 për qind, i Shkodrës me 11.9 për qind më 2020 dhe 16.8 për qind më 2018, qarku i Kukësit nga 13.4 për qind më 2021 në 18.2 për qind më 2020.

Tabela 1. Struktura e VSHB në degën e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit në përqindje ndaj gjithsej

Kodi	Nivelet statistikore 2/3	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi				
		2017	2018	2019	2020	2021
AL	RSH	21,8	21,1	21,1	22,0	21,1
AL01	Veri	26,6	25,9	25,9	26,3	25,4
AL011	Dibër	39,1	40,8	40,4	44,0	41,0
AL012	Durrës	16,0	15,2	15,1	15,8	15,3
AL013	Kukës	39,8	35,6	34,2	15,8	38,1
AL014	Lezhë	31,8	31,6	31,4	30,8	30,3
AL015	Shkodër	31,8	31,0	29,9	30,3	29,9
AL02	Qendër	8,9	8,7	8,7	8,9	3,8
AL021	Elbasan	39,0	39,1	39,5	39,9	39,0
AL022	Tiranë	4,0	3,9	3,8	3,9	3,6
AL03	Jug	40,3	39,2	39,1	42,1	41,3
AL031	Berat	49,1	47,7	45,2	50,2	48,6
AL032	Fier	45,4	44,2	45,5	48,3	47,9
AL033	Gjirok.	28,4	28,7	28,3	29,1	28,1
AL034	Korçë	41,6	40,2	39,8	41,7	43,2
AL035	Vlorë	28,1	27,3	29,3	30,8	27,3

Me këta tregues, në kushtet e Shqipërisë, rajoni i Veriut mund të konsiderohet një rreth me orientim industrial, me mbizotërim të industrisë së kromit e bakrit.

Rajoni Qendër dhe rajoni Jug paraqiten me tregues të përafërt të VSHB midis niveleve 11.5 për qind e 13.5 për qind. Nga qarqe, nivele më të larta paraqiten në qarkun e Elbasanit, Fierit, Vlorës.

Tabela 2. Industria nxjerrëse, përpunuese, energjia, uji

Kodi	Nivelet statistikore 2/3	Industria nxjerrëse, përpunuese, energjia, uji				
		2017	2018	2019	2020	2021
AL	RSH	12,8	14,1	14,1	12,6	12,9
AL01	Veri	16,9	18,0	18,0	15,6	17,4
AL011	Dibër	27,1	25,8	24,1	19,0	25,2
AL012	Durrës	18,1	19,0	19,2	18,2	18,7
AL013	Kukës	14,1	17,5	15,1	18,2	13,4
AL014	Lezhë	7,7	8,8	11,0	12,1	9,4
AL015	Shkodër	14,9	16,8	15,5	11,9	16,2
AL02	Qendër	11,5	12,6	12,6	11,6	11,2
AL021	Elbasan	15,9	16,2	14,7	16,2	15,3
AL022	Tiranë	10,7	12,0	11,5	10,8	10,6
AL03	Jug	11,9	13,5	13,4	11,9	12,4
AL031	Berat	11,5	12,0	11,7	8,9	11,0
AL032	Fier	15,7	17,5	18,3	14,7	16,5
AL033	Gjirok.	8,0	9,6	9,4	10,6	10,5
AL034	Korçë	7,7	9,2	9,7	9,4	8,6
AL035	Vlorë	10,3	12,2	12,3	11,1	9,4

3. Vlera e shtuar bruto në ndërtim

Ndërtimi kontribuon në VSHB në shkallë vendi nga 10.3 për qind më 2019 dhe 2020 në 10.9 për qind më 2021.

Mbi këto nivele paraqitet rajoni Qendër nga 11.7 për qind më 2017 në 13.4 për qind më 2021. Nga të dhënat del se në këtë rajon peshën më të madhe e mban qarku i Tiranës, nga 12.5 për qind më 2017 në 14.2 për qind më 2021. Tirana vitet e fundit është kthyer në një kantier ndërtimi apartamentesh banimi dhe objekteve sociale, kulturore e turistike.

Tregues më të lartë janë shënuar në qarqet bregdetare, si në Durrës, Lezhë, Vlorë, por edhe në qarqe të tjera si Gjirokastra dhe Korça, ku turizmi ka marrë një zhvillim më të dukshëm se qarqet e tjera.

Tabela 3. Vlera e shtuar bruto në ndërtim

Kodi	Nivelet statistikore 2/3	Ndërtimi				
		2017	2018	2019	2020	2021
AL	RSH	10,5	10,3	10,3	10,3	10,9
AL01	Veri	10,2	8,8	8,8	9,1	9,3
AL011	Dibër	4,2	3,7	3,7	4,6	4,1
AL012	Durrës	11,7	10,8	9,9	9,2	10,8
AL013	Kukës	5,5	5,5	5,5	9,2	6,2
AL014	Lezhë	15,5	11,9	11,2	10,3	11,4
AL015	Shkodër	9,3	7,3	7,3	10,0	9,2
AL02	Qendër	11,7	12,3	12,3	12,0	13,4
AL021	Elbasan	6,9	5,5	5,5	6,5	8,1
AL022	Tiranë	12,5	13,4	12,4	12,9	14,2
AL03	Jug	8,6	7,8	7,8	8,1	7,6
AL031	Berat	8,4	6,2	7,3	6,1	6,6
AL032	Fier	7,2	7,0	6,4	6,4	5,9
AL033	Gjirok.	12,0	7,4	7,0	7,9	8,9
AL034	Korçë	7,7	8,1	8,0	8,5	5,4
AL035	Vlorë	11,0	10,4	11,9	12,1	13,3

4. Vlera e shtuar bruto në tregti, transport dhe hotele

VSHB në tregti, transport dhe hotele në vitet 2017-2021 ka zënë një peshë të rëndësishme në VSHB gjithsej që fillon nga 18.4 për qind më 2017 në 18.9 për qind më 2021.

Nivelet më të larta janë shënuar në rajonin Qendër, nga 21.3 për qind më 2017 në 21.6 për qind më 2021. Sigurisht që kontributin më të madh e jep qarku i Tiranës, ndërkohë që qarku i Elbasanit paraqitet në shifra modeste. Pas rajonit Qendër renditet rajoni Veri me 17.5 deri 18.2 për qind të VSHB në tregti, transport dhe hotele. Këtë mesatare e ngre qarku i Durrësit, që paraqitet me nivele 25-26 për qind. Më pas renditen qarku i Lezhës dhe i Shkodrës, të cilat, si dhe Durrësi, kanë një pjesë të vijës bregdetare të detit Adriatik.

Rajoni i Jugut kontribuon me 14-15 për qind të VSHB në shkallë vendi. Tregues më të lartë kanë qarku i Gjirokastrës dhe Vlorës.

Tabela 4: Vlera e shtuar bruto në tregti, transport dhe hotele

Kodi	Nivelet statistikore 2/3	Tregti; Transport; Hotele				
		2017	2018	2019	2020	2021
AL	RSH	18,4	18,8	18,8	18,4	18,9
AL01	Veri	17,5	17,7	17,7	17,5	18,2
AL011	Dibër	7,4	7,0	7,8	6,3	6,7
AL012	Durrës	25,1	24,6	26,2	24,8	25,6
AL013	Kukës	7,6	10,4	10,5	24,8	9,0
AL014	Lezhë	15,4	16,5	15,8	14,4	17,7
AL015	Shkodër	13,6	14,2	15,9	14,3	13,3
AL02	Qendër	21,3	21,4	21,5	21,3	21,6
AL021	Elbasan	12,4	13,7	13,7	11,6	12,3
AL022	Tiranë	22,7	22,7	23,2	22,9	23,0
AL03	Jug	14,2	14,8	14,9	14,0	14,4
AL031	Berat	9,7	11,3	11,5	12,3	11,2
AL032	Fier	11,9	13,0	11,4	12,5	11,7
AL033	Gjirok.	18,9	21,3	21,8	19,3	19,5
AL034	Korçë	15,4	14,8	15,8	13,6	15,5
AL035	Vlorë	18,9	18,1	18,8	16,1	18,4

5. Vlera e shtuar bruto në informacion dhe komunikacion

Vlera e shtuar bruto në informacion dhe komunikacion, siç mund të kuptohet, për vetë natyrën e veprimtarisë së kësaj dege, ndikon fare pak në VSHB në shkallë vendi. Si dhe në aktivitete të tjera, edhe në këtë rast peshën më të madhe e jep rajoni i Qendrës dhe sidomos qarku Tiranë, me 6.3 për qind më 2021.

Tabela 5. Informacioni dhe komunikacioni

Kodi	Nivelet statistikore 2/3	Informacioni dhe komunikacioni				
		2017	2018	2019	2020	2021
AL	RSH	3,5	3,3	3,3	3,5	3,5
AL01	Veri	1,8	1,6	1,6	1,9	1,4
AL011	Dibër	1,5	1,4	1,3	1,7	1,3
AL012	Durrës	1,7	1,7	1,8	2,0	1,2
AL013	Kukës	2,5	2,3	2,2	2,0	1,7
AL014	Lezhë	1,6	1,6	1,4	1,9	1,4
AL015	Shkodër	1,9	1,6	1,7	1,9	1,6
AL02	Qendër	5,3	5,0	5,0	5,2	5,6
AL021	Elbasan	1,8	1,6	1,4	1,5	1,0
AL022	Tiranë	5,8	5,6	5,8	5,8	6,3
AL03	Jug	2,0	1,5	1,5	1,6	1,3
AL031	Berat	1,7	1,5	1,6	1,9	1,4
AL032	Fier	2,0	1,2	1,2	1,1	0,9
AL033	Gjirok.	2,6	2,5	2,1	2,4	2,0
AL034	Korçë	1,7	1,4	1,4	1,9	1,4
AL035	Vlorë	2,2	1,7	1,8	1,9	1,7

6. Aktivitetet financiare dhe të sigurimit

Në shifra të ulëta të VSHB rezultojnë edhe aktivitetet financiare dhe të sigurimit me rreth 2.4 për qind në dy vitet e fundit. Në këto aktivitete, ndryshe nga rastet e mësipërme, peshën më të madhe e mban sektori i Veriut me 20.5 për qind.

Tabela 6: Aktivitetet financiare dhe të sigurimit

Kodi	Nivelet statistikore 2/3	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit				
		2017	2018	2019	2020	2021
AL	RSH	2,9	2,6	2,6	2.4	2,4
AL01	Veri	2,0	2,6	2,8	2,9	2,5
AL011	Dibër	1,6	1,7	2,7	4,0	2,7
AL012	Durrës	1,6	2,6	2,1	2,5	2,3
AL013	Kukës	2,3	2,7	4,6	2,5	2,5
AL014	Lezhë	3,0	4,1	3,2	4,6	4,0
AL015	Shkodër	2,3	2,3	2,3	2,1	2,1
AL02	Qendër	3,5	2,5	2,5	2,3	2,3
AL021	Elbasan	2,0	2,2	2,2	1,7	2,0
AL022	Tiranë	3,7	2,6	2,7	2,4	2,3
AL03	Jug	2,4	2,7	2,6	2,2	2,4
AL031	Berat	1,5	3,1	3,8	2,9	3,0
AL032	Fier	2,1	1,8	1,9	1,6	1,7
AL033	Gjirok.	3,8	3,8	3,7	3,3	3,5
AL034	Korçë	2,8	3,3	3,0	2,1	2,8
AL035	Vlorë	2,9	3,2	3,9	2,3	2,5

7. Aktivitetet e pasurive të paluajtshme

Përgjithësisht vërehet një rritje e lehtë e kontributit të aktiviteteve të pasurive të paluajtshme në dy vitet e fundit të analizuara (2020-2021), përkatësisht 7.1 dhe 6.5 për qind. Peshën më të madhe e mban sektori Veri me 7.3 për qind dhe sidomos qarku Durrës me 10.1 për qind më 2020 dhe 9.5 për qind më 2021. Rajoni Qendër kontribuon me 7 për qind, ku Tirana është 7.3 për qind. Më pak ndikim ka dhënë në këtë sektor rajoni i Jugut.

Tabela 7. Aktivitetet e pasurive të paluajtshme

Kodi	Nivelet statistikore 2/3	Aktivitete të pasurive të paluajtshme				
		2017	2018	2019	2020	2021
AL	RSH	6,4	6,3	6,3	7,1	6,6
AL01	Veri	6,8	6,7	6,5	7,7	7,3
AL011	Dibër	3,1	3,0	3,8	3,5	3,1
AL012	Durrës	8,9	8,7	8,0	10,1	9,5
AL013	Kukës	4,0	3,7	4,3	10,1	4,0
AL014	Lezhë	6,1	6,3	6,9	7,0	6,5
AL015	Shkodër	6,3	6,3	6,3	7,3	6,9
AL02	Qendër	7,0	6,8	6,7	7,6	7,0
AL021	Elbasan	5,2	5,1	5,7	5,6	5,1
AL022	Tiranë	7,3	7,0	7,0	7,9	7,3
AL03	Jug	5,1	5,1	5,3	5,6	5,2
AL031	Berat	3,2	3,3	4,1	3,6	3,3
AL032	Fier	4,2	4,0	4,5	4,4	3,9
AL033	Gjirok.	4,6	4,7	5,9	4,8	4,2
AL034	Korçë	5,1	5,1	5,4	5,7	5,4
AL035	Vlorë	8,6	8,2	8,1	9,5	8,9

8. Aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike

Këto aktivitete kanë zënë një peshë në shifra të qëndrueshme në VSHB në shkallë vendi që luhaten midis 7.1 dhe 7.4 për qind në pesë vitet e analizuara në këtë artikull. Peshën më të madhe e ka zënë rajoni Qendër, që shkon nga 10.7 në 11.7 për qind, ku peshën më të madhe e mban qarku i Tiranës nga 12.1 në 13.5 për qind. Në shifra të ulëta paraqitet rajoni i Jugut, që luhaten nga 2.4 në 2.7 për qind.

Tabela 8. Aktivitetet shkencore, profesionale dhe teknike

Kodi	Nivelet statistikore 2/3	Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike				
		2017	2018	2019	2020	2021
AL	RSH	7,2	7,4	7,4	7,3	7,1
AL01	Veri	3,9	4,4	4,4	4,3	4,1
AL011	Dibër	1,1	1,8	0,9	2,7	1,7
AL012	Durrës	6,0	6,7	7,1	6,2	6,3
AL013	Kukës	2,2	1,7	1,9	6,2	1,3
AL014	Lezhë	2,4	2,6	3,1	2,6	2,0
AL015	Shkodër	3,3	3,5	3,6	3,5	3,2
AL02	Qendër	11,4	11,6	11,7	11,2	10,7
AL021	Elbasan	1,9	1,8	2,2	2,4	2,0
AL022	Tiranë	13,0	13,2	13,5	12,6	12,1
AL03	Jug	2,5	2,4	2,4	2,6	2,7
AL031	Berat	1,6	1,2	1,6	1,7	1,3
AL032	Fier	2,7	2,6	2,5	2,2	2,7
AL033	Gjirokastrë	2,7	2,4	2,7	3,4	3,9
AL034	Korçë	1,7	1,8	1,7	2,0	1,6
AL035	Vlorë	3,1	3,3	4,7	4,1	3,9

9. Administrata publike, arsimi, shëndetësia etj.

Tabela 9. Administrata publike, arsimi, shëndetësia etj

Kodi	Nivelet statistikore 2/3	Adm. Publike; Arsimi; Shëndetësia etj.				
		2017	2018	2019	2020	2021
AL	RSH	13,4	13,2	13,1	14,0	14,1
AL01	Veri	12,4	12,2	12,3	12,7	12,6
AL011	Dibër	14,3	13,7	14,7	13,3	13,6
AL012	Durrës	8,5	8,7	8,9	9,4	8,5
AL013	Kukës	20,4	19,1	20,8	9,4	23,2
AL014	Lezhë	14,5	14,1	13,9	14,4	15,1
AL015	Shkodër	14,6	14,8	15,4	15,6	15,3
AL02	Qendër	15,1	14,7	14,6	16,4	16,3
AL021	Elbasan	13,3	13,3	13,9	13,2	14,0
AL022	Tiranë	15,4	14,9	15,7	16,9	16,6
AL03	Jug	11,2	11,2	11,2	10,8	11,5
AL031	Berat	12,0	11,7	12,1	11,7	12,9
AL032	Fier	7,9	7,6	7,6	7,7	7,8
AL033	Gjirok.	16,0	17,6	17,6	17,7	18,1
AL034	Korçë	13,4	13,5	13,7	13,6	14,3
AL035	Vlorë	13,1	13,2	8,0	11,0	12,7

10. Arte, argëtim, çlodhje etj

Kjo degë përfaqësohet nga shifra të ulëta që shkojnë nga 2.5 për qind në 3.1 për qind në shkallë vendi. Siç mund të kuptohet, për shkak të natyrës së aktivitetit, tregues më të lartë janë shënuar në rajonin statistikor Qendër dhe sidomos në qarkun Tiranë, që ka arritur në 4.8 për qind në vitet 2017 dhe 2018 dhe ka rënë në 4 për qind në vitet 2020 e 2021, që pjesërisht është pasojë e masave kufizuese të vendosura gjatë pandemisë së Covid 19.

Tabela 10. Arte, argëtim, çlodhje etj.

Kodi	Nivelet statistikore 2/3	Arte, argëtim, çlodhje etj.				
		2017	2018	2019	2020	2021
AL	RSH	3,0	3,1	3,1	2,5	2,6
AL01	Veri	1,9	2,0	2,0	1,9	1,7
AL011	Dibër	0,6	1,2	0,7	0,8	0,6
AL012	Durrës	2,4	2,0	1,7	1,7	1,8
AL013	Kukës	1,61	1,4	0,9	1,7	0,6
AL014	Lezhë	2,0	2,6	1,9	1,9	2,1
AL015	Shkodër	1,9	2,4	2,1	3,1	2,3
AL02	Qendër	4,3	4,3	4,4	3,6	3,7
AL021	Elbasan	1,5	1,6	1,2	1,5	1,2
AL022	Tiranë	4,8	4,8	4,4	4,0	4,0
AL03	Jug	1,7	1,8	1,8	1,1	1,3
AL031	Berat	1,3	1,9	1,1	0,8	0,7
AL032	Fier	0,9	1,1	0,7	1,0	0,9
AL033	Gjirokastër	3,2	1,9	1,3	1,3	1,2
AL034	Korçë	2,9	2,6	1,6	1,5	1,8
AL035	Vlorë	1,9	2,4	1,2	1,2	1,9

III. STRUKTURAE VSHBSIPAS DEGËVE TË EKONOMISË DHE RAJONEVE STATISTIKORE, VITI 2021

Në mënyrë të përmbledhur, struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve statistikore për vitin 2021, viti me të dhëna më të fundit të publikuara, paraqitet në *tabelën 11*.

Nga analiza e këtyre të dhënave del se vlerën më të madhe në degën e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit në raport me VSHB gjithsej në shkallë vendi e zë rajoni statistikor Jug me 53.1 për qind, ku qarku i Fierit vlerësohet me 24.7 për qind, qarku i Korçës 10.6 për qind, i Beratit 7.7 për qind, i Vlorës 7.4 për qind etj. Më pas renditet rajoni Veri me 26.9 për qind dhe rajoni Qendër me 19.9 për qind, ku dallohet qarku i Elbasanit me 12.4 për qind.

Vlerën më të madhe në **degën e industrisë nxjerrëse, përpunuese, energji dhe ujë** e ka rajoni Qendër me 42.8 për qind, i pasuar nga rajoni Veri me 30.1 për qind dhe rajoni Jug me 26.1 për qind. Në rajonin Qendër Tirana vlerësohet me 35.8 për qind në shkallë vendi.

Vlerën më të madhe në **degën e ndërtimit** e ka dhënë rajoni Qendër me 61.9 për qind ndaj VSHB gjithsej, pasuar nga dy rajonet e tjera me vlerë të barabartë prej 19 për qind. Qarku i Tiranës zë edhe peshën më të madhe me 56.9 për qind.

Rajoni Qendër zë peshën më të madhe të VSHB në **degën e tregtisë, transportit, hotelorisë** me 57.6 për qind, i pasuar nga rajoni Veri me 21.6 për qind dhe rajoni Jug me 20.7 për qind. Qarku i Tiranës vlerësohet me 53.3 për qind të VSHB gjithsej.

Në degën e **informacionit dhe komunikacionit** vlerën më të madhe e jep rajoni Qendër me 81.1 për qind, kurse dy rajonet e tjera përkatësisht 8.8 dhe 10.1 për qind.

Në degën e **aktiviteteve financiare dhe të sigurimit** vlerën më të madhe e jep rajoni Qendër me 48.7 për qind, pasuar nga rajoni Jug me 27.3 për qind dhe rajoni Veri 24 për qind.

VSHB e degës së **aktiviteteve të pasurive të paluajtshme** përfaqësohet nga rajoni Qendër me 53.6 për qind, pasuar nga rajoni Veri me 25 për qind dhe rajoni Jug me 21.4 për qind.

VSHB e degës së **aktiviteteve shkencore, profesionale dhe teknike** përfaqësohet nga rajoni Qendër me 76.5 për qind, rajoni Veri me 13.1 për qind dhe rajoni Jug me 10.3 për qind.

VSHB e degës së **administratës publike, arsimit, shëndetësisë etj.**, përfaqësohet me 58 për qind nga rajoni Qendër, nga rajoni Jug me 22.1 për qind dhe rajoni Veri me 19.9 për qind.

VSHB e degës së **arteve, argëtimit, çlodhjes** përfaqësohet nga rajoni Qendër me 71.5 për qind, pasuar nga rajoni Veri me 14.8 për qind dhe rajoni Jug me 13.7 për qind.

Në përmbledhje të këtyre të dhënave, del se rajoni Qendër jep VSHB më të lartë në strukturën e VSHB gjithsej në 9 nga 10 degë gjithsej. Siç dihet, në këtë rajon përfshihet qarku i Tiranës, i cili zë edhe peshën më të madhe në shkallë vendi. Rajoni Jug zë peshën më të madhe vetëm në degën e bujqësisë, pyjeve e peshkimit.

Tabela 11. Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve statistikore viti 2021*

Kodi	Nivelet statistikore 2/3	Bujqësitia, pyjet dhe peshkimimi	Industria, ndërtimi, energjitikja, ujë	Ndërtimi	Tregtia, transporti, hotelet	Infomacioni dhe komunikimi	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	Aktivitetet të pasurisë ve të palutajve tshmet	Aktivitetet shkenore, profesionale dhe teknike	Administrimi, publike, arsimit, shëndetësi etj.	Arte, argëtimi, çlodhjet
AL	RSH	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100
AL01	Veri	26,9	30,1	19,1	21,6	8,8	24,0	25,0	13,1	19,9	14,8
AL011	Dibër	5,6	5,6	1,1	1,0	1,1	3,3	1,4	0,7	2,8	0,6
AL012	Durrës	7,3	14,6	9,9	13,6	3,4	9,7	14,5	9,0	6,0	7,0
AL013	Kukës	2,8	1,6	0,9	0,7	0,8	1,7	1,0	0,3	2,6	0,4
AL014	Lezhë	4,2	2,2	3,1	2,8	1,2	5,0	2,9	0,8	3,2	2,5
AL015	Shkodër	7,0	6,1	4,1	3,5	2,3	4,3	5,2	2,3	5,3	4,3
AL02	Qendër	19,9	43,8	61,9	57,6	81,1	48,7	53,6	76,6	58,1	71,5
AL021	Elbasan	12,4	8,0	5,0	4,4	1,9	5,7	5,2	1,9	6,7	3,2
AL022	Tiranë	7,5	35,8	56,9	53,3	79,2	43,0	48,3	74,7	51,4	68,3
AL03	Jug	53,1	26,1	19,0	20,7	10,1	27,3	21,4	10,3	22,1	13,7
AL031	Berat	7,7	2,9	2,0	2,0	1,4	4,3	1,7	0,6	3,1	0,9
AL032	Fier	24,7	13,9	5,8	6,7	2,7	7,8	6,4	4,2	6,0	4,0
AL033	Gjirok.	2,8	1,7	1,7	2,2	1,2	3,1	1,3	1,1	2,7	0,9
AL034	Korçë	10,6	3,5	2,5	4,3	2,0	6,2	4,3	1,2	5,3	3,7
AL035	Vlorë	7,4	4,1	6,9	5,6	2,7	5,9	7,7	3,2	5,1	4,2

*2021 Të dhëna gjysmëfnale

Përfundime dhe sugjerime

Me përgatitjen dhe botimin e të dhënave të Llogarive Rajonale Statistikore sipas standardeve të EUROSTAT-it dhe BE-së, INSTAT-i prej vitit 2011 ka krijuar mundësi për njohjen më konkrete të zhvillimit të ekonomisë nga politikëbërësit dhe studiuesit në shkallë kombëtare dhe rajonale. Përdorimi i kriterëve të njëjta metodologjike me strukturat e BE-së ka krijuar kushte për krahasime të PBB, VSHB e treguesve të tjerë me mesataren e BE-së, si dhe me vendet anëtare (dhe jo të tilla) të BE-së.

Nga analiza e të dhënave të botuara në vitet e fundit (2017-2021), del se është shënuar rritje reale e PBB në katër prej tyre dhe ka pësuar rënie vetëm në vitin 2020, rrjedhojë e efekteve negative që shkaktoi pandemia e Covid 19, në Shqipëri, e kudo në botë.

Niveli më i lartë i PBB me çmime korrente gjatë këtyre viteve është shënuar në rajonin Qendër në vitin 2021, ku arriti 50.5 për qind e nivelit në shkallë vendi, rreth 2.3 herë më shumë se në rajonin e Veriut dhe 85.6 për qind më shumë kundrejt rajonit të Jugut. Qarku i Tiranës ka dhënë 87 për qind të rajonit, kundrejt vetëm 13 për qind të qarkut të Elbasanit.

Kontributi ndaj rritjes reale të PPB në shkallë vendi është ndikuar nga masa e rajonit Qendër, ku peshën më të madhe e mban qarku i Tiranës. Referuar vitit 2021, rritja mesatare në shkallë vendi është vlerësuar 8.91 për qind, rajoni Veri ka kontribuar me 1.90 për qind, rajoni Qendër 5.40 për qind, që shpreh edhe peshën më të madhe të kontributit në shkallë vendi dhe rajoni Jug 1.61 për qind. Nga këto të dhëna del se rajoni Qendër është vendimtar në uljet apo ngritjet reale të PBB-së.

Në strukturën e PBB-së, vendin e parë me 43.72 për qind e mban qarku i Tiranës, i larguar ndjeshëm nga qarqet e tjera. Në vendin e dytë renditet qarku i Fierit me 10.86 për qind, që pasohet shumë ngushtë nga qarku i Durrësit me 10.06 për qind. Më pas vijnë: qarku i Elbasanit 6.73 për qind, i Vlorës 5.69 për qind, i Korçës 5.20 për qind, i Shkodrës 4.91 për qind, i Beratit 3.35 për qind, i Dibrës 2.88 për qind, i Gjirokastrës 2.08 për qind. Renditja mbyllet nga qarku i Kukësit me 1.56 për qind.

Treguesi i PBB-së për frymë sipas rajoneve statistikore ka shënuar rritje prej 22 për qind më 2021 kundrejt vitit 2017. Nivele më të larta të këtij treguesi janë shënuar në rajonin Qendër. Niveli i vitit 2021 në këtë rajon është 20.4 për qind më i lartë se më 2017. Brenda këtij rajoni, niveli më i lartë është arritur në qarkun e Tiranës 31.2 për qind. Pas rajonit Qendër vjen rajoni Jug, pasuar nga rajoni Veri.

PBB për frymë sipas rajoneve - indeksi ndaj PBB-së (%) $AI=100$ paraqitet më i lartë në rajonin Qendër, me 120.36 % më 2021. Në nivel qarqesh, tregues më të lartë të indeksit janë shënuar në qarkun e Tiranës 134.21 %, Fier 108.17 %, Gjirokastrë 103.40 % etj.

PBB për frymë në PPS në raport përqindjeje me BE 27=100 ka pasur rritje relativisht të ulët, nga 29.4 për qind më 2016 në 32.73 për qind më 2021. Si dhe në raportin mesatar të PBB-së ndaj BE-së, peshën më të madhe e jep rajoni Qendër, nga 35.1 për qind më 2016, në 38.19 në vitin 2021. Më pas renditen rajoni Jug dhe rajoni Veri.

Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) në bujqësi, pyje dhe peshkim në kuadrin e strukturës ka zënë 53.1 për qind të VSHB sipas degëve të ekonomisë dhe rajoneve statistikore gjithsej në shkallë vendi. Qarku i Fierit vlerësohet me 24.7 për qind, qarku i Korçës 10.6 për qind, i Beratit 7.7 për qind, i Vlorës 7.4 për qind etj. Më pas vjen rajoni Veri me 26.9 për qind dhe rajoni Qendër me 19.9 për qind, ku qarku i Elbasanit arrin 12.4 për qind. Me këto përqindje, rajoni i Jugut mund të cilësohet si një qark me orientim bujqësor.

Vlerën më të madhe në **degën e industrisë nxjerrëse, përpunuese, energji dhe ujë** e ka dhënë rajoni Qendër me 42.8 për qind, i pasuar nga rajoni Veri me 30.1 për qind dhe rajoni Jug me 26.1 për qind. Në rajonin Qendër Tirana vlerësohet me 35.8 për qind në shkallë vendi.

VSHB më të madhe në **degën e ndërtimit** e ka dhënë rajoni Qendër me 61.9 për qind, pasuar nga dy rajonet e tjera me vlerë të barabartë prej 19 për qind. Qarku i Tiranës zë edhe peshën më të madhe me 56.9 për qind.

Rajoni Qendër zë peshën më të madhe të VSHB në **degën e tregtisë, transportit, hotelierisë** me 57.6 për qind, i pasuar nga rajoni Veri me 21.6 për qind dhe rajoni Jug për 20.7 për qind. Qarku i Tiranës vlerësohet për 53.3 për qind të VSHB gjithsej.

Në degën e informacionit dhe komunikacionit vlerën më të madhe e jep rajoni Qendër me 81.1 për qind, kurse dy rajonet e tjera përkatësisht 8.8 dhe 10.1 për qind.

Në degën e aktiviteteve financiare dhe të sigurimit vlerën më të madhe e jep rajoni i Qendrës me 48.7 për qind, pasuar me 27.3 për qind nga rajoni i Jugut dhe 24 për qind nga rajoni Veri. VSHB e degës së aktiviteteve të pasurive të paluajtshme përfaqësohet përsëri nga rajoni Qendër me 53.6 për qind, pasuar nga rajoni Veri me 25 për qind dhe rajoni Jug me 21.4 për qind.

VSHB e aktiviteteve shkencore, profesionale dhe teknike përfaqësohet nga rajoni Qendër me 76.5 për qind, pasuar nga rajoni Veri me 13.1 për qind dhe rajoni Jug me 10.3 për qind. VSHB e degës së administratës publike, arsimit, shëndetësisë etj. përfaqësohet me 58 për qind nga rajoni Qendër, pasuar nga rajoni Jug me 22.1 për qind dhe rajoni Veri me 19.9 për qind. VSHB e degës së arteve, argëtimit, çlodhjes përfaqësohet nga rajoni Qendër me 71.5 për qind, pasuar nga rajoni Veri me 14.8 për qind dhe rajoni Jug me 13.7 për qind.

Në përmbledhje të këtyre të dhënave, del se rajoni Qendër jep VSHB më të lartë në strukturën e VSHB-së gjithsej në 9 nga 10 degë gjithsej. Siç dihet, në këtë rajon përfshihet qarku i Tiranës, i cili zë edhe peshën më të madhe në shkallë vendi. Rajoni Jug zë peshën më të madhe vetëm në degën e bujqësisë, pyjeve e peshkimit.

Shpërpjesëtimet e thella të PBB-së me çmime korrente dhe për frymë midis rajoneve statistikore nivel 2 dhe nivel 3 (qarqeve) duhet të tërheqin vëmendjen e organeve të qeverisjes qendrore e vendore për një zhvillim ekonomik më të balancuar, për një shpërndarje më të drejtë të investimeve publike, për një ndihmë më konkrete për biznesin privat e sidomos për biznesin e vogël, për zhvillimin e turizmit dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Sipas Kushtetutës së RSh (nenit 110), qarku është njësi ku ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore. Reforma administrative-territoriale, e cila është bërë efektive prej vitit 2015 me krijimin e 61 bashkive të reja dhe vijimin e 12 qarqeve, ka krijuar kushtet që të rritet bashkëpunimi midis organeve vendore dhe atyre qendrore për hartimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm në shkallë rajonale, qarku dhe bashkie. Por, për fat të keq, përvoja e këtyre viteve të fundit tregon se organet e qeverisjes qendrore dhe vendore nuk kanë mundur ta konkretizojnë këtë detyrë kushtetuese, pasi kanë munguar bashkëpunimet e ndërsjella midis tyre.

Veç sa më sipër, vërejmë se mungojnë analizat e të dhënave të llogarive kombëtare të publikuara nga INSTAT-i dhe institucionet publike përkatëse apo qendrat studimore joqeveritare të specializuara në fushën ekonomike e sociale.

Literatura:

1. *ESA95terminology.cso.ie/en/media/csoie/methods/nationalaccountsoutputandvalueaddedbyactivity/ methodology.*
2. *EUROSTAT.*<https://ec.europa.eu/eurostat/web/nuts/overview/>
3. *Eurostat regional yearbook 2023 edition.*
4. *INSTAT. Llogaritë rajonale në Shqipëri. 2011-2021.*
5. *INSTAT. Prodhimi i Brendshëm Bruto sipas Rajoneve Statistikore në Shqipëri, 2011- 2021.*
6. *Luan Shahollari, kryeredaktor i kolegjiut të revistës “Demografia”. Llogaritë rajonale në Shqipëri: Më shumë mundësi për analiza të thelluara të PBB-së dhe treguesve të tjerë socio-ekonomikë sipas qarqeve. Revista “Demografia” nr.1, viti 2019.*
7. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, botuar në Fletoren zyrtare nr. 28/1998. Ndryshuar së fundi me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016).*
8. *Regulation (EC) No 1059/2003 of the European Parliament and of the Council of 26 May 2003, which has been amended on several occasions (in 2005, 2008, 2013 and 2017), mainly upon accession of new Member States to the EU.*
9. *Vendimi i KM nr. 1037, datë 15.12.2010, “Mbi implementimin e nomenklaturës “Shqipëria në 3 (tri) rajone NUTS II” sipas nomenklaturës mbi Njësitë Territoriale për Statistikat (NUTS) të Bashkimit Europian.*
10. *<https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-datasets/-/tec00114>*
11. *<https://www.europarl.europa.eu/factsheets/en/sheet/99/common-classification-of-territorial-units-for-statistics-nuts->*
12. *<https://www.instat.gov.al/al/temat/statistikat-e-p%c3%abrgjithshme-dhe-rajonale/rajonet/#tab4+methodscollapse8939>.*

PRIRJE TË ZHVILLIMEVE BASHKËKOHORE SOCIO-EKONOMIKE DHE OFERTA AKADEMIKE, SHKENCORE DHE E SHËRBIMEVE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM NË NIVEL RAJONAL, QENDROR DHE LOKAL

*Prof. Dr. Irena NIKAJ
Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
inikaj@unkorce.edu.al*

PËRMBLEDHJE

Punimi shqyrton kushtet socio-ekonomike në Ballkanin Perëndimor duke përdorur një sërë kriteresh për të përcaktuar prioritetet. Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor janë aktualisht në një pikë kritike në trajektoren e tyre të zhvillimit dhe kërkojnë integrim të shpejtë në Bashkimin European. Në mënyrë të veçantë, punimi fokusohet në tri prioritetet strategjike: fuqizimi i edukimit dhe kompetencave për transformimin qytetar dhe ekonomik, promovimi i kohezionit social dhe zbatimi i një tranzicioni të gjelbër që redukton ndikimet negative mjedisore. Punimi e bën këtë duke kombinuar një analizë të thellë të alternativave të politikave në fushat prioritare me rezultatet e një procesi të gjerë mësimi nga praktikatat e mira të vendeve të tjera të përparuara.

Punimi ofron propozime dhe rekomandime politikash për krijimin dhe/ose ekzekutimin e planeve të zhvillimit në nivel lokal dhe ekonomik, si dhe struktura që lejojnë partnerët të veprojnë së bashku. Në çdo ekonomi të Ballkanit Perëndimor qasja në edukim të cilësisë së lartë është një objektiv parësor. Ekziston një nevojë urgjente për të identifikuar burime të reja të rritjes së produktivitetit dhe katalizatorë të fortë për transformimin ekonomik të këtyre kombeve ndërsa strukturat e tyre ekonomike ndryshojnë në mënyrë drastike. Edhe pse të rinjtë ende po largohen në masë të madhe nga vendi dhe rajoni, ka mënyra për të rritur punësimin dhe nivelin e aftësive të të rinjve në mënyrë që të ofrohen mundësi të reja.

Në këto kushte, të përgjithshme dhe lokale, Universiteti “Fan S. Noli” ndodhet aktualisht përballë një detyre jashtëzakonisht të rëndësishme që duhet përmbushur: shfrytëzimit të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për ta shndërruar atë në një universitet lider në rajon që prin zhvillimin ekonomik, kërkimin shkencor dhe ofrimin e shërbimeve.

Fjalët kyçe: Ballkani Perëndimor, Shqipëria, zhvillim i qëndrueshëm, migrimi i të rinjve, tipologjitë e arsimit, Universiteti i Korçës.

ABSTRACT

In order to determine the priorities, the paper carefully examines the socioeconomic conditions in the Western Balkans using a number of criteria. For example, the economies of the Western Balkans are currently at a critical juncture in their development trajectory and demand quick integration into the European Union. Specifically, the paper focuses on three strategic priorities: enhancing education and competencies for civic and economic transformation, promoting social cohesion, and implementing a green transition that reduces negative environmental impacts. It does this by combining an in-depth analysis of policy alternatives in priority areas with the outcomes of an extensive process of learning from the good practices of other advanced countries.

The paper offers proposals and policy recommendations for the creation and/or execution of development plans at the local and economic level as well as structures that allow partners to operate together. In every Western Balkan economy, access to high-quality education is a primary objective. There is an urgent need to identify new sources of productivity growth and strong catalysts for these nations' economic transformation as their economic structures drastically alter. Although young people are still leaving the country in large numbers, there are ways to increase youth employment and skill levels in order to provide new opportunities.

Under this conditions, both local and general, the “Fan S. Noli” University is currently confronted with an extremely important task that must be accomplished: turning its academic and infrastructure capabilities into a leading university for economic development processes, scientific research, and service delivery.


Key words: Western Balkans, Albania, sustainable development, youth migration, typologies of education, University of Korça

Hyrje

Shqyrtimi i kujdesshëm i gjendjes socio-ekonomike në Ballkanin Perëndimor ofron disa karakteristika, si, së pari, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor janë aktualisht në një udhëkryq të rëndësishëm në trajektoren e tyre të zhvillimit. Në dekadën që çoi në krizën globale financiare të vitit 2008, shumica e ekonomive në rajon përjetuan rritje dinamike dhe zgjerim të sektorit financiar. Duke përdorur fuqinë e tyre punëtore relativisht të arsimuar mirë dhe marrëdhëniet e ngushta me Europën dhe shumë pjesë të botës, ekonomitë rajonale u hapën dhe tërhoqën investime të konsiderueshme. Si rezultat, të ardhurat u rritën dhe standardi i jetës u përmirësua. Procesi i integritimit në Bashkimin Evropian (BE) ka qenë një shtytës qendror i demokratizimit, paqes dhe ndërtimit të institucioneve dhe ka hapur shumë mundësi për rajonin. Megjithatë, pasojat e krizës globale financiare të vitit 2008 dhe pandemia COVID-19 zbuluan gjithashtu sfida që pengojnë përparimin e rajonit. *Fillimisht*, gjetja e burimeve të reja të rritjes së produktivitetit dhe motorëve të rinj shtytës për transformimin ekonomik dhe strukturor shfaqet si një detyrë parësore për të gjitha ekonomitë. Tregjet me performancë të dobët të punës i kanë lënë shumë qytetarë pa mundësi tërheqëse punësimi dhe kanë thelluar pabarazitë dhe grupe shoqërore në kufijtë e varfërisë vazhdojnë të jenë ende një çështje që pret dhe kërkon ndërhyrje që të përmirësojnë gjendjen.

Së dyti, krijimi i mundësive dhe sigurimi i rritjes së qëndrueshme të standardit të jetesës janë ndërhyrje kyç për ta bërë rajonin një vend tërheqës për të jetuar, punuar dhe investuar. Të marra së bashku, tri prioritetet strategjike vendosin themelin për krijimin e mundësive për të gjithë. Vlerësimi i mundësive dhe kufizimeve nga Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik tregohet përmes vlerësimit 5P, që janë 5 prioritetet (njerëzit, përparimi, partneritetet, planeti dhe paqja) e zhvillimit të qëndrueshëm, i publikuar në qershor 2021.

Figura 1. 5 prioritetet strategjike të zhvillimit të qëndrueshëm¹⁾




Ky vlerësim i prioriteteve kombinon analizën e thelluar të alternativave të politikave në fushat prioritare me rezultatet e një procesi të gjerë të të mësuarit nga praktikatat e mira të të tjerëve të përparuar, sidomos në tri prioritetet strategjike: rritja e edukimit dhe kompetencave për transformimin qytetar dhe ekonomik; nxitja e kohezionit social; dhe zbatimi i një tranzicioni të gjelbër që redukton ndikimet negative mjedisore. Vlerësimi ofron rekomandime dhe sugjerime politikash për zhvillimin dhe/ose zbatimin e strategjive të zhvillimit në nivel ekonomik ose rajonal, si dhe korniza brenda të cilave partnerët mund të bashkëpunojnë.

1) OECD (2021), Multi-dimensional Review of the Western Balkans: Assessing Opportunities and Constraints, OECD Development Pathways, OECD Publishing, Paris, <https://dx.doi.org/10.1787/4d5cbc2a-en>.

1. Fuqia punëtore, trajnimi, ritrajnimi dhe përshtatja me tregun e punës

Forumi Ekonomik Botëror (WEF) ka theksuar se ndryshimi teknologjik, prirjet gjeo-ekonomike dhe tranzicioni i gjelbër paraqesin sfida të mëdha për jetesën e njerëzve dhe po transformojnë rrënjësisht tregjet e punës. Raporti për perspektivën e vendeve të punës në të ardhmen i 2023-shit tregon se deri në vitin 2027 43% e vendeve të punës do të automatizohen. Prandaj nevojiten investime urgjente në kapitalin njerëzor për të krijuar një botë më të drejtë, duke siguruar që njerëzve t'u jepet mundësia të përmbushin potencialin e tyre dhe të rritin në mënyrë domethënëse standardin e jetesës.

Figura 2. Punët që do të kryejnë makinat dhe njerëzit, në përqindje (Burimi: WEF 2024)²⁾



2) World Economic Forum (WEF 2024, <https://www.weforum.org>)

Forumi Ekonomik Botëror parashikon gjithashtu një të dhënë neto të përgjithshme pozitive në raportin midis rritjes dhe rënies së vendeve të punës. Megjithatë, nëse prirjet aktuale vazhdojnë, programet e vjetruara të të mësuarit do të përkeqësojnë më tej mospërputhjen e aftësive me kërkesat në të ardhmen, sepse vetëm 0.5% e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) global investohet aktualisht për të mësuarit gjatë gjithë jetës për të rriturit. Megjithatë, hulumtimi i Forumit i bërë në bashkëpunim me PwC (firma konsulence dhe shërbimesh) tregon se investimi në rikualifikimin dhe përmirësimin e aftësive të fuqisë punëtore aktuale globale ka potencialin për të rritur PBB-në me 6.5 trilionë dollarë deri në vitin 2030, ndërsa investimi në edukimin që ofrohet për brezin e sotëm të fëmijëve të moshës shkollore si përgatitje për kërkesat në të ardhmen mund të rritet me 2.54 trilionë dollarë shtesë gjatë së njëjtës periudhë.

Forumi ka ndërtuar platformën e revolucionit të ritrajnimit mbështetur në tri drejtime për të krijuar ndikim të prekshëm:

- Përfshirja e burimeve,
- Harmonizimi i zgjidhjeve,
- Lidhja e palëve të interesuara.

Udhërrëfyesi i iniciativës për 2024-2025³⁾ përfshin përsheptimin e rikualifikimit dhe ngritjes së aftësive në mbarë botën, nxjerrjen në sipërfaqe të modeleve të të mësuarit të përmirësuara nga inteligjenca artificiale (AI) dhe ruajtjen e fokusit gjeografik përmes nxitjeve zhvillimore rajonale. Ndikimi arrihet nëpërmjet një kombinimi të nismave të udhëhequra nga partnerë që kanë interes të investojnë në zhvillimin e fuqisë së tyre punëtore ose në zhvillimin e strategjive të zhvillimit në zgjerimin e bizneseve dhe zhvillojnë nisma në nivel vendi.


Gjenerata e milenials mund të jetë brezi më i madh në fuqinë punëtore të sotme. Por fuqia punëtore moderne përbëhet nga katër breza, secili me kërkesa unike dhe nivele gjithnjë në rënie të angazhimit. Që kompanitë të funksionojnë në mënyrë efektive në këtë mjedis të pritjeve të ndryshme, duke tërhequr, mbajtur dhe angazhuar njëkohësisht punonjës të rinj, ato duhet të modernizojnë së pari komunikimin dhe ndërveprimin në kuadër të organizatës.

3) World Economic Forum (WEF 2024, <https://www.weforum.org>)

Gjenerata Z përbëhet nga njerëz të lindur pas vitit 1996, dhe sipas parashikimeve kjo gjeneratë do të përbëjë rreth 30% të fuqisë punëtore deri në vitin 2030. Gjenerata Z mund të ketë disa karakteristika të mbivendosura me milenials dhe gjeneratat e tjera, por ka disa karakteristika specifike që e përcaktojnë personalisht, profesionalisht dhe në mënyrë holistike brezin e ri të profesionistëve.

Me fillimin e këtij ndryshimi në fuqinë punëtore, do të ketë gjithashtu një ndryshim në njerëzit me të cilët bashkëpunojmë, njerëzit që do t'i shohim si menaxherë dhe drejtues dhe njerëzit që do të frymëzojnë përparimin në ekonomi dhe industri.

Grafiku 1. *Projeksioni i fuqisë punëtore në botë deri në vitin 2030 (Burimi: Departamenti i Punës i ShBA-së, www.dol.gov)⁴⁾*



Disa mënyra për të mbajtur të lidhur me interesin për punën gjeneratat e reja (milenials, Z) janë:

- Shpërblimet dhe përparimi në karrierë;
- Përfshirja e teknologjive të reja;

⁴⁾ Departamenti i Punës i ShBA-së, www.dol.gov

- Përgatitja e *gjeneratës Z* dhe *milentials* për t'u bërë menaxherë;
- Komunikim dhe bashkëpunim;
- Kontrolli i niveleve të larta të stresit.

Përfshirja e burimeve ka nevojë edhe për mbështetjen e integritetit të grave në tregun e punës duke përfshirë inkurajimin e sipërmarrjes së tyre që të lejojë që ekonomitë e Ballkanit Perëndimor të përdorin kapitalin e tyre njerëzor duke nxitur kohezionin social. Pavarësisht ndryshimeve midis ekonomive të Ballkanit Perëndimor, hendeuku gjinor rajonal në fuqinë punëtore aktive (rreth 20 pikë përqindje) është dukshëm më i lartë se mesatarja e OECD-së dhe BE-së (përkatësisht 16.5 dhe 12.4 pikë përqindjeje). Në të gjithë rajonin, edhe në Shqipëri, gratë përballen me pengesa të shumta për punësimin formal, duke përfshirë mungesën e kujdesit të disponueshëm për fëmijët, pengesat institucionale dhe normat sociale. Pjesëmarrja e ulët në tregun e punës do të thotë se gratë duhet t'i japin përparësi kujdesit për fëmijët në vend të punësimit. Mungesa e organizimit fleksibël të punës dhe normave sociale, të tilla si stereotipat gjinorë dhe kultura patriarkale, gjithashtu kufizojnë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.⁵⁾

Ndryshimet që kanë përfshirë shoqëritë më të përparuara ofrojnë domosdoshmërinë e një kujdesi, vëmendjeje dhe të politikave më relevante për edukimin dhe rolin e tij në ecjen përpara të ekonomisë dhe shoqërisë si një e tërë, në rajon dhe në Shqipëri.

2. Zhvillimi dhe perspektiva e edukimit të lartë në Shqipëri

Vlerësimi i perspektivës së zhvillimit të Ballkanit Perëndimor lidhet ngushtësisht me transformimin e edukimit dhe të mësuarit bazuar në kompetencat për transformimin ekonomik të të gjitha ekonomive të rajonit. Ndërsa strukturat ekonomike ndryshojnë ndjeshëm nga një ekonomi në tjetrën, gjetja e burimeve të reja të rritjes së produktivitetit dhe motorëve shtytës për transformimin e ardhshëm është një detyrë urgjente për të gjitha ekonomitë rajonale. Punët e mira dhe tërheqëse janë të pakta dhe të rinjtë vazhdojnë të largohen. Rritja e kompetencave të të rinjve dhe fuqisë

5) Nikaj, I & Titili, D. Cultural and socio-economic sources of the gender pay gap in Albania, Demographic Journal, Nr.1/ 2023

punëtore mund të hapë mundësi të reja për të kapërcyer këto prirje. Sa më i pafavorshëm të jetë raporti aktual midis pagave ndaj produktivitetit të një ekonomie, aq më urgjente bëhet gjetja e veprimtarive prodhuese dhe të shërbimeve të reja dhe më produktive për të ndërtuar një ekonomi të fortë.

Edukimi cilësor kryeson listën e prioriteve për të siguruar të ardhmen e qëndrueshme në Shqipëri dhe në rajon. Edukimi cilësor është një element thelbësor i cilësisë së jetës për të gjithë: të rinjtë në shkollë, familjet, për ata që duan mundësi për fëmijët e tyre, ata që duan të kenë fëmijë në të ardhmen dhe ata që varen nga brezat e rinj për të formuar të ardhmen e shoqërive të tyre. Përtej inovacionit dhe mundësive ekonomike, edukimi ka rëndësi edhe për angazhimin qytetar, respektin për diversitetin dhe për forcimin e sundimit të ligjit.

Perspektiva ndërtohet, para së gjithash, duke e parë si proces kyç transformimin digjital të sistemit arsimor shqiptar për të forcuar kompetencat e fuqisë punëtore të ardhshme dhe për të krijuar mundësi të reja në sektorin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit në zhvillim, sepse në nivel global mjetet digjitale dhe përdorimi i tyre janë bërë një pjesë gjithnjë e më e rëndësishme e shkollimit. Aplikimi i teknologjive digjitale nënkupton përdorimin e kompjuterëve dhe teknologjive për disa qëllime: për të hyrë në internet, për të marrë dhe ndarë njohuritë mes nxënësve dhe mësuesve, për të mbledhur të dhëna dhe për të matur performancën, për të konstruktuar rrjete të të mësuarit bashkëpunues, për të zgjidhur problemet dhe për të nxitur aftësitë krijuese midis studentëve. Teknologjia digjitale nuk gjeneron mrekulli e vetme, ajo ka nevojë për mësues të aftë. Shkathtësia në përdorimin e teknologjive digjitale ofron gjithashtu mundësi rritjeje në sektorin në zhvillim të TIK-ut dhe është një mjet kyç për të rritur produktivitetin në të gjithë sektorët ekonomikë, duke treguar rëndësinë që ka për të rriturit e aftë për punë kompetenca digjitale.

Në nivelin e edukimit formal, duke u mbështetur në standardet e përpunuara rishtas të mësuesve, zhvillimi dhe zbatimi i një sistemi të vlerësimit të performancës i lidhur me përparimin në karrierë dhe rritjen e trajnimit të mësuesve janë tri veprime prioritare për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Në shkollat profesionale, por jo vetëm në to, mungesa e mësuesve të përkushtuar të TIK-ut është ndër pengesat kryesore për zhvillimin e aftësive digjitale të nxënësve: matjet tregojnë se 77% e mësuesve pranojnë se kanë nevojë për trajnim në përdorimin e TIK-ut për qëllime mësimore. Me gjithë trajnimet që janë bërë, shfaqet domosdoshmëria e formimit digjital të mësuesve gjatë edukimit universitar të tyre.

Përtej edukimit formal, Shqipëria duhet të mbështesë programet profesionale dhe të theksojë mësimin e bazuar në punë (*learning by doing*), veçanërisht në lidhje me teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Mësimi i bazuar në punë është ende në fillim në Shqipëri dhe ende jo i detyrueshëm për arsimin fillor. Duke qenë se TIK-u është ndër sektorët me rritje më të shpejtë në Shqipëri dhe ka tërhequr investitorë të huaj, kjo është një mundësi e humbur. Në vitin 2018 sektori i TIK-ut përbënte 2.9% të PBB-së, megjithatë firmat inovative në Shqipëri përballen me pengesa më të larta kur kërkojnë punonjës të rinj, si për detyra rutinë ashtu edhe për ato jo rutinë.⁶⁾

Për të plotësuar ndërhyrjet e mësipërme, Shqipëria duhet të përmirësojë infrastrukturën e saj digjitale, e cila mbetet një pengesë për aplikimin e teknologjive digjitale në shkolla dhe më gjerë. Shkollave në Shqipëri u mungojnë kompjuterët dhe kanë akses të dobët në internet; me rreth 0.2 kompjuterë për nxënës, shkollat janë thelbësisht nën mesataren e vendeve të OECD-së prej 0.8. Për më tepër, ndërsa pothuajse të gjithë kompjuterët e shkollave në vendet e OECD-së janë të lidhur me internetin, në Shqipëri kjo shifër është pak më shumë se 70%. Edhe pse në përmirësim, në vitin 2020 vetëm 25% e shkollave shqiptare kishin akses në internet me një shpejtësi mbi 10 Mbps (megabajt për sekondë).⁷⁾ Po kështu, vetëm një e treta e nxënësve ndjekin shkollat ku në mënyrë aproksimative mendohet se ka mbështetje efektive në internet, krahasuar me më shumë se gjysmën e nxënësve në vendet e OECD-së. Nga ana tjetër, më pak se gjysma e nxënësve shqiptarë ndjekin shkollat ku titullarët dhe drejtuesit tregojnë se disponojnë softuerë adekuatë, krahasuar me më shumë se dy të tretat e nxënësve në vendet e OECD-së.⁸⁾

Shqipëria duhet të zhvillojë korniza për aftësitë dhe kompetencat digjitale dhe të përcaktojë kualifikimet dhe kurrikulat e TIK-ut, veçanërisht në bashkëpunim me sektorin privat. Ndërsa Agjenda Digjitale Shqiptare

6) Banka Botërore 2020, <https://www.worldbank.org>

7) OECD (2021), Multi-dimensional Review of the Western Balkans: Assessing Opportunities and Constraints, OECD Development Pathways, OECD Publishing, Paris, <https://dx.doi.org/10.1787/4d5cbc2a-en>.


8) OECD (2020), Education in the Western Balkans: Findings from PISA, PISA, OECD Publishing, Paris, <https://dx.doi.org/10.1787/764847ff-en>.

2015–2020 ka theksuar rëndësinë e integritit të përdorimit të TIK-ut në sistemin arsimor dhe Korniza Kombëtare e Kurrikulës Parauniversitare e përmend atë si një nga shtatë kompetencat kyçe për edukimin e përgjithshëm dhe profesional, të dy dokumentet nuk kanë asnjë kuadër konkret se si duhet të integrohen aftësitë dhe kompetencat digjitale në praktikën e të mësuarit.⁹⁾ Kualifikimet dhe kurrikulat e TIK-ut nuk janë ende të përcaktuara brenda Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Për zhvillimin e kurrikulave, përfaqësuesit e industrisë duhet të bashkëpunojnë në përcaktimin e rezultateve të të nxënësve. Krijimi i një qasjeje koherente për zhvillimin e aftësive digjitale në të gjitha nivelet e sistemit arsimor është i rëndësishëm.

Kërkesat që parashtrohen më sipër nuk mbështeten nga rezultate të qëndrueshme dhe në rritje nga matjet e PISA 2022. Rezultatet mesatare të vitit 2022 ishin në rënie në krahasim me vitin 2018 në matematikë, lexim dhe shkencë. Në Shqipëri nxënësit raportuan se kishin shpenzuar dukshëm më pak përpjekje për PISA në vitin 2022 në krahasim me vitin 2018 dhe ka të dhëna të besueshme se studentët nuk u angazhuan seriozisht gjatë gjithë testit dhe pyetësorit. Rënia e rezultateve të nxënësve në Shqipëri, e vërejtur në PISA 2022, duket se lidhet me faktorë të ndryshëm.

Në fund të vitit 2019 një tërmet i fortë goditi Shqipërinë, duke shkaktuar dëme të mëdha në infrastrukturë, përfshirë shkollat dhe shtëpitë, në 12 qytete kryesore. Rreth gjysma e nxënësve pjesëmarrës në PISA 2022 (50.5%) janë me origjinë nga qytetet më të goditura nga tërmeti. Deri në prill 2022, kur u zhvillua PISA, këta nxënës kanë vijuar mësimet jashtë shkollave të tyre të rregullta, me turne dhe orë të reduktuara. Pandemia e Covid-19 i shtoi sfidat me të cilat u përball sistemi arsimor në Shqipëri në vitet 2020-2021: gjendja e infrastrukturës digjitale paraqiste vështirësi të mëdha për përdorimin efektiv të mësimi online dhe në distancë. Ndërprerjet e shkaktuara nga tërmeti dhe Covid-19 në gjendjen psiko-sociale të nxënësve dhe studentëve mund të kenë ndikuar negativisht në angazhimin e studentëve në PISA 2022.

9) ETF (2018), Digital Skills and Online Learning in Albania. Digital Factsheet December 2018

Grafiku 2. Të dhënat për matjen PISA 2000-2022¹⁰⁾

Duke pasur parasysh hendekun e aftësive të fuqisë punëtore aktuale, aftësitë digjitale duhet të bëhen gjithashtu një pjesë integrale e mësimi të të rriturve. Strategjia e Shqipërisë për Punësimin dhe Aftësitë 2019–2022 nuk i ka trajtuar aftësitë digjitale si prioritet, ndërsa ekonomitë e tjera rajonale kanë kohë që kanë filluar të trajtojnë hendekun e aftësive digjitale midis të rriturve.¹¹⁾ Në krahasim me shumë standarde ndërkombëtare, studentët nga shtresat e pafavorizuara në Shqipëri kanë performuar relativisht mirë. Megjithatë ekziston një hendek performance prej 61 pikësh midis studentëve nga familjet e pafavorizuara (sektori i poshtëm i indeksit PISA të statusit ekonomik, social dhe kulturor) dhe atyre nga sektori i parë në krye, kjo diferencë është më e vogël se në OECD (89 pikë). Studentët shqiptarë nga familjet e pafavorizuara janë gjithashtu akademikisht relativisht më elastikë – duke shënuar 12.3% ndaj 11.3% në OECD (OECD, 2019).¹²⁾

10) PISA 2022 RESULTS: FACTSHEETS – ALBANIA © OECD 2023

11) OECD (2021), OECD Statistics (database), OECD Publishing, Paris, <https://stats.oecd.org>

12) OECD (2019), Getting Skills Right: Future-Ready Adult Learning Systems, Getting Skills Right, OECD Publishing, Paris, <https://dx.doi.org/10.1787/9789264311756-en>

Në vazhdim, ofrimi i mbështetjes për fëmijët nga familjet e pafavorizuara, veçanërisht ata që jetojnë në zonat rurale, mund të mbyllë më tej hendekun dhe dallimet në edukim. Të rinjtë që jetojnë në rajonet urbane të Shqipërisë kalojnë mesatarisht dy vite më shumë në shkolla sesa bashkëmoshatarët e tyre në zonat rurale. Duke marrë parasysh se rreth 40% e shqiptarëve jetojnë në zona rurale dhe malore, edukimi jociësor e prek shumë këtë grup.

Distanca e mëdha ndërmjet shkollës dhe shtëpisë, mungesa e mbështetjes motivuese për mësuesit për të punuar në zonat rurale (pavarësisht numrit të madh të mësuesve në nivel kombëtar të papunësuar), detyrimet e fëmijëve për të kontribuar në të ardhurat e familjes dhe martesat e hershme (veçanërisht në mesin e komuniteteve etnike dhe kulturore, si romët dhe egjiptianët) janë disa nga faktorët që kontribuojnë në pabarazi të tilla.

Ndërkohë që Shqipëria ka bërë përpjekje të rëndësishme për të trajtuar ndarjen urbane-rurale, duke përfshirë futjen e mbështetjeve financiare për transportin e stafit mësimdhënës, ka nevojë për paketa më të plota të politikave arsimore dhe mbrojtjes sociale, veçanërisht në zonat që kanë mbetur pas. Ndër të tjera, stimuj gjithëpërfshirës financiarë dhe të zhvillimit të karrierës mund të përdoren për të inkurajuar mësuesit e mirë që të punojnë në zona të vështira. Përveç kësaj, duhet të jepet mbështetje e mjaftueshme (p.sh., përmes mundësive të rrjetëzimit) për të ndihmuar mësuesit e rinj dhe me përvojë që të punojnë në mënyrë efektive në shkollat rurale.

Qasja më e mirë në edukim për pakicat etnike apo kulturore, si romët dhe egjiptianët ballkanikë, është gjithashtu e rëndësishme për sigurimin e integritetit të tyre, krijimin e mundësive të reja dhe nxitjen e kohezionit social në të gjitha grupet. Disa vlerësime tregojnë se rreth gjysma e fëmijëve romë të moshës 6-16 vjeç nuk janë regjistruar kurrë në shkollë, ndërsa rreth 50% studentë romë dhe egjiptianë janë ndër shkallët më të larta të braktisjes së shkollës: mesatarisht, romët kanë rreth 4.4 vite shkollim krahasuar me 9.6 vjet mes joromëve. Romët gjithashtu ngelen pas për sa u përket rezultateve të edukimit: me një shkallë të shkrim-leximit prej rreth 65%, popullsia rome është rreth 30 pikë përqindjeje prapa popullsisë jorome.

Shqipëria ka bërë përpjekje të rëndësishme për të përmirësuar arritjet në edukim për popullatën rome dhe egjiptiane, megjithatë do të ishte e rëndësishme të rriteshin veprimtari të tilla. Disa ndërhyrje politike përfshijnë masa të tilla, si një program rimbursimi të teksteve shkollore dhe përpjekje

për të promovuar identitetet rome dhe egjiptiane si një pjesë integrale e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë etj. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2015-2020,¹³⁾ promovoi integrimin e këtyre grupeve të marginalizuara.

Gjatë dhe pas pandemisë COVID-19 rikuperimi i të mësuarit lipsej të trajtohej me një vëmendje të shtuar te barazia dhe përfshirja. Ndërsa Shqipëria është ende duke luftuar me pasojat e pandemisë, rimëkëmbja e të mësuarit do të duhet të jetë çelësi i përparimit dhe rritjes ekonomike. Nxënësit dhe studentët me më pak burime shtëpiake, për sa i përket aksesit në mësimin online në shkollë, si dhe mbështetjes prej prindërve dhe burimeve të tjera kulturore si librat, ka të ngjarë të kenë mbetur prapa siç e tregojnë disa të dhëna dhe matje.

Një raport i OECD-së¹⁴⁾ grumbulloi përvojat e shoqërive të ndryshme në reagimin ndaj pandemisë, duke përfshirë menaxhimin e periudhave të mbylljes së shkollave dhe rihapjes së mëvonshme. Përvoja nga pandemia ka shtruar për zgjidhje disa çështje, si realizimin e ndërhyrjeve të synuara, të përshtatura me kërkesat lokale, për të mbështetur nxënësit me pak burime digjitale në shtëpi. Së dyti, zhvillimi i modeleve “hibride” të mësimdhënies dhe të nxënësve, të cilat bashkojnë mësimdhënien ballë për ballë (në masën më të mundshme) me përdorimin e burimeve digjitale dhe të mësuarit online. Në rrethana të tilla, studentëve vulnerabël, të cilëve u mungojnë burimet digjitale shtëpiake, duhet t’u mundësohet mësimi në klasa.

Në Shqipëri Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përgjegjësinë kryesore për arsimin në të gjitha nivelet, me përjashtim të formimit profesional, i cili menaxhohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ministria e Arsimit dhe Sportit është përgjegjëse, gjithashtu, për drejtimin strategjik, por gjatë dy dekadave të fundit ka transferuar shumë përgjegjësi për menaxhimin e shkollave, pjesërisht përmes krijimit të drejtorive dhe zyrave rajonale që menaxhojnë zbatimin e politikave. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Arsimit për vitet 2021-2026¹⁵⁾ ka siguruar një koordinim dhe bashkëpunim të fortë në zbatimin e politikave arsimore.

13) OECD (2020), “The impact of COVID-19 on student equity and inclusion: supporting vulnerable students during school closures and school re-openings”, OECD Policy Responses to Coronavirus (COVID-19), OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/d593b5c8-en>.

14) Po aty.

Në kuadrin e Strategjisë së mëparshme të Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar (2014-2020), zbatimi i politikave të ndryshme shpesh ka ndodhur në izolim me një koordinim të kufizuar ndërmjet agjencive të ndryshme. Duke qenë se kompetencat kryesore për politikat arsimore janë ndarë midis dy ministrive, siç përshkruhet më sipër, bashkërendimi dhe bashkëpunimi solid është edhe më i rëndësishëm.

Vlerësimi ka luajtur dhe do të luajë një rol kyç për strategjinë e re arsimore dhe politikëbërjen. Shqipëria ka bërë përparime domethënëse në zhvillimin e një sistemi informativ modern të menaxhimit të arsimit (EMIS), i cili ofron një bazë solide dhe faktike për të kryer vlerësimin. Mungesa e të dhënave të cilësisë së lartë dhe një kulturë relativisht e dobët e vlerësimit kufizojnë përdorimin e vlerësimit për të përmirësuar politikat. Si rezultat, monitorimi dhe raportimi i rregullt mbi progresin ka qenë i kufizuar, dhe si rrjedhim nuk ofron informacion adekuat për të adresuar kufizimet e kapaciteteve. Aktualisht, monitorimi në kohë reale i të dhënave administrative nuk është i mundur për shkak të procedurave të gjata të raportimit të të dhënave nga shkollat, fillimisht në zyrat arsimore lokale dhe më pas në drejtoritë rajonale që përpilojnë të dhëna dhe i ndajnë ato me ministrinë.

Shqipëria ka nevojë të forcojë ndikimin e vlerësimeve të jashtme të shkollave duke ndërtuar kapacitetet e drejtorisë arsimore rajonale për të kryer vlerësime të paanshme. Në vitin 2019 Shqipëria riorganizoi sistemin e saj të jashtëm të vlerësimit të shkollave duke zhvendosur përgjegjësinë nga agjencia e pavarur e inspektoratit të shkollave në drejtoritë arsimore rajonale (DAR). Më parë, për shkak të kufizimeve buxhetore, agjencia e inspektoratit ishte në gjendje të kryente vetëm disa vlerësime të jashtme. Aktualisht, çdo DAR ka vetëm katër persona të dedikuar për këtë punë, ndërsa Shqipëria numëron gjithsej 3759 shkolla në nivelet fillore dhe të mesme.¹⁶⁾ Duke qenë se DAR-et kanë gjithashtu rolin e mbështetjes së shkollave për të përmirësuar performancën e tyre, integriteti i vlerësimit të tyre të jashtëm për të njëjtat shkolla mund të rrezikohet. Këto 4-5 vitet që kanë kaluar nga implementimi i këtij ndryshimi nuk provojnë se ndërhyrja

15) Agjencia e Sigurimit të Cilësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, <https://arsimi.gov.al/>

16) Wort, M., D. Pupovci and E. Ikononi (2019), Appraisal of the Pre-University Education Strategy 2014-2020, UNICEF, <https://www.unicef.org>

ka dhënë rezultate pozitive domethënëse; në pikëpamjen tonë, agjencitë e pavarura të vlerësimit, duke mos qenë në konflikt interesi, janë më të besueshme, më të gatshme dhe më eksperte për të realizuar vlerësime objektive për edukimin, por edhe në fusha të tjera.

Tre faktorë kyç kanë kapacitetet për të bërë real ndryshimin: sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë, digjitalizimi dhe kompetenca e qeverisjeve vendore.

Sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë krijon jo vetëm progres, por edhe besueshmëri në opinionin publik ballkanik dhe shqiptar, të ushqyer vazhdimisht me premtime të pambajtura. Qeveritë në Ballkanin Perëndimor kanë prodhuar tashmë një sasi dhe cilësi mbresëlënëse të teksteve dhe strategjive ligjore. Megjithatë, zbatimi në praktikë shpesh mbetet i ngadalshëm. Strukturat joefikase qeveritare dhe mungesa e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve janë identifikuar si kufizime kryesore. Strukturat shtetërore priren të jenë tepër komplekse, duke përfshirë shpesh ministri dhe agjenci të shumta pa linja të qarta përgjegjësie. Kjo vonon vendimet dhe ka implikime për koston, kohën dhe burimet.

Ndryshimet e shpeshta politike dhe mbrojtja e pamjaftueshme kundër ndikimit të padrejtë janë burime të tjera vonese dhe pengesash. Në të njëjtën kohë, qytetarët vlerësojnë shumë lart sundimin e ligjit, qeverisjen e mirë dhe politikëbërjen efektive në vizionet e tyre për një të ardhme të mirë gjatë sondazheve dhe vlerësimeve që janë kryer sistematikisht. Arritja e konsensusit në lidhje me objektivat dhe sigurimi i ofrimit dhe zbatimit efektiv publik janë elemente thelbësore të qeverisjes së mirë që mbështesin arritjen e prioriteteve strategjike.¹⁷⁾

Së dyti, digjitalizimi mund të transformojë qeveritë dhe të përmirësojë ofrimin e shërbimeve publike; potenciali i tij duhet të eksplorohet plotësisht. Shembuj të ekonomive me përshtatje të hershme, si Estonia, tregojnë se digjitalizimi mund të ndihmojë në riinxhinierimin e strukturave të administratës publike për performancë më të lartë me kosto më të ulët. Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor kanë bërë përparim të rëndësishëm në përshtatjen e teknologjive digjitale. Nga 193 kombet e listuara në indeksin e përbërë EGD15 (zhvillimi i e-Government) të OKB-së, ato renditen në

17) OECD (2021), Multi-dimensional Review of the Western Balkans: Assessing Opportunities and Constraints, OECD Development Pathways, OECD Publishing, Paris, <https://dx.doi.org/10.1787/4d5cbc2a-en>.

rangun e mesëm: Serbia (58), Shqipëria (59), Maqedonia e Veriut (72) dhe Mali i Zi (75).¹⁸⁾

Së treti, qeverisja vendore ka nevojë për kapacitete më të afta/eksperte për të përshtatur shërbimet sipas nevojave lokale. Në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor qeveritë vendore kanë rol kyç për zbatimin dhe ofrimin e shumë programeve dhe shërbimeve qeveritare (p.sh., edukimi, kujdesi shëndetësor, ndihma sociale, shërbimet e furnizimit me ujë dhe përpunimit të mbeturinave). Megjithatë, shpesh ata nuk i përmbushin rolet e tyre. Shumë nivele të administrimit vendor me staf të konsiderueshëm shpenzojnë pjesën më të madhe të buxheteve të tyre për paga. Matjet që janë bërë tregojnë se shërbimet e ofruara nuk janë në përputhje me atë që shpenzohet për ofrimin e tyre. Mbikëqyrja/ndërhjyra politike shpesh luan një rol të madh në punësimin në nivel vendor. Në disa ekonomi, stimujt që rregullojnë shpërndarjen e fondeve qendrore për qeveritë vendore çojnë në punësime të tepërta, në vend të investimeve të zgjuara dhe efikase të bazuara në performancë. Ndërsa strukturat ndryshojnë, të gjitha ekonomitë luftojnë në njëfarë mënyre me ofrimin e shërbimeve në nivel lokal. Në vijim, përmirësimi i mbledhjes së të dhënave të popullsisë është i nevojshëm për të kuptuar nevojat e njerëzve dhe komuniteteve lokale dhe ofrimin e shërbimeve të synuara (OECD, 2021).¹⁹⁾

3. Universiteti “Fan S. Noli” - UNIKO dhe oferta akademike, kërkimore dhe e shërbimeve ndaj të tretëve

Edukimi cilësor është një prioritet kryesor në të gjitha ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ndërsa strukturat ekonomike ndryshojnë ndjeshëm, gjetja e burimeve të reja të rritjes së produktivitetit dhe shtytjeve të fuqishme për transformimin ekonomik të këtyre vendeve është nevojë urgjente. Mundësitë për punësim që vlerëson aftësitë dhe jep kënaqësi janë të pakta dhe të rinjtë vazhdojnë të emigrojnë, por janë mundësitë që rritja e kompetencave të të rinjve dhe fuqisë punëtore të hapë mundësi të reja. Sa

18) OECD (2020), Curriculum (re)design: A series of thematic reports from the OECD Education 2030 Project, <https://www.oecd.org/education/2030-project>

19) OECD (2021), Multi-dimensional Review of the Western Balkans: Assessing Opportunities and Constraints, OECD Development Pathways, OECD Publishing, Paris, <https://dx.doi.org/10.1787/4d5cbc2a-en>.

më i pafavorshëm të jetë raporti aktual i pagës ndaj produktivitetit të një ekonomie, aq më urgjente bëhet kjo detyrë.

Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor kanë bërë përparim të madh në edukim gjatë viteve të fundit. Zbatimi i kurrikulave të bazuara në kompetenca, pjesëmarrja në Programin për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (PISA), zhvillimi i standardeve të reja për mësuesit dhe investimet në edukimin dhe aftësimin profesional (AFP) kanë qenë disa nga reformat kryesore në rajon. Pavarësisht këtij progresi, mbetet një hapësirë e gjerë për përmirësimin e rezultateve të edukimit formal. Arsimi ndërkombëtar dhe arritjet e studentëve në programe studimi dhe universitete ndërkombëtare me origjinë nga ekonomitë e Ballkanit Perëndimor zbulojnë boshllëqe në rezultatet e të nxënit të studentëve.

Përtej edukimit formal, shumë të rriturve u mungojnë kompetencat e kërkuara në tregjet e punës. Shumë ndërmarrje në rajon raportojnë vështirësi në punësim për shkak të mungesës së aftësive dhe zbulojnë se sistemi arsimor nuk jep aftësitë e nevojshme (Banka Botërore, 2021). Përveç Serbisë dhe Malit të Zi, përqindja e individëve me aftësi digjitale bazë ose mbi atë bazë është relativisht e ulët në krahasim me ekonomitë standarde të BE-së. Përqindja e njerëzve që kanë përdorur formulat bazë aritmetike në një raport pune është shumë e vogël në disa ekonomi, gjë që tregon mungesën e aftësive kryesore kompjuterike, të cilat janë kërkesa të rëndësishme për shumë punëdhënës.

Në këtë kuadër edhe Universiteti “Fan S. Noli” është përpara një sfide të domosdoshme për t’u realizuar, që është shndërrimi me kapacitet akademike dhe infrastrukturore që i disponon dhe të tjera që do të shtohen në perspektivë, në një universitet udhëheqës të proceseve të zhvillimit ekonomik, shkencor dhe të ofrimit të shërbimeve.

Që nga nëntori 2023 në Universitetin “Fan S. Noli” mbërriti grupi i ekspertëve, të cilët përfaqësonin AADF dhe READ, dy agjenci që udhëheqin procesin e ekspertizës për reformimin e edukimit të lartë në Shqipëri në përputhje me kërkesat e Bashkimit Europian për vendet candidate në proces anëtarësimi.

Fillimisht, të konsiderosh UNIKO si një “shtyllë kryesore” për zhvillimin rajonal të Korçës, do të thotë ta shikosh rajonin e Korçës si një “sistem” në të cilin elementet përbërëse territoriale-funksionale (shoqëria, ekonomia, dhe tregu) janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe me UNIKO-n. Në parim, universiteti kontribuon, *së pari*, me “smart” kapital njerëzor dhe *së dyti*, me veprimtari kërkimore-shkencore që janë

relevante për rajonin, të specializuara dhe me cilësi të lartë, në përputhje me prioritetet e BE-së dhe Shqipërisë për zhvillimin e specializuar (E3 SMART SPECIALIZATION), që përbëjnë tri fusha për rajonin e Korçës: a) specializimi në bujqësi, b) zhvillimi i sipërmarrjeve të turizmit, dhe c) inovacioni teknologjik (digjitalizimi). Në këtë kontekst, planifikimi strategjik i UNIKO-s për vitin 2024-2030 përbën një proces kompleks dhe kritik, i cili në thelb duhet t'u japë përgjigje të drejtpërdrejtë disa pyetjeve kyçe:


1) Në çfarë pozicioni është në të vërtetë sot UNIKO?

2) Si do të jetë vazhdimësia e universitetit?

3) Çfarë duhet bërë për të fuqizuar universitetin, në mënyrë që ekspertiza e tij të garantojë mundësi për zhvillimin dhe rritjen e rajonit?²⁰⁾

Universiteti i Korçës, pavarësisht problemeve që ka pasur ndër vite, më shumë të qeverisjes, të cilat nuk kanë shërbyer për ta kthyer këtë potencial kapitali kulturor kaq thelbësor për zhvillimin rajonal në udhëheqës të zhvillimit të qëndrueshëm, i ka mundësitë dhe kapacitetet për të ndryshuar rrënjësisht gjendjen.

Figura 3. Analiza SWOT për Universitetin e Korçës²¹⁾



20) Draft-Raport vlerësimi mbi përmirësimin dhe transformimin e Universitetit të Korçës (UNIKO)-AADF & READ, 2024 (<https://www.aadf.org>)

21) Po aty.

Të katër njësitë kryesore, në përbërje të UNIKO, Fakulteti i Bujqësisë, Edukimit, Ekonomisë dhe Shkencave Natyrore dhe Humane kanë burime njerëzore dhe kapacitete për t'u transformuar, duke u kthyer në njësi që udhëheqin ndryshimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe në harmoni me mjedisin. Mendojmë se Universiteti i Korçës mund të funksionojë si një pol universitar, që mund të plotësojë kërkesat dhe nevojat e Shqipërisë Juglindore, por edhe të rajonit më gjerë, me burime njerëzore të kualifikuara, me ekspertizë shkencore të nivelit të lartë dhe të lidhur ngushtë me nevojat dhe perspektivat e rajonit, si dhe me shërbime aq të nevojshme, funksionale dhe të një spektri të gjerë, të cilat mund të kontribuojnë që mundësitë për të jetuar, punuar dhe mbajtur tërheqës rajonin e Korçës në perspektivë të sigurojnë vazhdimësinë e ekzistencës së tij.

Përfundime

Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit Shqipëria ka bërë përpjekje për të forcuar kompetencat në edukim. Rezultatet e të nxënës, të matura nga Programi i OECD-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (PISA), janë përmirësuar me shpejtësi. Miratimi kohët e fundit i kurrikulave të bazuara në kompetenca dhe standardeve të përgatitjes së mësuesve janë një bazë e rëndësishme për të përmirësuar rezultatet e të nxënës.

Për të rritur më tej kompetencat e brendshme të nevojshme për transformimin ekonomik të Shqipërisë dhe pjesëmarrjen qytetare shfaqen këto prioritet kryesorë të politikave në mjedisin e arsimit formal dhe më gjerë; Rritja e aftësive digjitale të studentëve duhet të jetë një prioritet kryesor, duke pasur parasysh lulëzimin e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në Shqipëri. Meqenëse dy ministri të ndryshme mbajnë përgjegjësi për kompetencat në edukim, ekziston fushëveprimi për të përmirësuar qeverisjen përmes koordinimit efektiv dhe koherencës së politikave.

Shqipëria duhet gjithashtu të përmirësojë cilësinë dhe aftësitë tërheqëse të edukimit dhe trajnimit profesional (AFP), një burim kryesor ky për të ofruar fuqi punëtore të gatshme për punë. Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të edukimit dhe trajnimit profesional dhe sektorit privat do të ishte veçanërisht e rëndësishme. Duke pasur parasysh ritmin e shpejtë të progresit teknologjik dhe ndryshimin e nevojave të biznesit, krijimi i mundësive më të mira për mësimin e vazhdueshëm të të rriturve dhe

ritrajnimi i tyre janë gjithashtu jetikë për rritjen e kompetencave të fuqisë punëtore aktive aktuale.

Mendojmë se Universiteti i Korçës mund të funksionojë si një pol universitar, që mund të plotësojë kërkesat dhe nevojat e Shqipërisë Juglindore, por edhe të rajonit më gjerë, me burime njerëzore të kualifikuara, me ekspertizë shkencore të nivelit të lartë dhe të lidhur ngushtë me kërkesat dhe perspektivën e rajonit, si dhe me shërbime aq të nevojshme, funksionale dhe të një spektri të gjerë, të cilat mund të kontribuojnë që mundësitë për të jetuar, punuar dhe mbajtur tërheqës rajonin e Korçës në të ardhmen të sigurojnë vazhdimësinë e ekzistencës së tij.

Burime dhe literaturë

1. Banka Botërore 2020, <https://www.worldbank.org>
2. Draft-Raport vlerësimi mbi përmirësimin dhe transformimin e Universitetit të Korçës (UNIKO)-AADF & READ, 2024.
3. ETF (2018), *Digital Skills and Online Learning in Albania*. Digital Factsheet December 2018.
4. Forumi Ekonomik Botëror, <https://www.weforum.org>
5. Nikaj, I. & Titili, D. Cultural and socio-economic sources of the gender pay gap in Albania, *Demographic Journal*, Nr.1/ 2023
6. Nikaj, I. The Sociological study of concept of generations. *Demographic Journal*, Nr.2/2021.
7. OECD (2022), "Overview: Making the Western Balkans an attractive place to live, work and invest in", in *Multi-dimensional Review of the Western Balkans: From Analysis to Action*, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/8debad2-en>
8. PISA 2022, OECD 2023, www.oecd.org
9. Revista "Studime Demografike", Nr. 2, 2023, <https://www.revistademografia.al>

PROMOVIME

Një jetë me statistikat

Pak ditë më parë, më 29 maj 2024 dr. Pasko S. Vako mbushi plot 90 vjet. Ai u lind më 29 maj 1934 në fshatin Potkozhan, që bën pjesë në Bashkinë e Pogradecit.

Shkollën fillore dhe shtatëvjeçare i kreu në vendlindje me rezultate shumë të mira në vitin 1950. Në këtë vit i del e drejta e studimit dhe ndjek teknikumin tregtar “Nako Spiru” në Tiranë, të cilin e përfundoi me sukses në vitin 1954.

Në vitin 1954 i miratohet e drejta e studimeve të larta për statistikë në Universitetin e Sofjes - kryeqytet i Bullgarisë, të cilat i përfundoi më 1959 me rezultate shumë të mira.



Dr. PASKO S. VAKO

Në fillim dhe për gati 10 vjet punoi në Drejtorinë e Statistikës pranë Komisionit të Planit të Shtetit, ku fitoi një përvojë shumë të vlefshme për detyra të tjera të mëvonshme.

Për mbi 25 vite ka qenë pedagog i statistikës në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, ku ka dhënë leksione të statistikës ekonomike, statistikës së industrisë, teori statistike dhe statistikë demografike

Krahas Fakultetit Ekonomik të UT-së, ai ka dhënë leksione për statistikën para dhe pas vitit 1990 edhe në Universitetin e Mjekësisë, si dhe në kolegjin universitar “LOGOS”, e po ashtu edhe në filialet e rretheve.

Dr. Pasko Vako është autor i 2 monografive mbi zgjatjen mesatare të jetës në Republikën e Shqipërisë dhe faktorët që kushtëzuan rritjen e saj, mënyrat e llogaritjes, prirjet dhe problemet.

Dr. Pasko Vako është gjithashtu bashkautor i 8 teksteve mësimore teorike dhe ushtrimore të botuara në vitet 1976-1986.

Në vitet 1960-1989, dr. Pasko Vako ka qenë pjesë e grupit të punës për përgatitjen e dokumentacionit udhëzues në procesin e regjistrimit të popullsisë dhe relator i procesit të regjistrimit të popullsisë në zona të ndryshme të vendit.

Ka marrë pjesë në realizimin e studimit për llogaritjen e minimumit jetik në Shqipëri në vitin 1999 për llogari të Këshillit të Sindikatave të Shqipërisë.

Ka shkruar dhjetëra artikuj dhe studime për ekonominë dhe demografinë në revistat *Ekonomia Popullore*, *Demografia* dhe *Studime Demografike*.

Me përkushtim të pashembullt, pas një pune disavjeçare, në vitin 2023, dr. Pasko Vako, në bashkëpunim me Parashqevi Avdulajn, përgatitën dhe botuan monografinë “Statistika ekonomike dhe sociale (SES)” parathënien e së cilës po e botojmë në vijim.

Dr. Pasko Vako është anëtar i kolegjiut të revistës “Studime Demografike”.

Në këtë përvjetor të rrallë, redaksia e revistës “Studime Demografike” i uron dr. Pasko Vakos shëndet të plotë dhe krijimtari të pandërprerë!

Redaksia e revistës “Studime Demografike”

STATISTIKA EKONOMIKE DHE SOCIALE (SES)

*Dr. Pasko VAKO
Parashqevi AVDULAJ (VAKO)¹⁾*

Me zhvillimin e marrëdhënieve të tregut, në mënyrë objektive rritet edhe roli i statistikës ekonomike dhe sociale (SES) si instrument diagnostikues e veprues i analizës së fenomeneve dhe proceseve ekonomiko-sociale dhe si faktor i rëndësishëm i përsosjes operative efektive. Në këto marrëdhënie ajo është një prej orientuesve më të rëndësishëm për përcaktimin e politikës ekonomike.

SES është shkenca e burimit dhe sigurimit të të gjithë informacionit sasior dhe cilësor mbi nivelin dhe mundësitë e zhvillimit të vendit si nga ana ekonomike e demografike, ashtu edhe nga ana sociale. Ajo është edhe një instrument diagnostikimi i veprimtarisë funksionale, i nevojshëm për njohjen e gjendjes, për hartimin e politikave ekonomike dhe marrjen e vendimeve e masave adekuate politike të drejtimit dhe menaxhimit të vendit.

1) Parashqevi Avdulaj (Vako) kreu studimet me rezultate të shkëlqyera në degën e Financës në Fakultetin e Ekonomisë (UT). Me eksperiencën e saj mbi 30-vjeçare në fushën e financë-bankës dhe pagesave pranë Bankës së Shqipërisë dhe Opportunity Albania, të mësimdhënies dhe administrimit pranë Kolegjit Universitar “LOGOS” ka dhënë ndihmesë të veçantë në disa pjesë të librit.

Ajo është pasqyra ku pasqyrohet organizmi i gjallë ekonomiko-social, ndonjëherë i tëri, ndonjëherë pjesët e tij përbërëse. SES është një dritare e re për të njohur më mirë vendin e botën dhe zbatimi praktik i saj bën të njihet më mirë edhe rajoni e sektori, ndërmarrja e biznesi. Veç njohjes, ajo shërben sidomos si orientues dhe është mjeti i vetëm për orientim dhe për të analizuar praktikisht ekonominë dhe shoqërinë.

SES ka si qëllim zbulimin e ligjësive statistikore të gjendjes e të zhvillimit të njësive të vrojtura të bashkësive të ndërlikuara si dhe ligjësitë e ndikimit të faktorëve në ndryshimin e vetive të bashkësive në studim në kohë e në hapësirë. Ajo synon gjithashtu edhe zhvillimin e mendimit statistikor ekonomik duke aplikuar parime, rregulla, metoda, metodologji e mjete të reja e tregues të matjes dhe analizës sasiore të fenomeneve ekonomiko-shoqërore. E madhe është ndihma e saj për njohjen dhe futjen e standardeve botërore, për zgjerimin e gamës së treguesve statistikorë dhe për përsosjen e metodologjisë së llogaritjes së tyre, për shtimin e informacionit statistikor dhe kënaqjen e nevojave me të, për kontrollin e realizimit të programeve dhe të detyrave në treguesit kryesorë të ndërmarrjes, degës dhe për gjithë ekonominë e vendit.

Për nevojat e politikës ekonomike të stabilizimit, SES llogarit vazhdimisht indikatorë të "Katërkëndëshit magjik", që janë rritja ekonomike, niveli i punësimit, stabilizimi i çmimeve të konsumit dhe përfrimi i eksportit me importin në tregtinë e jashtme. Po kështu vepron edhe për llogaritjen në vazhdimësi të treguesve përkatës, që u nevojiten llojeve të tjera të politikave ekonomike. Ajo, pra, është jo vetëm e domosdoshme dhe bashkëkohore, por edhe shumë e dobishme. Në themelin e saj qëndron shkrirja organike e praktikës më të mirë me trajtimin aktual shkencor dhe standardet bashkëkohore ndërkombëtare dhe fund e krye përshkohet nga ideja e lidhjes sa më të ngushtë të teorisë me praktikën statistikore. Me anë të sistemit të llogarive kombëtare ajo ka bërë të mundur lidhjen më të mirë midis statistikës dhe kontabilitetit, si dhe lidhjen e problemeve ekonomike me ato financiare e bankare, të atyre ekonomike me ato sociale e demografike.

Metodologjia ndërkombëtare, bazuar në SLLK, e aplikuar në praktikën tonë, sjell ndryshime të rëndësishme në përmbajtjen e nocioneve dhe kategorive, të klasifikimeve dhe grupimeve që përdoren më përpara, ajo kërkon futjen e metodave dhe treguesve të rinj, të cilët ky tekst i trajton. Ndryshimet e bëra në praktikën statistikore kërkojnë dhe lejojnë të formohet praktikisht një statistikë e re, që t'u përgjigjet kushteve të ekonomisë së

tregut dhe të jetë në përputhje me parimet themelore të statistikës zyrtare të miratuara nga Komisioni i Statistikës i OKB-së dhe Eurostatit.

Duke trajtuar nocione dhe përkufizime të qarta bashkëkohore, me anën e treguesve statistikorë është paraqitur shumë më mirë edhe ndërlidhja reciproke e thelbit të fenomeneve e proceseve (ana cilësore) me përcaktimin numerik të tyre (ana sasiore), çka i shërben shumë mirë edhe analizës së tyre. Statistika ekonomike dhe sociale është gjuha universale e informacionit, që lejon komunikimin ndërmjet ekonomistëve të të gjitha vendeve dhe të të gjitha drejtimeve, të veprimtarëve shtetërorë, të politikanëve, studiuesve, juristëve, sociologëve, financierëve, ekonomistëve, statistikienëve, biznesmenëve, menaxherëve të ndërmarrjeve dhe të firmave, investorëve, gazetarëve etj. Me ndihmën e kësaj gjuhe në teorinë ekonomike përpunohen “metodat organizative dhe sistematike të argumentimit”.

Në anën tjetër të saj, SES është grumbullim hipotezash konsistente që numërojnë vetitë esenciale të ligjësisë të realitetit të ndërlikuar. Ajo jep nocionet kryesore që studiojnë ligjësitë sasiore të fenomeneve dhe proceseve ekonomike e shoqërore mbështetur në përcaktueshmërinë dhe përmbajtjen e tyre cilësore.

SES është një kompleks dijesh sistematike e metodash statistikore mbi fenomenet dhe proceset ekonomike e shoqërore që ekzistojnë realisht. Ajo na njeh me nocionet, rregullat, metodologjinë aktuale dhe standardet ndërkombëtare si dhe me treguesit bashkëkohorë të statistikës, duke krijuar hapësirën e informacionit adekuat për përgatitjen e ekonomistëve analizues, të aftë që të përcaktojnë drejtimet prioritare të zhvillimit ekonomik e social në kushtet e ekonomisë së tregut.

Meritë e SES është fakti që në strukturën e saj përmbahen nocionet, metodat, treguesit dhe metodologjia bashkëkohore e llogaritjes së tyre, të cilët përdoren si nga statistika makroekonomike dhe nga ajo mikroekonomike, d.m.th si në nivel vendi e dege, ashtu dhe për ndërmarrjen.

Drejtimi analitik është karakteristik e SES dhe përfshin metoda të ndryshme statistikore, si atë të indekseve në analizën faktoriale të madhësive mesatare, atë të analizës së korrelacionit e regresionit, atë për vlerësimin e lidhjeve të ndërsjella, llogaritje të sakta të treguesve statistikorë etj. Pra, SES është syri (sepse vrojton gjithçka) dhe truri (i specialistit që analizon) i shoqërisë.

Ajo përdor *Sistemin e Llogarive Kombëtare dhe Metodën e Vlerësimeve të Argumentuara* (MVA), që është një metodë specifike e prioritare për SES, e cila ka si qëllim përfitimin e treguesve përgjithësues

makro-ekonomikë. Po ashtu, ajo ka përpunuar mirë treguesit ekonomikë, financiarë, demografikë dhe socialë etj. në shërbim të analizës statistikore për të nxjerrë në dukje ligjshmëritë statistikore dhe ndikimin e faktorëve në funksion të një interpretimi shkencor të tyre me qëllim që t'i shërbejnë marrjes së vendimeve sa më të drejta e shkencore dhe hartimit të politikave ekonomike e sociale sa më të mira. Rëndësia e llogaritjeve makroekonomike mbi bazën e treguesve të sistemit të llogarive kombëtare dhe mungesa e literaturës dhe e specialistëve të kualifikuar krijojnë domosdoshmërinë e ngutshme të zhvillimit të kësaj disipline, e cila përbën një vlerë të re të shtuar për përgatitjen e studentëve, kryesisht të fakulteteve ekonomike dhe atyre sociale.

Botimi i SES dhe përfshirja në programet mësimore do të ndihmojë që tekstet teorike të statistikës t'i afrohen e të barazohen me praktikën statistikore të vendit tonë, e cila aktualisht është më përpara nga teoria statistikore. Qëllimi i saj është që t'u bëjë të njohur studentëve bazat e analizës sasiore të fenomeneve e proceseve ekonomike e sociale, që janë karakteristike të sistemit ekonomik e social dhe t'u mësojë të interpretojnë drejt ndryshimet e ligjshmërive që ndodhin në ekonomi dhe në jetën sociale. Si rezultat i përvetësimit të tekstit, studentët do të njohin sistemin e treguesve statistikorë, do të mundën të analizojnë të dhënat, të nxjerrin konkluzionet përkatëse dhe të bëjnë propozimet e duhura. Ndërsa në botë ajo zhvillohet në disa qindra universitete, te ne mungon prej mbi 30 vite.

Mungesa e saj për një kohë kaq të gjatë ka krijuar një boshllëk në mirëpërgatitjen e studentëve tanë. Duke mbushur këtë boshllëk, botimi i saj është risi që i jep njëkohësisht edhe një vlerë të re të shtuar fondit të literaturës ekonomike.

Sot qëndron tepër i mprehtë problemi i rritjes së dijeve të ekonomistëve. Kalimi në ekonominë e tregut dhe zhvillimi i mëtejshëm i SES varen shumë nga cilësia e përgatitjes së teksteve të statistikës dhe të vetë ekonomistëve. Dihet se të gjitha fenomenet e proceset janë të ndërlydhura reciprokisht, prandaj ato duhet të shihen si nga ana ekonomike, ashtu dhe nga ana sociale, problem ky që realizohet me këtë tekst. SES është e prekshme dhe e kuptueshme për të gjithë përdoruesit e saj.

Në tekst paraqiten çështjet e përmbajtjes së SES në kushtet e ekonomisë së tregut, ekspozohet rëndësia e sistemit të llogarive kombëtare (SLLK) në studimin statistikor të proceseve ekonomiko-sociale; jepet përmbajtja e SLLK, nocionet kryesore e përkufizimet, klasifikimet dhe rregullat e evidentimit e të aplikimit të SLLK; parimet e përgjithshme të

ndërtimit të tij; llogaritë kryesore; metodat e llogaritjes së PBB si treguesi kryesor i SLLK; treguesi i rritjes ekonomike; jepen tabelat e burim-përdorimeve; statistikat e popullsisë dhe të tregut të punës; statistikat e pasurisë kombëtare dhe bilanci i aktiveve dhe pasiveve; ajo e shkencës dhe inovacionit; e sipërmarrjes, e ndërmarrjeve dhe e investimeve; e të ardhurave, shpenzimeve, e konsumit dhe mbrojtjes sociale të popullsisë, ku theksohen për herë të parë shtatë ligjshmëritë e konsumit të buxhetit të familjeve, metodat e matjes së pabarazisë në të ardhurat dhe treguesit e varfërisë; statistikat e degëve të sferës sociale dhe e kushteve të jetesës së popullsisë; statistikat juridike; e çmimeve e tarifave dhe inflacionit; e financave dhe ato bankare; e lidhjeve të jashtme ekonomike, statistikat doganore, e rregullimit të valutës dhe e kontrollit të saj, e bilancit të pagesave; e treguesve të efektivitetit ekonomik të faktorëve të prodhimit; e modelimit dhe e prognozimit ekonomiko-social të fenomeneve, ku përdoren bashkërisht metodat e statistikës dhe ato të statistikës matematike për qëllimet e një analize më të thellë, ku me aplikimin e këtyre metodave një vëmendje e veçantë i kushtohet prognozimit të proceseve ekonomiko-sociale.

Teksti që botohet për herë të parë pas 32 vitesh përmban material statistikor të paktën sa të 4 teksteve (statistikë ekonomike, statistikë sociale, financiare-bankare, statistikë e popullsisë etj. Zhvillimi i SES në universitete shton edhe numrin e personelit akademik të profilizuar përkatësisht.

Në tekst jemi përpjekur që secili përdorues i tij të ketë mundësinë e marrjes së sqarimeve të plota mbi përmbajtjen dhe mundësitë analitike të treguesve statistikorë, të metodologjisë së llogaritjes së tyre, të metodave të interpretimit e sidomos në drejtimet e analizës statistikore etj. Lidhja e treguesve të analizës së prodhimit, të fuqisë punëtore, të gjendjes financiare me treguesit e efektivitetit ekonomik në ndërmarrje, degë dhe në tërë vendin e paraqet plotësisht gjendjen dhe ndihmon marrjen e vendimeve të drejta e shkencore.

SES trajton shumë pjesë, kapituj, çështje e tregues të rinj. Kështu, mbi 10 kapituj janë krejt të rinj, si: sistemi i llogarive kombëtare; nocionet kryesore ekonomike, përcaktimet, klasifikimet, njësitë dhe sektorët institucionalë; statistika e shkencës dhe inovacionit; ajo e shoqërisë së informacionit, statistika e nivelit të jetesës së popullsisë; statistika politike; ajo e turizmit; statistika juridike; statistika e çmimeve, tarifave dhe e inflacionit; ajo e financave të ndërmarrjeve; ajo e bilancit të pagesave dhe

e rregullimit e kontrollit të valutës; efektiviteti ekonomik nga përdorimi i faktorëve të prodhimit etj. SES jep gjithashtu metoda të reja të statistikës, si: metodën e vlerësimeve të argumentuara, atë të burime-përdorimeve, atë të klasifikimeve, metodën e treguesve përgjithësues etj., të cilat ndihmojnë dhe lejojnë shfaqjen e lidhjeve të ndërsjella, përmasat e fenomeneve e proceseve dhe përcaktojnë ligjshmëritë statistikore të zhvillimit të tyre.

Janë shumë nënkapituj e paragrafë të rinj me treguesit përkatës. Ka disa dhjetëra tregues të rinj, jo vetëm në kapitujt e rinj, por edhe në çështjet që janë trajtuar edhe para 1990. Në veçanti theksojmë treguesit e rinj të efektivitetit ekonomik nga përdorimi i faktorëve të prodhimit; të rentabilitetit në financat e ndërmarrjeve, të vrojtitit të besimit të biznesit dhe të konsumatorëve; treguesit e bilancit të pagesave; treguesit e statistikës juridike; të shkencës dhe inovacionit; të statistikës politike; të statistikës së turizmit e shumë të tjerë, ashtu si në ndërmarrje dhe në çdo veprimtari përfshihet numri maksimal i treguesve të njohur.

Në veçanti në këndvështrimin e statistikës trajtohen të gjitha çështjet kryesore të statistikës financiare e bankare, si ato të buxhetit të shtetit, të tatimeve e taksave, të rezultateve financiare në subjektet e ndryshme, të qarkullimit monetar dhe të kreditit, të depozitave, të sigurimit të pasurisë dhe të jetës etj., duke e plotësuar kuadrin e çështjeve dhe të problemeve të statistikës financiare e bankare në përputhje të plotë me kushtet e ekonomisë së tregut.

Thënë shkurt, SES na mundëson njohjen e zbatimit të metodave dhe të treguesve statistikorë bashkëkohorë në të gjitha fushat kryesore të veprimtarisë njerëzore, në sipërmarrje, degë, rajon dhe nivel qendror.

Theksojmë se për përgatitjen e tekstit të SES u mbledhën dhe u shfrytëzuan shumë burime të statistikës bashkëkohore, të huaja dhe vendëse, enciklopedi e termave të statistikës me 8 volem e saj, fjalorë të statistikës, manuale dhe dokumente statistikore metodologjike të botuara nga OKB, EUROSTAT, BB, FMN, PNUD, ILO, UNESCO, OBSH, OBT etj., metodologji e udhëzime bashkëkohore për shumë tregues statistikorë nga vende anëtare të BE-së, të EUROSTAT-it, vjetarë statistikorë të INSTAT-it, buletine e studime të ndryshme ekonomike e sociale etj.

Rëndësia e ndihma që jep, çështjet që trajton dhe përmbajtja e tyre si dhe literatura e gjerë shkencore bashkëkohore e shfrytëzuar për përgatitjen e SES, e bëjnë atë një tekst statistike bashkëkohor dhe të kompletuar. Për grumbullimin dhe mbledhjen e literaturës së mësipërme, që arrin në disa mijëra faqe, për përkthimet e materialeve nga gjuhë të ndryshme, për

përzgjedhjen e përshtatjen e çështjeve që nevojiteshin si dhe për shkrimin, si dorë e parë, dhe rishikimet e duhura disa herë, na është nevojitur një kohë shumë e gjatë, disavjeçare.

Teksti u drejtohet studentëve të fakulteteve ekonomike e sociale të universiteteve dhe IAL-ve publike e private, në qendër dhe në rrethe, që studiojnë statistikë dhe informatikë, ekonomiks, menaxhim, financë, kontabilitet, bankë, marketing-turizëm, biznes, agrobiznes, shkenca sociale, gazetari, logjistikë etj. Atë mund ta përdorin gjatë punës së tyre edhe punonjësit e aparatit shtetëror, sidomos ata të statistikës në ministri, qarqe, bashki e njësi administrative, punonjësit e ndërmarrjeve dhe të bizneseve, studiuesit, punonjësit shkencorë, punonjësit e medias së shkruar televizive e elektronike etj. Ai u mëson përdoruesve si bëhet analiza statistikore e fenomeneve ekonomike-sociale, si të interpretojnë drejt ligjësitë statistikore, të njohin sistemin e treguesve që duhen dhe të zgjerojnë njohuritë mbi statistikën. Për arsye të vëllimit të madh që do të zinte dhe të çështjeve të shumta që trajton, SES-it i mungojnë mjaft ushtrime, që do ta bënin më të plotë atë. Për këtë jemi të ndërgjegjshëm. Por këtë boshllëk, edhe sipas traditës sonë, duhet ta plotësojë një tekst tjetër i posaçëm vetëm me ushtrime.

Falënderojmë prof. dr. Fatmir Memën, zëvendësdekan dhe shef katedre në Fakultetin e Ekonomisë të UT dhe drejtorin e statistikave ekonomike në INSTAT, z. Elton Aliko (kapitujt II-IX), për recensionet tyre, që përmes vërejtjeve, sugjerimeve dhe vlerësimeve të tyre, të cilat u reflektuan të gjitha, na ndihmuan për ta përmirësuar më tej tekstin.

Vërejtjet e studiuesve dhe sidomos ato të specialistëve dhe të studentëve i mirëpresim për ta përmirësuar më tej tekstin në të ardhmen.

Pasko Vako
Parashqevi Avdulaj

STATISTIKA EKONOMIKE DHE SOCIALE

SES është syri dhe truri i shoqërisë. Ajo është
gjuha universale e informacionit



PASKO VAKO mbaroi studimet e larta shumë mirë për ekonomi-statistikë në Sofie në vitin 1959. Punoi rreth 10 vjet në Drejtorinë e Statistikës. Mbi 25 vite ka qënë pedagog i statistikës në Fakultetin Ekonomik të (UT), ku ka dhënë leksione të statistikës ekonomike, statistikës së industrisë, teori statistike dhe statistikë demografike, si në Fakultetin Ekonomik edhe në disa fakultete të tjera, në filialet e rretheve, në Universitetin e Mjekësisë dhe "LOGOS". Është bashkëautor i tetë teksteve mësimore si dhe i dy monografive. Në shtypin e përditshëm dhe revistat Ekonomia Popullore dhe Demografia ka shkruar disa dhjetëra artikuj dhe studime për ekonominë dhe demografinë. Në nëntor 2023 bashkë me vajzën botojnë tekstin e munguar gjatë me titull "Statistika Ekonomike dhe Sociale" (SES).

PARASHQEVI AVDULAJ (VAKO), mbaroi studimet me rezultate të shkëlqyera në degën e Financës në Fakultetin e Ekonomisë (UT). Me një eksperiencë të gjerë mbi 30 vjeçare në fushën e financë-bankës dhe pagesave pranë Bankës së Shqipërisë dhe Opportunity Albania; në atë të mësimdhënies, menaxhimit e administrimit pranë Kolegjit Universitar "LOGOS", kontriboi në realizimin e disa pjesëve të librit.

Në tekstin që botohet trajtohen çështjet e përmbytjes së Statistikës Ekonomike dhe Sociale (SES) në kushtet e ekonomisë së tregut: sistemi i llogarive kombëtare; nocionet përcaktimet dhe klasifikimet; treguesit më të rëndësishëm të sistemit të llogarive kombëtare; tabelat e burimeve dhe të përdorimeve; statistika e popullsisë dhe e tregut të punës; ajo e pasurisë kombëtare dhe e bilancit të aktiveve e pasiveve; e shkencës dhe inovacionit; e sipërmarrjes, investimeve dhe e ndërmarrjeve; e nivelit të jetesës, të ardhurave, shpenzimeve, konsumit dhe mbrojtjes sociale të popullsisë; statistika e degëve të sferës sociale; statistika juridike dhe ajo politike; e çmimeve, tarifave dhe inflacionit; statistika financiare, e buxhetit të shtetit, e tatimeve e taksave; statistika bankare, ajo e rezultateve financiare; e sigurimit të pronës dhe jetës, e qarkullimit monetar; e letrave me vlerë; e kurseve të valutës; e veprimtarisë ekonomike të jashtme, e tregëtisë së jashtme dhe e doganave; e rregullimit e kontrollit të valutës dhe e bilancit të pagesave; statistika e treguesve të efektivitetit të veprimtarive ekonomike; prognozi dhe modelimi statistikor i fenomeneve ekonomike dhe sociale.

Libri që mungon prej 33 vitesh, u hartua mbështetur në standardet ndërkombëtare bashkëkohore, me synimin kryesor të formimit të ekonomistëve e specialistëve analistë të problemeve ekonomike e sociale.

Teksti destinohet për studentët e IAL-ve publike e private që studiojnë për ekonomi, financë, bankë, informatikë, shkencat sociale, biznes, agrobiznes, agroturizëm, gazetarit etj. Ai u shërben ekonomistëve në detyrë në gjithë institucionet shtetërore e në kompanitë private si dhe punonjësve që përgatisin temat e dizertacioneve, doktoraturave, punonjësve shkencorë, gazetarëve, biznesmenëve, investitorëve etj.

PËRVOJA JETËSORE

Luan SHAHOLLARI

Vitet e para të daljes në jetë

Gusht 1973 - emërimi në rrethin e Kukësit¹⁾

Dalja në jetë pas përfundimit të një cikli të shkollor, apo pas arritjes së një moshe të caktuar shënon një ngjarje të rëndësishme në jetën çdo njeriu. Për këtë arsye ajo le mbresa të pshlyeshme që mbeten gjallë e kujtohen me emocione të veçanta. Këtu, në vijim po hedh disa mbresa nga fillimet e daljes time në jetën e punës, por më parë, po e nis me pak të dhëna jetësore.

Datëlindja ime është 1 mars 1952 dhe vendlindja Lumalasi, një fshat i vogël rreth pesë km pa hyrë në qytetin e Korçës, rrëzë një kodre, pranë rrugës automobilistike kombëtare që e lidh atë me Tiranën. Sipas regjistrimit të parë të popullsisë në Shqipëri, më 1923 fshati kishte vetëm 14 shtëpi dhe 98 banorë. Sigurisht, një shtëpi ka pasur dy e më shumë kurorë, apo familje. Deri në fund të vitit 1990 ka pasur rreth 70 familje me 300 banorë. Gjatë këtyre viteve tranzicion janë larguar por edhe kanë ardhur më shumë familje të tjera. Të shohim se sa do të ketë nxjerrë censi i popullsisë i vitit 2023.

Si fshat me pak banorë e sigurisht me pak nxënës, deri në vitet 1970 kishte një shkollë fillore me klasa kolektive, ku jepnin mësim një mësues dhe një mësuese që vinin çdo ditë me biçikleta nga qyteti i Korçës. Fillova klasën e parë fillore në shtator 1958, gjashtë muaj para afatit të detyruar të kohës prej 7 vjeç. Ndikim në këtë “shkelje” ka pasur babai që pat biseduar

1) Ndarja administrative e Shqipërisë deri në vitin 1990 ka qenë e përbërë nga 26 rrethe. Në këto vite, në rrethin e Kukësit ka bërë pjesë edhe territori i sotëm i Bashkisë së Hasit.

me mësuesin e shkollës që të hyja si “dëgjues” pasi e “kisha qejf” shkollën. Viti kaloi dhe unë mora një dëftesë me pesat atyre viteve... Hyrja në shkollë para moshës 7 vjeç, ndjekja e sistemit 7-vjeçar dhe e gjimnazit 11-vjeçar më dhanë mundësinë t’i përfundoj studimet e larta (pa stazhin) 21 vjeç e pak muaj.

Mba vesh, Luan, po s’të kanë emëruar në Kukës!

Nga fundi i qershorit 1973, pasi kishim dhënë provimet e vitit të katërt dhe të fundit, ishim duke kryer zborin (stërvitjen ushtarake). Gjatë këtyre ditëve, shpesh, ulur apo shtrirë në lëndinat e Institutit të Lartë Bujqësor (nga viti 1991 Universiteti Bujqësor), hamendësonim se ku mund të ishim emëruar. Në një rast Lutfi Noka, një shok i kursit nga Kukësi, ia shkrep:

- Mba vesh, Luan, po s’të kanë emëruar në Kukës!

- Po ky? - Ç’dua unë në Kukës, kur ka nevojë Korça? - ia ktheva i sigurt.

- Mirë, mirë, - tha Lutfiu, - po Kukësi ka më shumë nevojë!

Lutfiu vërtet “ia fuste kot”, siç thuhet rëndom në raste të tilla, megjithatë nuk u desh më shumë se një javë që emërimi “kot” t’i dilte “plot”! Madje atë vit në Kukës u emëruam vetëm ne të dy - unë nga Korça dhe Lutfiu vendali, nga Kalisi!

Njoftimi i parë, përmes një bisede telefonike me punonjësen e zyrës së kuadrit në Ministrinë e Bujqësisë nuk m’u duk bindës, prandaj i thashë ta shikonte edhe një herë se ndoshta ishte bërë ndonjë gabim, se të dy rrethet me “K” fillonin... Por ngulmimit tim për ta riparë, duke e kuptuar gjendjen time, ajo m’u përgjigj: “Në Kukës, more djalë, në Kukës!”

Më vonë këto emërimet na erdhën edhe zyrtarisht, duke mos harruar të na porositnin për t’u paraqitur sa më shpejt në detyrë!

Nuk e prisja. Ky ishte zhgënjimi i dytë pas atij të katër vjetëve më parë; kur mbarova gjimnazin “Th. Gërmenji”, e më caktuan të studioja në një degë që nuk e kisha kërkuar. Ndodhi që në vitin e tretë na kaluan në krijimin e fakultetit të Ekonomisë Agrare. Tani mendoja se do të emërohesha së paku në vendlindjen time në Lumalas, që ishte qendra e një prej ekonomive bujqësore më të mëdha të rrethit e madje në shkallë vendi. Kisha arsye për ta menduar këtë, pasi, edhe pse e tillë, këtu ende nuk kishte një ekonomist ekonomist plani me arsim të lartë! Kështu do të kisha mundësi të ndihmoja edhe prindërit, të cilët kishin bërë sakrifica për shkollimin tim, të dy vëllezërve, e motrës pas meje.

Por ja që dosja ishte dërguar në Kukës, në drejtim të kundërt me dëshirën time. Tani do të ishin organet partiake dhe të pushtetit në rreth ato që do të vendosnin për emërimin në ndonjë ndërmarrje, kooperativë apo institucion ku kishte nevojë për ekonomist plani.

Mbërritja në Kukës


Nga Korça mbërrita në Tiranë një ditë para nisjes për në Kukës. Ditën tjetër, më 27 korrik 1973, u nisëm me një autobus të zakonshëm të linjës interurbane. Udhëtoja për herë të parë në Kukës. Autobusi ishte plot me studentë e studente që do të merrnin emërimet atje.

Rruga m'u duk e gjatë dhe e lodhshme, siç ishte në të vërtetë, ndonëse ndalua për kafe në Rubik, për drekë në Fushë-Arrëz dhe për t'u freskuar në Ujin e Ftohtë. Pjesa e rrugës nga Qafa e Malit në Kukës ende nuk ishte asfaltuar dhe në autobusin me dritare hapur hynte një ajër i nxehtë i përzier me re pluhuri që i linin gomat pas.

Në Kukësin e vjetër mbërritëm në mbrëmje. Kukësi i vjetër kishte dy hotele: Njëri quhej "Gjalica" dhe vlerësohej si më i miri. Ai ndodhej në hyrje të qytetit, sapo dilje nga ura e Drinit të Zi, në krah të djathtë. Në katin e parë ishte restoranti, që mbahej edhe ky si më i miri. Hoteli tjetër ishte "Përparimi", rreth njëqind hapa më afër qendrës. Ngjitur me të ishte edhe kinemaja, kurse përballë Komiteti Ekzekutiv, gjimnazi, pallati i kulturës, biblioteka e ndonjë objekt tjetër që nuk ishte transferuar ende në Kukësin e ri. Zbritëm nga autobusi dhe u drejtua në hotel Gjalica. U krijua njëfarë rrëmuje në fillim, pasi nuk kishim lajmëruar më parë, por Rizai (apo Xakja, siç e thërrisnin shkurt) na "sistemoi" të gjithëve.

Kukësi – një kantier i madh ndërtimi

Një pjesë e rrethit të Kukësit në mesin e viteve 1970 ngjante me një kantier të madh ndërtimi, pasi, krahas me ngritjen e qytetit të ri, po punohej edhe për pastrimin e kupës së liqenit që do të krijohej nga ngritja e digës së hidrocentralit të Fierzës. Liqeni zinte një sipërfaqe prej 1288 ha, që shtrihej në brigjet e Drinit të Zi e të Bardhë, e takoheshin pikërisht në qytetin e vjetër. Me aksion po punohej në ndërtimin e qytetit të ri, në qytezat e Gostilit, Fushë-Dukagjinit, Kalimashit, Fajzave si dhe të 29 fshatrave që po ndërtoheshin tërësisht apo pjesërisht të reja.



Hyrja nga ura mbi Drinin e Zi në Kukësin e Vjetër, para se të përmbyshej nga liqeni i Fierzës. Hotel "Gjalica" ndodhet në ndërtesën e parë dykatëshe në krahun e djathtë të fotos.

Qyteti i ri dhe i vjetër në këtë kohë lidheshin midis tyre me një rrugë të përkohshme të asfaltuar prej rreth katër km. Qyteti i vjetër ishte më i kufizuar në hapësirë, më i vogël në numër banorësh, por më i mbledhur dhe më i organizuar brenda territorit të tij. Por tani ishte në tkurrje të vazhdueshme.

Kurse qyteti i ri shtrihej në një sipërfaqe më të gjerë, të hapur nga shpyllëzimet, mbi bazën e një planimetrie e cila nuk parashikonte ngritjen e shtëpive private. Por qyteti i ri ishte ngritur në një vend të ekspozuar ndaj erërave të forta dhe të ftohta në dimër.

Të dy pjesët e qytetit të Kukësit në këtë kohë kishin rreth 8 500 banorë.

Themelet e pallatit të parë të qytetit të ri ishin hedhur qysh më 1962 dhe deri në vitin 1973 ishin ngritur ndërtesat e disa institucioneve kryesore të qeverisjes qendrore e lokale si: ajo e Radio Kukësit, spitalit, Komitetit të Partisë, degës së Punëve të Brendshme etj. Ndërkohë vazhdonin punimet për ndërtimin e Komitetit Ekzekutiv, të Bankës së Shtetit, pallatit

të kulturës, shkollës së mesme të përgjithshme dhe disa objekte social-kulturore. Përballë komitetit të partisë dhe komitetit ekzekutiv po ngrihej hoteli i ri që do të mbante përsëri emrin e malit të Gjalicës.



Kukësi i ri në vitet e para të ndërtimit

Emërimi zyrtar: kryetar i degës së planit në kooperativën bujqësore Klos të Fanit!

E pata lënë çështjen e emërimit brenda rrethit të Kukësit në “rrjedhje të lirë”, siç kisha bërë edhe për të drejtën e studimit pas përfundimit të gjimnazit në Korçë dhe të caktimit nga Ministria e Bujqësisë! Për shkak se nuk kishin dalë ende emërimet, në ditët e para të gushtit ne bënim xhiro në qytetin e vjetër nga hotel “Gjalica” te “Përparimi” duke ndalur për të pyetur te Komiteti Ekzekutiv. Në një nga këto ditë na thirrën në seksionin e bujqësisë për të na njohur me vendimet e emërimit. Mendoja që do të më kishin caktuar “aty afër”, pasi ishim të parët që kishim marrë një diplomë të veçantë për planifikimin dhe organizimin e ekonomive bujqësore. Por në seksionin e bujqësisë inspektori A. Hallaçi më komunikoi se isha emëruar kryetar i degës së planit në kooperativën bujqësore me qendër në Klos të Fanit!

Nuk e dija ku binte kjo kooperativë, por pasi dola, pyeta dhe u interesova, e kuptova se isha caktuar në një nga skajet e rrethit të Kukësit, në kufi me rrethin e Mirditës, ose më mirë të themi në Mirditën e sotme! Organeve të partisë dhe pushtetit në rreth u ishin dukur pak dy ditë rrugë

Korçë-Tiranë-Kukës, prandaj më kishin larguar edhe një ditë tjetër, pasi Klosi ishte më afër Rrëshenit sesa Kukësit! Edhe Lutfiun e kishin caktuar larg familjes: nga Kalisi në Zapod!

Nuk ke me shku në Klos të Fanit!

Kështu m'u drejtua Azem Kërxxhaliu, zv/kryetar i Komitetit Ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit të Kukësit në një takim që u zhvillua në një nga ditët e para të gushtit me ne stazhierët, për të na dhënë porosinë e rastit para se të shpërndaheshim në ndërmarrjet dhe kooperativat ku ishim emëruar. Komiteti Ekzekutiv ishte ende në një ndërtesë dykatëshe në qytetin e vjetër, e cila para çlirimit kishte qenë prefekturë. Pranë tij në vitin 1939 ishte ngritur një monument i heroit tonë kombëtar Skënderbeut me vështrim nga Kosova, vepër e "Skulptorit të Popullit" Odhise Paskali.

Ato ditë kishim "eksploruar" zyrat e katit të parë ku ndodhej seksioni i bujqësisë dhe disa seksione të tjera ku na kishin njohur me emërimet. Tani ndodheshim në korridorin e katit të dytë, ku kishin zyrat drejtuesit kryesorë. Ky kat ishte më i mirëmbajtur, ndonëse edhe këtu dërrasat kishin filluar të kërcisnin. Dukej që në këtë ndërtesë kishte vite që nuk ishte vënë dorë dhe dihej arsyeja: në qytetin e ri po ngrihej një ndërtesë e re katërkatëshe ku u vendos Komiteti Ekzekutiv i këshillit popullor të rrethit dhe që prej vitit 1992 aty është Bashkia e Kukësit.

Duke na përshëndetur, na ftoi të hynim në zyrën e tij të madhe. Nuk më kujtohet kush, por në atë takim ishte edhe një punonjës tjetër, ndoshta nga seksioni i kuadrit, për të mbajtur shënime. Ndonëse kishte "hije të rëndë", Azemi na krijoi një atmosferë me humor, veti të cilën vendësit e dinin, por ne të tjerët tani po e mësonim. Ai filloi të na pyeste me radhë, sikur të na merrte në intervistë. Dukej se shumica ishim specialistë të rinj të bujqësisë: agronomë, ekonomistë, zooteknikë, veterinerë, por kishte edhe nga degë të tjera.

Po ndiqja pyetjet e Azemit dhe përgjigjet e studentëve stazhierë apo atyre që kishin përfunduar diplomimin. Po intervistohesha një student që ishte diplomuar për mjek veteriner.

- Po ty E ku t'kan ç'u?

Fakti që i foli me emër, tregonte se kishte njohje të mëparshme.

- Në kooperativën bujqësore të Kolshit, - iu përgjigj E.

- E ç'a ke mbaru ti?

- Mjek veteriner, shoku Azem, - iu përgjigj ai.

- Hë, - qeshi Azemi, - pse nuk thua doktor magjarësh, po mjek veteriner! Qeshën edhe disa të tjerë, edhe ne pasi “përkthym” fjalën ”magjar”.

Kaluan pa ndonjë “problem” tre-katër “të intervistuar” të tjerë. Po më vinte radha mua:

I thashë emrin dhe mbiemrin.

- Nga të kemi ty?

- Nga Korça.

- Nga Korça mrena?

- Aty afër, nga Lumalasi, - shtova unë, - rreth pesë km larg...

- Hëm. E po kështu thuaj de, se e njoh mirë Korçën unë.

Më vonë mora vesh se ai kishte punuar në vitet 1960 në Korçë me rendin dhe i njihte mirë kuadrot kryesorë të rrethit.

- Ehë, po ku të kanë caktu ty?

- Shef plani në kooperativën bujqësore të Klosit, në Fan, - iu përgjigja.

Atij i bëri përshtypje emërimi im, pasi vazhdoi:

- E kush ta tha ty këtë?

- Inspektori i seksionit të bujqësisë, A. Hallaçi, - iu përgjigja. Kishim filluar të fiksonim edhe emrat e parë, me të cilët ishim takuar ato ditë.

- Heu bre, - tha, - kush drejton kuadrot e nalta të bujqësisë! - Ai përmendi diçka për nivelin arsimor të tij... Pastaj gjithë seriozitet shtoi: - Nuk ke me shku aty!

Nuk fola, por, sidoqoftë, më erdhi mirë. Pasi u “intervistuan” edhe të tjerët, Azemi na porositi për të njohur vështirësitë e bazës, për të përfutur nga përvoja, duke dhënë ndonjë porosi sipas rastit, pasi i njihte mirë problemet dhe kuadrot e rrethit.

Ky ishte takimi i parë me një përfaqësues të pushtetit ekzekutiv në rreth. Humori, e folura në dukje e ashpër, por e sinqertë ishin karakteristika të Azemit, me të cilat do të mësohesha gjatë periudhës në Kukës, por edhe në ndonjë takim të rastit në vitet 1990 në Tiranë.

Stazhi më “transferon” nga Klosi në Kolsh!

Ne ishim studentët e parë që, sipas udhëzimit të miratuar një vit më parë, duhej të kryenim një stazh (praktikë profesionale) në një qendër pune para se të diplomoheshim. Stazhi synonte që studenti të lidhte më mirë dijet e fituara në shkollë me praktikën e punës. Kjo periudhë zgjaste një vit shkollor dhe konsiderohej si vazhdim i procesit mësimor.

Stazhi duhej të bëhej detyrimisht pranë një specialisti përkatës me arsim të lartë. Krahas stazhit merrnim edhe një emërim përfundimtar. Në

këtë detyrë do të kalonim pasi të diplomoheshim dhe pasi të kishim kryer stërvitjen ushtarake 5-6 mujore. Paga e një stazhieri ishte baras me atë të një specialisti të mesëm. Nuk kishte ndonjë shtesë për ata që caktoheshin jashtë rrethit të tyre.

Pak ditë më vonë doli se organet e rrethit nuk kishin zbatuar udhëzimin e Ministrisë së Arsimit për kushtet e emërimit të studentëve stazhierë. Nuk shkova në Klos të Fanit, pasi aty mungonte ekonomisti i lartë ku unë duhej të merrja përvojë!

Pas dy ditësh më njoftuan se më kishin caktuar stazhier në degën e planit në kooperativën bujqësore të Kolshit, e cila ishte afër qytetit të vjetër, në hyrje të tij, në krah të majtë të rrugës automobilistike për Tiranë. Qendrën kooperativa e kishte në Myç-Mamëz, në një zonë kodrinore rreth gjysmë ore larg Kukësit. Këtu, prej pesë vjetësh, në detyrën e kryetarit të degës të planit ishte Myrto Gërbeti, një ekonomist i lartë për industri nga Kozmaçi i Shkodrës. Myrtua e priti me gëzim, pasi te kjo lëvizje pa jo thjesht një stazhier që do ta ndihmonte në punë, por më tepër një shpresë që të transferohej pranë familjes. Kërkesave të tij tani nuk mund t'i përgjigjeshin se:



Dhjetor 1973: Në Kukësin e vjetër

“nuk kemi me kë të zëvendësojmë”. Mund të priste edhe një vit derisa të mbroja diplomën, të kryeja stërvitjen ushtarake (zborin) dhe të kthehesha për të marrë emërimin përfundimtar. Megjithatë, kjo nuk ishte e garantuar, pasi bëhej fjalë vetëm për stazhin, emërimin zyrtar e kisha ende në Klos të Fanit...

Përfundimi i stazhit, prill 1974

Pas përfundimit të stazhit ne duhej të pajiseshim me një karakteristikë pune të firmosur nga sekretari i partisë i kooperativës. Sekretari B. Vata shkruan se “nga data 15 gusht 1973 deri më 20 mars 1974 në kooperativën bujqësore “29 Nëntori” Kolsh, pranë degës së planit, kreu stazhin studenti i Fakultetit të Ekonomisë Agrare Luan Shahollari. Gjatë kohës së qëndrimit të tij ai punoi me ndërgjegje të lartë për mbarëvajtjen e punëve të ndryshme të kooperativës. Ka marrë pjesë aktive në zgjidhjen e shumë problemeve që kanë dalë në degën e planit si dhe ka kontribuar në problemet e tjera... Është i përgatitur nga ana profesionale. Sjellja e tij ka qenë shembullore. Ne mendojmë se nga Fakulteti juaj ka dalë një kuadër i cili, pasi kreu me sukses stazhin në kooperativën tonë, është plotësisht në gjendje të mbrojë temën e diplomës. Kolsh, 1.4.1974.

Sekretari i Komitetit Ekzekutiv të KR të Rrethit, Dali Tota, në fund të saj ka vënë shënimin: “Ky dokument të vendoset në dosjen e tij”.

Me këtë karakteristikë, e cila pason atë të përfundimit të studimeve, fillon seria e vlerësimeve të punës, të lidhura në dosjen time të kuadrit që vazhdon deri në vitin 1989.

Metoda bilancuese, bazë për ngritjen e nivelit shkencor të planifikimit në bujqësi

Në përfundim të studimeve, gjatë vitit të stazhit, ne kishim dy mundësi për t'u diplomuar: t'i nënshtroheshim një provimi formimi ose të mbronim një temë diplome. Shumica zgjidhnin alternativën e parë, pasi ishte me më pak telashe. Një pjesë e vogël, përgjithësisht ata që kishin dëshirë për t'u marrë me punë studimore, zgjidhnin alternativën e dytë.

Kështu, së bashku me dy shokë të kursit, Skënder Gjatën dhe Daman Sinanin, zgjodhëm temën me titull: “Zgjerimi dhe përsosja e metodës bilancuese - bazë për ngritjen e nivelit shkencor të planifikimit në bujqësi”. Temën e morëm në linjën e katedrës të organizimit të Fakultetit të Ekonomisë Agrare, kurse udhëheqës kishim prof. Besim Bardhoshin, shef i katedrës së planifikimit të Fakultetit të Ekonomisë në UT. Tema ishte e njëjtë për të tre ne, por do të trajtohej në analizën e të dhënave të tri ekonomive bujqësore ndryshme ku po kryenim stazhin, përkatësisht: të Kolshit (Kukës), të Vaqarit (Tiranë) dhe të Shirgjanit (Elbasan).

Temat e diplomës i mbrojtëm më 15 maj 1974, në prani të komisionit

si dhe disa pedagogëve e studentëve të interesuar. Secili nga ne, duke përdorur shembuj nga ekonomitë në studim, arritëm në përfundime dhe rekomandime të përafërta për ngritjen e nivelit shkencor të planifikimit në bujqësi. Mirëpo drejtimi i temës nga një profesor i jashtëm (nga Universiteti i Tiranës) kishte ngjallur xhelozin në ndonjë pedagog të brendshëm të ILB, që krahas pyetjeve dhe ndonjë “sugjerimi”, përpiquej të ndikonte në vlerësimin e komisionit, por kjo nuk ka rëndësi.

Rëndësi ka fakti që përmbajtjen e temës ne e kthyem në artikull për gazetën “Zëri i popullit”. Disa ditë para se të mbronim diplomat, na lindi ideja që një përmbledhje të saj ta botonim në shtypin e ditës, duke synuar gazetën më të rëndësishme të kohës. Fillimisht hartova një draft prej 4 faqesh me shkrim dore, të cilin e diskutuam bashkërisht të tre. Në foton që kemi paraqitur këtu, kemi dalë të ulur në stolin e gurtë mbi lulishten e atëhershme, pranë monumentit të heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, duke diskutuar për shkrimin. Pas diskutimeve mora rrugën drejt redaksisë së gazetës, në ish-bulevardin “Stalin”, tani “Zogu i Parë”. Te hyrja më thanë të takohem me një gazetar që mbulonte problemet e bujqësisë e që quhej Ibrahim Baçi.

U ngjita në katin e tretë, trokita dhe hyra në zyrën e tij, me dy tavolina në formë T-je. Pasi u përshëndetëm, i zgjata shkrimin, të cilin ai filloi ta lexojë pa zë. Pas leximit ai ngriti kokën dhe tha se shkrimi trajtonte një problem të kohës, siç është rritja e nivelit shkencor të planifikimit. Ka edhe shembuj konkretë nga ekonomitë bujqësore ku keni punuar ju, - shtoi më pas. Ai tha se shkrimi mund të botohet, por nuk dha ndonjë datë, pasi, siç u shpreh, kishte edhe shefa më lart. Shkrimin e kishim nënshkruar me emrat tanë si “ekonomistë agrarë (stazhierë) në Fakultetin e Ekonomisë Agrare të Institutit të Lartë Bujqësor”. Shkrimi u botua një ditë pas diplomimit, më 16 maj, me mbititullin me shkronja të mëdha: “Probleme të drejtimit të ekonomisë”. Kjo shënoi ngjarje për ne, pasi në ditët më pas në fakultet, jo vetëm shokët, por edhe pedagogët na uronin për të. Këtu po sjell edhe pjesën e gazetës që përmban shkrimin e botuar.

Botimi i shkrimit ishte një nxitje e re për mua, pasi deri atëherë kisha botuar në gazetën tonë “Studenti i Bujqësisë”, në gazetën “Përpara” të Korçës, në “Drita”, në revistën “Nëntori”, por tani kisha mbërritur tek organi më i rëndësishëm i shtypit shqiptar. Aq më tepër me një shkrim problemor për planifikimin në ekonomitë bujqësore. Meritë për këtë pati edhe Ibrahim, i cili e vlerësoi pa na paragjykuar se ishim ende të rinj për të dalë në faqet e kësaj gazete.

Stërvitja ushtarake: 1 korrik 1974 - 27 nëntor 1974

Pas diplomimit dhe disa ditëve pushime në familjet tona, më 1 korrik 1974 filluam stërvitjen ushtarake. Stërvitja ushtarake (apo zbori) përbënte brinjën e tretë të trekëndëshit të detyrueshëm të kohës (pas mësimit dhe punës në prodhim) që mbyllte procesin mësimor universitar. Ajo zgjaste si rregull 6 muaj, por ne bëmë një program 5-mujor në repartin ushtarak nr. 4896 në Drojë-Mamurras, një qendër e përshtatur për studentët e shkollave të larta.

Atë vit ishim një numër i madh studentësh të sapodiplomuar, ndoshta rreth 400 nga Universiteti i Tiranës, Instituti i Lartë Bujqësor dhe Instituti i Lartë i Arteve. Stërvitjen e kryem në llojin e armës së këmbësorisë, e cila ishte mjaft e vështirë nga ana fizike. Toga jonë përbëhej prej rreth 20 vetash. Si këmbësorë ishim të pajisur me armatim të lehtë: automatik tip kallashnikov, lopatë xheniere, vezme me fishekë, çantat e shpinës me takëmet e nevojshme etj.

Mjaft gjallëri i jepnin kampit ushtarak studentët e Institutit të Lartë të Arteve. Aty kemi ndjekur recitimet e aktorëve të rinj, si: Piro

Malaveci, Zehrudin Dokle, Sotirag Bratko, Besnik Kurti etj., kemi dëgjuar muzikën e Aleksandër Lalos dhe Osman Mulës... Në kujtesë më kanë mbetur disa artistë të rinj, të cilët në kohën e lirë krijojnë “banda frymore”, ku në vend të veglave muzikore përdornin lugë, garuzhde dhe u binin kapakëve të tenxhereve...



Maj 1974: Me Daman Sinanin dhe Skënder Gjatën duke diskutuar për artikullin

Kryetar i degës së planit në kooperativën bujqësore të Kolshit

Ndërkohë që vazhdoja ende stazhin në kooperativën e Kolshit, vendin e kryetarit të degës së planit në Klos të Fanit e kishte zënë A. Baruti. Kështu që, ndonëse ende nuk më kishin vënë në dijeni për ndonjë ndryshim, logjikisht unë duhej të zëvendësoja Myrton në Kolsh e ky të transferohej në Shkodër. Dhe kështu ndodhi. Po shkonte në vend «premtimi» i A. Kërkhaliut, mendova me vete. Klos me Kolsh kanë ndryshim vetëm një “h”, por në terren janë goxha larg: Klosi në skaj në Mirditë, kurse Kolshi ngjitur me Kukësin!

Punuam së bashku me Myrton ca ditë të muajit dhjetor për të përgatitur raportin vjetor statistikor dhe pas kësaj ai u largua. Punën e fillova me pasion dhe me ambicie profesionale për të bërë përmirësime në mbajtjen e dokumentacionit bazë, në evidentimin më të mirë të punës së kryer nga kooperativistët, në zhvillimin e analizave ekonomike që t'i shërbenin rritjes së vlerës së ditës së punës. Fillova të hyj më thellë në problemet e kooperativës, të përgatis raportet e analizat për kryesinë e kooperativës, në të cilat gjeja mirëkuptimin e kryetarit Xhemë Visha.

Në zgjedhjet e organizuara në prill të atij viti më zgjodhën edhe sekretar të komitetit të rinisë të kooperativës, kurse konferenca më zgjodhi anëtar të plenumit të BRPSH-së të rrethit. Po më tërhiqte puna me rininë, prandaj po përpiqesha për ta gjallëruar jetën e organizatave duke aktivizuar edhe të rinj nga sektorët e arsimit, shëndetësisë etj.

Në punë e sipër po përfitoja përvojë, e cila do të më ndihmonte në karrierën time profesionale të mëvonshme. Këtu fillova të botoj për herë të parë edhe në gazetën lokale «Kukësi i Ri». Pra, e kisha marrë shtruar, me mendimin për të mbushur «afatin» tim këtu, në këtë ekonomi dhe pastaj të transferohesha... në Korçë. Kjo ishte dëshira ime në këtë kohë.

Por, përkundër këtij mendimi, nga fundi i muajit qershor Komiteti i Partisë kishte kërkuar karakteristikën time. Po përse kaq shpejt, kur nuk i kisha mbushur ende 6 muaj si kryetar i degës së planit? Në karakteristikën e firmosur nga B. Vata viheshin në dukje përpjekjet nga dhjetori 1974 deri në qershor 1975 për të ngritur nivelin e punës në degën e planit, për zhvillimin e ekonomisë kooperativiste. Përmbajtja e saj ishte në frymë pozitiviste.

Sinan Demhasa, sekretari i Komitetit të Partisë të rrethit, që mbulonte kuadrin, në fund ka vënë shënimin: “Dakord, të vihet në dokumentet e tij si kuadër”.

Inspektor në Inspektimin e Shtetit?

Disa ngjarje të ndodhura gjatë vitit 1974 e kishin rënduar gjendjen e përgjithshme social-ekonomike e shoqërore në rreth. Për të përmirësuar gjendjen, në rreth u dërguan grupe ndihme e kontrolli nga qendra. Kalam Apostoli, kryetar i Inspektimit të Shtetit, në një takim me kuadrot drejtues të ndërmarrjeve ekonomike nxori mjaft shkelje dhe propozoi masa për përgjegjësit.

Nuk kam pasur fare dijeni për kërkesën që është bërë për të më emëruar inspektor në Inspektimin e Shtetit me qëndrim në rrethin e Kukësit! Me këtë fakt për herë të parë u njoha kur dosja e punës ra në dorën time në qershor 1992. Në dosje është edhe një karakteristikë e firmosur nga Sekretari i Komitetit të Partisë S. Demhasa më datën 27 qershor 1975. Kjo do të thotë që karakteristika e firmosur nga Baftjari është bërë para kësaj date, ndoshta në datat 22-25 qershor. Disa shprehje të njëjta për të dy karakteristikat tregojnë që Baftjari i është përgjigjur një kërkesë të sekretarit të Komitetit të Partisë. Në karakteristikën e firmosur nga S. Demhasa, mes të tjerave, shkruhet: «Si kuadër i ri është shquar edhe për preokupacion e dashuri për profilin e punës. I sjellshëm me masën e kooperativistëve dhe duke punuar bashkë me ta, gjë për të cilën ka fituar respektin e tyre...Duke parë përbërjen e tij, punën dhe perspektivën, mendojmë të emërohet inspektor i Inspektimit të Shtetit me qëndrim në rrethin tonë, detyrë të cilën me ndihmën që mund t'i jepet, i ka të gjitha kushtet për ta kryer mirë”.

Po përse nuk u emërova në këtë detyrë? Në faqen mbrapa të karakteristikës, inspektori i kuadrit në Komitetin Ekzekutiv të KP të rrethit Ndue Marku ka vënë shënimin: “U gjënd në arkiv e pa sistemuar”. Kukës, 9.10.1985. Pra, është sistemuar pas dhjetë vjetësh! Tani e kam të qartë përse nuk jam emëruar aty: Ishte më e ngutshme zgjidhja e problemit të NB-së së Krumës!

Gjyqi ndaj drejtuesve të NB-së së Krumës

Nga fillimi i muajit korrik 1975 na njoftuan për të marrë pjesë në një gjyq që do të zhvillohej ndaj ish-drejtorit të NB-së së Krumës si dhe disa kuadrove e specialistëve të kësaj ndërmarrjeje. Gjyqi bëhej në pallatin e kulturës në qytetin e vjetër, por kishin vënë megafona që të dëgjohej edhe jashtë sallës. Me disa shokë të mi e ndoqëm procesin nga jashtë. Akuza e prokurorit dhe pyetjet e gjyqtarit të shtinin frikën, pasi çështja penale

kishte kaluar nga “shpërdorim detyrë” në “sabotim në përpjesëtime të mëdha të ekonomisë socialiste”. Ky nen të çonte në dënim të rëndë, sido që nuk na e merrte mendja se do të kishte dënime kaq të rënda....

Gjyqi na la një shije të hidhur dhe na tronditi edhe ne që sapo kishim dalë në jetë. Por nga ana tjetër ishte një paralajmërim për më tepër kujdes në raportimet e vlerave materiale e financiare, pasi këto mund të na ndodhnin në ekonomitë ku punonim. Sidoqoftë, atëherë unë e ndieja veten larg ngjarjeve të NB-së së Krumës...

Kryetar i degës së planit në NB-në e Krumës!

Nga mesi i muajit korrik më njoftojnë që të paraqitem në Komitetin e Partisë. Ndërtesa ishte në qytetin e ri dhe ishte hera e parë që po shkoja atje, pasi lidhjet ne i kishim me seksionet e Komitetit Ekzekutiv e sidomos me ato të bujqësisë dhe të planit. Më thanë se më priste Filip Boçi, sekretar i Komitetit të Partisë për bujqësinë. Në pritje ishte edhe S. Sulejmani, përgjegjës i zyrës së kuadrit, gjë që nënkuptonte ndonjë lëvizje kuadri të re. Filipi e filloi bisedën në formë shoqërore, pastaj shpejt vijoi me vendimin që kishte marrë Sekretariati i Komitetit të Partisë për të më emëruar kryetar të degës së planit në NB-në e Krumës, e cila ishte ekonomia bujqësore më e madhe në zonën e Hasit por edhe e rrethit të Kukësit.

Unë jam i ri, shoku.... Por pa e mbaruar mirë fjalën, ai tha se vërtet isha i ri, por kisha edhe përvojën e Kolshit, prandaj kishin besim se do ta kryeja me sukses këtë detyrë. Ai tha se partia kishte dërguar aty kuadrot më të mirë (këtu përmendi I. Dyrmishin dhe V. Gjokollarin) me qëllim që ta nxjerrim Krumën nga prapambetja. Po kështu, NB Kruma po plotësohej edhe me kuadro dhe specialistë të tjerë. Veç kësaj, ai shtoi se duhej të paraqitesha sa më shpejt, pasi vendi i shefit të planit ishte bosh prej tre muajsh.

Mungon karakteristika për emërimin në NB-në e Krumës

Nga shqyrtimi i dosjes, del se aty mungon një karakteristikë e veçantë me propozim për t'u emëruar në NB-në e Krumës, siç ka pasur në rastet e mëparshme apo të mëvonshme. Në fletën e llojit të punëve që keni bërë, del thjesht vendimi i Sekretariatit të Komitetit të Partisë të rrethit me numër 266, datë 7.7.1975, që më emëronte kryetar të degës së planit.

Pse nuk është sistemuar në kohë karakteristika e S. Demhasës, kur dihet se procedurat për emërim e lëvizje të kuadrove nga organet partiake apo shtetërore nuk mund të bëheshin pa një karakteristikë pune?

Në dosje nuk gjen shpjegime. Shpjegimi mund të jetë ky: plotësimin e vendit bosh të kryetarit të degës së planit në NB-në e Krumës Sekretariati i Komitetit të Partisë e ka vlerësuar si më prioritar ndaj kërkesës së Inspektimit të Shtetit! Sigurisht, në këtë vendim do të ketë ndikuar edhe kërkesa e përsëritur e drejtorit Izet Dyrmishi. Këtë do ta kuptoja më mirë kur do të shkoja ta takoja vetë aty... Si do të kishte shkuar jeta ime nëse do të isha emëruar qysh më 1975 aty? Shumë hamendje mund të krijohen tani, po më mirë që nuk e kam ditur atëherë, pasi u përkushtova tërësisht në detyrën time të kryetarit të degës së planit në NB-në e Krumës.

GUSHT 1975 - SHTATOR 1979 - KRYETAR I DEGËS SË PLANIT NË NB-NË E KRUMËS

Dita e parë në Krumë

Më 1 gusht 1975 u nisa për në Krumë me autobusin e linjës, (një 30-vendësh), i ulur andej nga fundi. Po e bëja këtë udhëtim atje për herë të parë dhe me kureshtje pasi historikisht . Kruma ka qenë kryeqendra e zonës së Hasit. Ndërsa me emërimin në Klos të Fanit e kisha drejtimin për në brendësi të vendit,tani po shkoja më në veri, përkrah kufirit të at'hershëm me Kosovën, afër me rrethin e Tropojës.

Me vete kisha një valixhe (prej kartoni), ku kisha vendosur “gardërobën” time, përfshirë edhe një radio-transistor me bateri “Iliria”, prodhim i URT, Durrës. Me siguri do të kem lënë përshtypjen e një “jabanxhiu”, ndoshta të ndonjë arsimitari, pasi ata ishin më të shumtë në atë kohë. Pyetjeve të rastit u ktheja përgjigje të shkurtra, më tepër meditoja.

Rruga prej 32 km, e ndërtuar me aksion më 1969, ishte e paasfaltuar, por jo dhe fort e keqe. Pamjet që dilnin para dhe anash dritareve të hapura gjithashtu nuk dukeshin aq të ashpra sa i kisha menduar. Madje, pasi dolëm në Tregtan, nuk pashë më ndonjë shkëmb, por kodra me bimësi pyjore e toka ara të sapokorrura nga gruri apo të mbjella me misër e foragjer. Pas më shumë se një ore, autobusi ndaloi aty ku kishte stacionin, afër postë-telegrafës, përballë një ndërtese dykatëshe, ku i sipërmi ishte hotel, kurse kati i parë restorant.

Kjo ishte “qendra” e qytetit (apo qytezës) të vjetër të Krumës.

Ishte mesditë e vapë. Pasi zbrita dhe po kërkoja dikë për ta pyetur për zyrat e drejtorisë së ndërmarrjes bujqësore u përballa me një djalë të ri, të shëndoshë, të nxirë nga dielli. Ai, duke e ndier se do të isha ndonjë specialist i ri i ndërmarrjes, u tregua i gatshëm për të më shoqëruar atje. Adem Muneka, kështu quhej, ishte fillrojtës i zonës.

Pas nja 10 minutash në një rrugë këmbësore në arën e korrur nga gruri, arritëm te ndërtesa e drejtorisë e NB-së së Krumës. Trokitëm dhe hymë pasi dikush nga brenda na dha lejen. Zyra e planit ishte një dhomë mesatare, me dy tavolina të kryqëzuara me sistem T-je, me tri karrige, me një dritare me hekura e drejtim nga veriu.

“Shefi planit tuj”, iu drejtua Ademi personit që dukej se ishte ulur në krye të T-së që duhej të ishte karrigia e shefit, një mesoburrë me mustaqe, ndërkohë që unë i zgjata dorën. Ky lëvizi pak, më dha dorën dhe më ftoi të ulesha në karrigen bosh. Ndërkohë Ademi, duke e konsideruar të kryer detyrën e tij, na mori leje të largohej.

- Pa hë, bre burrë, përse kini ardhë?

Mbeta i befasuar nga kjo pyetje, por mendova se vendimi për emërimin tim nuk do të kishte ardhur ende, prandaj aty për aty iu përgjigja:

- Do të bisedojmë më vonë, por më parë dua të takoj shefin e kuadrit.

Lashë valixhen aty dhe dolëm në korridor ku “mesoburri me mustaqe” më orientoi me dorë të gjeja zyrën e shefit të kuadrit që ishte në anën e kundërt të zyrës së planit. Ai u fut përsëri brenda, kurse unë nga më drejtoi ai. Sapo u prezantova, Ibrahim Peçaku, kështu quhej përgjegjësi i kuadrit, më tha se vendimi kishte ardhur, e kishte mbi tavolinë dhe m’i lexoi ata pak rreshta me numër, datë, paga mujore etj. Ndërkohë që ne po bisedonim, ia behu “burri me mustaqe”.

- Po më fal, bre burrë, se nuk jena marr’ vesh. Kujtova se ishit shefi i planit t’ujrave.

- Nuk ka problem, gjëra që ndodhin, këtu do të jemi tani, - iu përgjigja.

Kishte ndodhur një keqkuptim, të cilin Shaban Haxhia, kështu quhej “burri me mustaqe”, ekonomisti i furnizimit në degën e planit, ma shpjegoi kur hymë në zyrë duke më drejtuar te karrigia e shefit dhe ai duke u ulur në karrigen e vet.

- M’u dëgjua se ishit “shefi i planit i ujrave”.

Shqiptimi: “t’ujrave” kishte “hyrë në ujë” dhe ishte bërë “t’uj”. Ademi që ishte ende te dera e daljes nga zyrat, e kishte pyetur: - Hë, si t’u duk shefi i ri?

- Ç' thua, more, po a nuk ishte ai shefi i planit i ujrave?
- Ama, ç' jena marr vesh! - i kishte thënë Ademi duke tundur kokën.



Pamje e qytetit të Krumës në fillim të viteve 1970

Takim me drejtorin

Izetin e takova në kafenë në “qendër” të Krumës, në pasditen që mbërrita. Ai ishte duke biseduar me nëndrejtorin e ndërmarrjes, Gjergj Kolën, agronom nga Fani. Pasi i përshëndeta dhe më ftoi të ulesha, shprehja e parë ishte: “Po ku je, o Luan, se po të presim!”. Posti kishte rënë, por diçka kishte mbetur nga autoriteti i sekretarit të parë, prandaj nuk fola. Fakti që “po më prisnin” tregonte se jo vetëm kishte dorë në emërimin tim, por edhe padurim pse po vonoja. Kjo më kujtoi edhe porosinë e F. Boçit kur më komunikoi vendimin e emërimit për t’u paraqitur sa parë në detyrë. Më pas, gjatë bisedës së tyre, fillova të njihem me detyrat më të ngutshme të atyre ditëve, të dëgjoj për herë të parë emra kuadrosh e specialistësh dhe emërtime sektorësh të ndërmarrjes.

Organizimi dhe drejtimi i NB-së së Krumës

Një nga mangësitë e para që vërejta kur fillova punën në NB-në e Krumës ishte mungesa e një rregulloreje për organizimin dhe funksionimin e saj. Pra, nuk kishte përshkrim për detyrat që duhej të kryenin drejtori, zv.drejtori, kryeagronomi, kryetarët e degëve, si të prodhimit, planit, financës, kuadrit apo personelit, përgjegjësit e sektorëve e nivele të tjera

më të ulëta. Këto ishin organizuar sipas praktikave të trashëguara më parë.

Por duke u thelluar më tej më doli se nuk ekzistonte as ndonjë rregullore tip për NB-të në shkallë vendi, siç ishte miratuar në atë kohë për kooperativat bujqësore. Si e kishte lejuar këtë mangësi Ministria e Bujqësisë? Kjo duhej korrigjuar, pasi mungesa e rregullores për detyrat dhe përgjegjësitë e personave drejtues, degëve e sektorëve linte shtigje për mbivendosje kompetencash e mungesë përgjegjësie. Kjo kishte sjellë si pasojë edhe disa nga shkeljet që kishin ndodhur në rastin e administrimit të prodhimit të misrit dy vjet më parë.

Pasi nuk gjeta ndonjë praktikë të shkruar në ndërmarrje dhe në drejtorinë e NB-ve në Ministrinë e Bujqësisë, fillova të interesohem në NB-të e tjera. Më dërguan pjesë rregulloresh për degë të veçanta nga NB-ja e Thumanës, që kishte përvojë në organizim si dhe ndonjë tjetër.

Mbi këtë bazë si dhe nga rregullorja tip e kooperativave bujqësore, brenda tre-katër muajve të parë arrita të përshtat një rregullore për ndërmarrjen tonë. Drejtori, Izeti, e lexoi, bëri disa vërejtje, të cilat i korrigjova dhe më pas e firmosi. Kështu kjo rregullore u bë e detyrueshme për të gjitha degët brenda drejtorisë dhe sektorët e ndërmarrjes. Një kopje të rregullores e nisa edhe në drejtorinë e NB-ve në Ministrinë e Bujqësisë, që shërbeu si nxitje për të hartuar një rregullore tip në shkallë vendi. Rregullorja pati ndikimin e saj që të dilte më në pah përgjegjësia e secilit dhe të parandaloheshin ato shkelje që ishin bërë në vitet e mëparshme.

Dua të vë në dukje me këtë rast se të punuarit me përgjegjësi të përcaktuara qartë për degë, sektorë apo poste m'u bë një "ves" që më ka shoqëruar në detyrat e mëvonshme. Një metodë e tillë është paksa burokratike, por ndikon në shmangien e shkeljeve ligjore dhe të korrupsionit.

Ekipi drejtues i NB-së së Krumës në qendër

Ekipi drejtues kur fillova punën në NB-në e Krumës përbëhej nga kuadro të njohur e me përvojë, specialistë të përgatitur e të përkushtuar për detyrat e ngarkuara. Më i riu isha unë, me vetëm dy vjet përvojë pune, por i shqetësuar për detyrën si gjithë të tjerët.

Drejtori Izet Dyrmishi

I. Dyrmishin e gjeta sekretar të parë të Komitetit të Partisë të rrethit kur shkova për herë të parë në Kukës në gusht 1973. Ai ishte në këtë detyrë prej dhjetorit të vitit 1968, pasi më parë kishte pasur të njëjtën detyrë në rrethin e Tropojës dhe një përvojë të shkurtër në aparatën e KQ të partisë. Në fillimet e tij kishte pasur detyra partiake edhe në Skrapar e Berat.

Opinionin në atë kohë ishte i ndarë lidhur me emërimin e Izetit në NB-në e Krumës: shumica e besonin vërtet se atë e kishin dërguar aty për të nxjerrë ndërmarrjen nga prapambetja. Ata e kishin dërguar se e kishte pritur mirë emërimin këtu pas shkarkimit si sekretar i parë. Ata e shikonin që ai përpigjej, por vetë Kruma ishte një “kafshatë që nuk kapërdihej”.

Por ndërkohë qarkullonte edhe një mendim tjetër që Izetin e kishin sjellë këtu për “ta djegur”. Drejtuesit e partisë dhe pushtetit në rreth, por edhe në qendër, jo vetëm nuk po e ndihmonin, por po e shkurajonin në punën e tij të re. E kishin emëruar drejtor, por në të njëjtën kohë e kishin “hequr” si deputet në Kuvendin Popullor dhe anëtar të byrosë së partisë të rrethit. Kjo shfaqej edhe në ndonjë detaj si pa rëndësi.

Kryeagronomi Vangjel Gjokollari

Vangjeli ishte njohës i mirë i bujqësisë, me një përvojë të gjatë pune. Kishte filluar studimet për agronomi në Zagreb, por pasi u prishën marrëdhëniet me Jugosllavinë, i vazhdoi në Tiranë. Ishte në grupin e studentëve të parë që krijuan ILB më 1951. Ai i kishte kaluar të gjitha hallkat e karrierës: agronom sektori, kryeagronom në NB-në e Thumanës, zv/kryetar i komitetit ekzekutiv të kp të rrethit të Krujës për bujqësinë.

Kishte qenë kërkesa e Izetit, si sekretar i parë, për ta “marrë” Vangjeli detyrën e zv/kryetarit të komitetit ekzekutiv në rrethin e Kukësit në vitin 1972. Më 1975, pasi u “godit” Izeti, e “pësoi” edhe Vangjeli. Kur Izeti u transferua në NB-në e Krumës, Vangjeli e ndoqi në rolin e krahut të djathtë, të kryeagronomit të ndërmarrjes. Kur Izeti u shkarkua, Vangjeli pësoi një ulje nga kryeagronom në kryetar i degës së prodhimit. Më pas, në vitin 1978, Vangjelit “ulja” i doli për mbarë, pasi u transferua në detyrën e shefit të seksionit të bujqësisë të rrethit të Tiranës.

Në dosjen time kam një karakteristikë që mban datën 10.5.1977, të shkruar me dorë nga Vangjeli, në cilësinë e sekretarit të organizatës së partisë të administratës, ku në fund shprehet për mua se “është shok me

perspektivë”. Ruaj mbresat më të mira për bashkëpunimin profesional e shoqëror me Vangjelin nga puna në Krumë, por edhe më vonë.

Në detyrën e kryeagronomit Vangjelin e zëvendësoi Ramazan Muça, një specialist i ri vendës, agronom në sektorin e Fajzave. Rama e vlerësonte përgjegjësinë e detyrës, i njihte mirë terrenin dhe njerëzit. Ishte i ndershëm, por mjaft i ndjeshëm ndaj kritikave. Kështu e përjetoi ai një kritike të I. Subashit, sekretar i Komitetit të Partisë që mbulonte ekonominë, i cili na kritikoi të dyve për mosrealizim detyrash në një nga numrat e gazetës “Kukësi i ri” të muajit qershor 1978. Unë i thosha me shaka se Islami kishte të drejtë, pasi tani ne kishim mbetur “më të vjetrit”.

Zv/drejtori Gjergj Kola

Gjergji ishte agronom nga zona e Fanit, por familjarisht banonte në Krumë. Si zv/drejtor ai mbulonte aktivitetet e tjera përveç bujqësisë, të cilat drejtoheshin nga kryeagronomi dhe degët përkatëse. Gjergji e njihte mirë bujqësinë dhe NB-në e Krumës dhe për më tepër kishte marrëdhënie të mira me kuadrot kryesorë në rreth. Nuk është e rastit që ishte pikërisht ai që zëvendësoi Izetin pas largimit të tij. Gjergji, ndryshe nga Izeti që e “zhveshën” nga mbështetjet politike pas marrjes së detyrës së drejtorit, u zgjodh anëtar i Komitetit Ekzekutiv. Me Gjergjin drejtor punova derisa u transferova në Kukës, në shtator 1979.

Kur Gjergji u “gradua” drejtor, vendin e zëvendësit e zuri Isa Brasha, inxhinier mekanik, me origjinë nga një familje e njohur Helshani, pra nga Hasi. Isai ishte kuadër me përvojë, pasi më parë kishte drejtuar SMT-në e rrethit. Ai dha një kontribut efektiv për mbarëvajtjen e sektorit të mekanikës, i cili luante një rol përcaktues për fushatat e mbjelljeve dhe korrje-shirjeve të drithërave të bukës e bimëve të tjera bujqësore.

Kryetari i degës së prodhimit Aqif Hoxha

Aqifi ishte agronom nga Ujmishti. Ai erdhi në Krumë familjarisht, me të shoqen nga Vlora. Aqifi ishte një specialist metodist, që kishte njohuri edhe në problemet ekonomike dhe financiare. Me ndihmën e degës së prodhimit arritëm të hartonim për herë të parë kontot kulturore, të cilat ishin një kombinim i proceseve të punës për çdo bimë, të shoqëruara me efektet ekonomike dhe financiare përkatëse të tyre. Në këtë mënyrë arritëm

që të disiplinonim shpenzimet pa kriter. Më vonë Aqifi kaloi përgjegjësi në sektorin të parë, atij të Krumës.

Në këtë degë bënte pjesë edhe Nikoll Çupi, agronom për mbrojtjen e bimëve, nga Fani, me të cilin kishim mbaruar ILB-në në të njëjtin vit. Ishte një specialist i ri i përgatitur. Të dy më vonë u transferuan në Kukës dhe më pas në Tiranë, ku edhe i kam takuar në raste të ndryshme.

Kryetarët e degës mekanike

Sektori i mekanikës ishte vendosur në sektorin e dytë, në atë të planit, por i shërbente të gjithë ndërmarrjes. Mekanika luante një rol vendimtar për zbatimin e afateve të vendosura për proceset e punës, veçanërisht për mbjelljen, korrije-shirjen dhe grumbullimin e drithërave të bukës, të cilat përbënin edhe drejtimin kryesor të ndërmarrjes.

Fillimisht kryetar i degës mekanike ishte inxhinieri mekanik Agim Omuri, me origjinë nga Kukësi, por me banim në Tiranë, i cili më parë kishte punuar në NB-në “29 nëntori” të Lushnjës. Ishte punëtor dhe i drejtë, por mekanika haste në vështirësi në tokat e rënda të Krumës. Veç kësaj, ankohej edhe për ndonjë problem shëndetësor, prandaj u transferua shpejt.

Agimin e zëvendësoi Xhemali Elezi, edhe ky inxhinier mekanik nga Kukësi, që kishte punuar më parë në SMT. Përvoja e punës që kishte fituar më parë e ndihmonte të kapte e zgjidhte më shpejt problemet e shumta të mekanikës në ndërmarrje, që vinin edhe për shkak të mungesës së pjesëve të këmbimit, veçanërisht të importit.

Vendin e Xhemaliut, që u transferua në Kukës, e zuri Esat Dogjani, edhe ky inxhinier mekanik nga Kukësi (Bicaj), i cili kishte qenë më parë kryetar i degës mekanike, por kishte kaluar inxhinier në kuadrin e masave që ishin marrë për drejtues e specialistë të ndryshëm të ndërmarrjes. Prej Esatit kam karakteristikën kur jam transferuar nga Kruma, me cilësinë e sekretarit të organizatës së partisë.

Dega e kuadrit

Kryetari i degës së kuadrit Ibrahim Peçaku ishte vendali dhe kishte qenë më parë kryetar i këshillit popullor të qytetit të Krumës. Ibrahim ishte korrekt në detyrën e shefit të kuadrit, por edhe më i afrueshëm me ne

të rinjtë. Me Ibrahimin, kur dilnim nëpër sektorë, bënim edhe ndonjë qitje në natyrë me pistoletën që mbante me leje. Më vonë ai u zëvendësua nga Ymer Cenalia nga Vranishti, një veprimtar shoqëror mjaft i njohur në këtë zonë. Pas Ymerit erdhi Esat Cahani, arsimtar nga Cahani, një fshat malor pjesë e ndërmarrjes, tepër korrekt në zbatimin e detyrës.

Dega e planit

Dega e planit në qendër përbëhej nga 3 punonjës: kryetari, që isha unë; një ekonomist për evidencat statistikore ditore dhe periodike dhe një tjetër me furnizimin materialo-teknik.

Petrit Nenada, një ekonomist i mesëm nga Kruma, rreth të dyzetave, ishte i ngarkuar me statistikat. Petriti kishte një kaligrafi (shkrim) të rregullt, evidencat i paraqiste në kohë dhe me kujdes. Me anë të këtyre të dhënave drejtori dhe kuadrot e tjerë të ndërmarrjes orientoheshin për ecurinë e punëve në ndërmarrje, p.sh. për mbjelljet, korret, për prodhimin e grurit, misrit, drithërave në tërësi, perimeve, të qumështit, të vezëve etj. Petriti, për fat të keq, u nda shpejt nga jeta, nga një sëmundje e rëndë, pasi isha transferuar në Kukës.

Shaban Haxhia, ekonomisti i furnizimit, që përmenda pak më lart, ishte nga Tropoja, me shkollë të mesme. Ai kishte drejtuar ndërmarrjen e shërbimeve komunale, por më vonë, nuk e di pse, e kishin transferuar në Krumë. Shabani ishte korrekt në ndjekjen e kontratave, ndonëse në këtë kohë shpeshherë ndienim mungesën e karburanteve, plehrave kimike, veglave të punës etj.

Në korrik 1977 në degën e planit u emërua Apostol Jorgji nga Vergoi i Sarandës, i cili kishte mbaruar Fakultetin e Ekonomisë Agrare dhe do të bënte stazhin pranë meje. Në maj 1978 ai mbrojti diplomën dhe u kthye, por tani me emërim përfundimtar. Po më vinte edhe mua rasti për transferim, pasi po binte argumenti se “nuk kemi më kë të transferojmë”.



*Kryetar i degës së planit i NB
Krumës, 1975-1979*

Ekonomistët dhe normistët e sektorëve

Dega e planit kishte në vartësi ekonomistët dhe normistët në të gjithë sektorët. Ata kishin përgjegjësi për plotësimin e rregullt edhe të raporteve të punës nga brigadierët që përbënin edhe bazën e plotësimit të dokumenteve të tjera. Në kohën kur shkova aty, nuk kishte ndonjë ekonomist me arsim të lartë. Pas një viti në sektorin e parë u emërua Lumnije Dogjani, ekonomiste e lartë nga Tropoja, bashkëshorte e inxhinierit Esat Dogjani nga Bicaj, kryetare e degës së planit, që kishte kaluar “në prodhim” si pasojë e masave që u morën në atë kohë.

Ekonomistët e tjerë ishin me arsim të mesëm ekonomik, bujqësor, apo thjesht me përvojë praktike. Kështu, në sektorin e planit ekonomiste ishte S. Laçi, vajzë nga një fshat aty afër, në sektorin e mekanikës ishte Bali Sokoli nga Vlahna, që ishte edhe i moshuari, kurse më i riu, Halim Cenalia, ishte nga Fajza. Ai nuk e kishte arsimin e mesëm në atë kohë, por e arrinte atë nivel me një punë të kujdesshme. Në sektorin e mekanikës normist kishim Hysen Didën, një rapsod i talentuar dhe i njohur jo vetëm në Has e në Kukës, por edhe në Kosovë e diasporë.

Pak muaj pasi fillova punën, mobilizova të gjithë ekonomistët dhe normistët për rishikimin e normave të punës dhe njësimin e tyre në shkallë ndërmarrjeje. Rishikimi dhe vendosja e tyre mbi bazën e përvojës së përparuar të vetë ndërmarrjes ndikoi në rritjen e rendimentit të punës, në disiplinimin e fondit të pagave dhe uljen e rasteve të shpërblimeve të pamerituara. Në analizat mujore përpiquesha të përhapja edhe përvojën midis sektorëve. Në marrëdhënie me vartësit, në plan të parë vija edukimin, trajnimin, kërkesën e llogarisë, për rrjedhojë, nuk m'u dha shkas të propozoj masa për ndëshkimin e ndonjërit prej tyre.

Katër humbjet e kohës

Pak pasi fillova të njoh më mirë punën, terrenin fizik dhe atë shoqëror të ndërmarrjes po vëreja se kishte rrezik të bija në humbje kohe nëse nuk e programoja atë dhe e lija në rrjedhje të lirë. Rreziku i parë ishte rënia në plogështi e në mungesë perspektive kur shikoje që specialistë të ardhur nga rrethe të tjera, jo vetëm të bujqësisë, por edhe të degëve të tjera, si arsimtarë, inxhinierë (sidomos të minierave), mjekë, oficerë kishin vite e s'kujtohej njeri për ta.

Kishte prej tyre që ishin të dhënë më shumë se ç'duhej pas pijeve

alkoolike, sidomos atyre me ngjyrë që shkonin me të ftohtin e dimrit, të tjerë që kishin filluar duhanin, që ndiqnin me orë e pa orë radion e sidomos televizorin, ishin të pasionuar pas motoçikletave etj.

Ndërkohë nga filozofia e dija se koha ka një veti karakteristike: është e pakthyeshme. Populli me të drejtë thotë se “koha është flori”. Prandaj duhej përdorur me kujdes koha. Një nxitje më erdhi edhe nga botimi në një numër të revistës “Ylli” të vitit 1975 (nuk më kujtohet muaji), mes disa kurioziteteve, e katër mënyrave të humbjes së kohës, që ishin:

- Duke mos bërë asgjë!
- Duke e bërë gabim!
- Duke mos bërë atë që duhet!
- Duke mos e bërë në kohën e duhur!

Tani që “mësova” katër mënyrat e humbjes së kohës, pyetja që dilte para meje ishte: a do të isha në gjendje ta shmangia rënien në një nga këto katër humbjet e kohës? Aq më tepër që në konceptin e kohës nuk përfshija vetëm atë pjesë për të cilën isha emëruar e paguhesha, por edhe atë që mbetej e lirë pas kohës të gjumit. Sidoqoftë, më pëlqeu ky formulim kaq i qartë, prandaj e ngulita mirë në kokë. Por shpesh, sidomos gjatë ditës, nga problemet e shumta që dilnin, pa dashur bija në ndonjë prej këtyre “humbjeve”. Prandaj, me qëllim që t’i kisha parasysh, i shkrova me bojë tushi të zi në një gjysmë letre format dhe e futa poshtë xhamit të trashë të tavolinës.

Tani dita ime e punës fillonte me kujtesën për të mos humbur kohën!

Pas pak më shumë se katër vjet në NB Krumë, mora një emërim të ri, por përsëri...brenda rrethit të Kukësit...

Një analizë e shkurtër treguesve kryesorë të NB-së së Krumës në vitet 1975-1985

Tabela me të dhëna për veprimtarinë e NB-së së Krumës për vitet 1975-1985, e përgatitur nga Seksioni i Bujqësisë dhe Banka Bujqësore, Kukës në vitin 1986 në vijim krijon mundësi për të bërë një analizë të shkurtër të treguesve ekonomikë dhe financiarë të saj. Këto të dhëna janë deri në vitin 1985, kur kjo ndërmarrje u nda në dy: NB e Krumës dhe NB e Fajzave, që më parë ishte sektor.

Tabela përmban tregues kryesorë të numrit të familjeve, të banorëve, sa në moshë pune, të punonjësve gjithsej e punëtorëve në veçanti, të fondit

të pagave, të numrit të sektorëve e brigadave, të të ardhurave, shpenzimeve, të humbjes financiare, të investimeve, të plehrave kimike të përdorura, për mekanikën bujqësore, për prodhimin e përgjithshëm bujqësor të ndarë sipas degëve, bimë të arave, pemëtari, blegtori, për sipërfaqen e tokës së punuar, në tokën arë, pemëtore, vreshta, për hapjen e tokave të reja.

Po kështu, vijon me sipërfaqet e mbjella, rendimentet dhe prodhimet e realizuara në drithëra buke, ndarë në grurë, misër, thekër, në perime, patate, tagjira e foragjere, në pemë frutore.

Të dhëna paraqiten edhe për numrin e krerëve, rendimentet dhe prodhimet e mishit, qumështit, leshit, vezëve.

Nga këto të dhëna del se në territorin e NB-së së Krumës ka pasur nga 560 familje më 1975, në 1100 më 1980 dhe 1415 më 1985. Pra, gjatë 11 vjetëve numri i familjeve në këtë ndërmarrje bujqësore është rritur 2.5 herë. Kjo rritje ka ardhur si rrjedhojë e ndarjes së familjeve të mëdha, por edhe e hyrjes së familjeve të reja nga fshatrat, veçanërisht nga familjet e zhvendosura nga fshatrat e përmbytura nga liqeni i Fierzës, nga Bruti e Ramhasi e deri në Vaspas.

Numri i banorëve është rritur nga 4460 më 1975 në 6960 më 1980 dhe 8819 në vitin 1985, ose gati 2 herë më shumë se më 1975. Në vitin 1975 një familje ka pasur mesatarisht 8 anëtarë, në vitin 1980 dhe 1985, rreth 6 anëtarë.

Në vitin 1975 ndërmarrja ka pasur 1490 punonjës, nga të cilët 1380 punëtorë dhe 110 personel drejtues, në vitin 1980 ky numër ka arritur në 2185 dhe në vitin 1985 në 2459 ose 65 për qind më shumë se më 1975.

Fondi i pagave është rritur nga 8770 mijë lekë në vitin 1975, në 11634 mijë në vitin 1980 dhe 12974 më 1985, ose 48 për qind më shumë se 11 vjet më parë.

NB-ja e Krumës ka pasur 6 -7 sektorë dhe 34 brigada më 1975, 50 më 1980 dhe 55 më 1985.

Të ardhurat në vitin 1979 kanë shënuar një rritje prej 4883 mijë lekë ose 55 për qind kundrejt vitit 1975, duke qenë gjithashtu 3129 mijë lekë ose 30 për qind më shumë edhe ndaj vitit 1985. Këto të dhëna tregojnë që veprimtaria e ndërmarrjes ka qenë me luhatje të ndjeshme në treguesin e të ardhurave, madje duke u keqësuar në vite.

Nga ana tjetër, ndërsa në të ardhura janë krijuar mosrealizime, në shpenzime janë shënuar vetëm rritje. Kështu, shpenzimet nga 12276 mijë lekë në vitin 1975 janë rritur në 18302 mijë lekë më 1980, 6026 mijë lekë më shumë ose 49 për qind. Kurse në vitin 1985 shpenzimet kanë arritur në

21160 mijë lekë ose 72 për qind më shumë se më 1975.

Rritja e të ardhurave me një ritëm më të ulët se shpenzimet ka sjellë si rezultat rritjen e humbjes financiare të ndërmarrjes, nga rreth 3000 mijë lekë më 1975 në 5184 mijë lekë më 1980, 2184 mijë lekë më shumë ose rreth 73 për qind. Në vitin 1985 humbja ka arritur në 8716 mijë lekë ose 2.9 herë më shumë.

Nivel më i ulët i humbjes është shënuar në vitin 1975 dhe në vitin 1976 dhe sidomos në vitin 1979 prej 2 301 mijë lekë, që është më ulëta e 11 vjetëve në analizë. Vitet 1975-1979 kanë qenë vitet më të vështira, por edhe më efektivet e stafit drejtues të NB-së së Krumës.

Në treguesit e tjerë NB-ja e Krumës zinte një peshë të rëndësishme në shkallë rrethi për prodhimin e drithërave të bukës, që përbënin edhe drejtimin kryesor të veprimtarisë së saj. Referuar vitit 1985, për të cilin ka të dhëna të botuara krahasuese, NB-ja e Krumës ka prodhuar rreth 30 për qind të prodhimit të drithërave të bukës në shkallë rrethi, ku gruri zinte peshën më të madhe.

Rezultati më i lartë i prodhimit të drithërave të bukës është regjistruar në vitin 1979 prej 47877 kv, nga i cili, grurë 28604 kv ose 59.7 për qind, misër 19108 kv ose rreth 40 për qind dhe një sasi e vogël thekre prej 165 kv ose 0.3 për qind.

Zhvillimi i bujqësisë në NB-në e Krumës ka qenë i karakterit ekstensiv, që do të thotë se prodhimi i drithërave të bukës është bazuar kryesisht në rritjen e sipërfaqes dhe më pak në rendimentin e grurit apo misrit. Rendimentet në këto kultura kanë qenë të ulëta, në rastin më të mirë, 21 kV/ha për grurin dhe rreth 30 kV/ha për misrin.

Hapja e tokave të reja ka qenë me ritme më të larta në vitet e para dhe ka ardhur duke u ulur në vitet e mëvonshme nga 53, 40, 84, 26, 45 ha në vitet 1975-1979 në 15, 21, 23, 48, 3, 23, në vitet 1980-1985. Kështu toka e punuar dhe toka arë nuk kanë pësuar rritje të ndjeshme.

Investimet, plehrat kimike, mekanizimet kanë pasur rritje me ritme të ulëta gjatë këtyre viteve të analizuara. Defektet e traktorëve me zinxhirë kanë qenë të shpeshta e të kushtueshme dhe zëvendësimi me traktorë me goma i ngadaltë. Në vitet e fundit pati një rritje të numrit të autokombajnave, nga 4-5 në vitet 1975-1977, në 13 në vitet 1983-1985.

Në NB-në e Krumës janë mbjellë sipërfaqe të vogla me patate: 10 deri 20 ha dhe vetëm në vitin 1985 janë mbjellë 55 ha. Rendimenti dhe prodhimi ka qenë i ulët. Tradita për mbjelljen e patates ka pasur (dhe ka) zona e Shishtavecit që furnizon edhe një pjesë të tregut vendës.

Gjatë këtyre viteve ka pasur një rritje të ndjeshme të prodhimit të perimeve, kryesisht si rezultat i rritjes së rendimentit më shumë se rritjes së sipërfaqes. Kështu, prodhimi i perimeve në vitin 1975 ishte vetëm 1842 kv, kurse në vitin 1979 4294 kv dhe në vitin 1985 7368 kv ose 4 herë më shumë se më 1975. Kurse rendimenti është rritur nga 54 kv/ha në 147 ose 2.7 herë.

Një rritje e ndjeshme është shënuar edhe në prodhimin e tagjirave e foragjereve, që si dhe në rastin e perimeve, rritja më e ndjeshme ka ardhur kryesisht nga rritja e rendimentit.

Pemëtaria, si nga numri i tyre, rendimenti për rrënjë e prodhimi nuk ka ecur mirë; në të kundërtën, këta tregues kanë ardhur në rënie. Kështu, ndërsa në vitin 1975 kishte 28615 pemë në prodhim me një rendiment 5.8 kg për rrënjë dhe prodhim 1862 kv, në vitin 1985 këta tregues ishin përkatësisht 30660 rrënjë 2.8 kg për rrënjë dhe 874 kv!

Në përgjithësi, ka pasur një rritje nga njëri vit në tjetrin në treguesit e blegtorisë, si në numrin e krerëve, të rendimentit e të prodhimit të qumështit, mishit, leshit e vezëve.

Numri i lopëve është dyfishuar gjatë këtyre viteve, nga 213 më 1975 në 436 në vitin 1985, delet janë rritur 1.2 herë, dhitë 3.8 herë.

Pozitiv është fakti që bashkë me numrin e krerëve është rritur edhe rendimenti i tyre: qumësht nga një lopë nga 1277 kg më 1975 në 1931 kg më 1985 ose 51 për qind më shumë, qumësht nga një dele, nga 20 kg në 48 kg, 2.4 herë më shumë, qumësht nga një dhi, nga 71 kg, në 101 kg ose 42 për qind. Si rrjedhojë e rritjes së dy treguesve, numrit dhe rendimentit, është rritur edhe prodhimi i qumështit, nga 3381 kv më 1975, në 12029 kv më 1985 ose 3.5 herë.

Po kështu, me ritme të shpejta është rritur edhe prodhimi i mishit, nga 425 kv, në rreth 1500 kv ose 3.5 herë si dhe i leshit, nga 21 kv në 55 kv ose 2.6 herë. Ndërsa në prodhimin e vezëve ka pasur rënie, që ka ardhur për rënie të numrit të krerëve dhe të rendimentit për krerë.

Disa tregues kryesorë të NB-së së Krumës për vitet 1975-1985

Emërtimi	1975	1976	1977	1978	1979	1980	1981	1982	1983	1984	1985
Nr. i familjeve	560	590	795	938	1080	1100	1300	1350	1072	1350	1411
Nr. i banorëve	4460	4700	4912	6590	6830	6940	6982	7200	7544	8600	8819
-Moshë pune	1527	1724	2028	3031	2935	2970	2625	2700	2529	2600	2913
Punonjës gjith.	1490	1555	1730	2092	2210	2185	2237	2335	2353	2382	2459
-Punëtorë	1380	1456	1625	1980	2097	2071	2122	2219	2234	2260	2339
Fondi i pagës ⁱⁱ	8770	9027	1007	11676	11672	11634	11936	12853	12969	11893	12974
Nr. i sektorëve	6	6	6	7	6	7	7	7	7	6	7
Nr. i brigadave	34	38	41	48	47	50	54	58	63	52	55
-Të arave	22	24	26	27	29	24	23	24	23	16	18
Të ardhura	8806	8416	11224	11248	13689	9807	10804	12240	12370	11140	10560
Shpenzime	12276	12015	16052	15854	18014	18312	18300	21579	21502	21757	21160
Humbja	2999	3274	5411	3748	2301	5184	4231	5415	7129	7931	8716
Dëmet ⁱⁱⁱ	340	624	324	684	690	1266	739	827	1122	489	1319
Investimet	1570	1690	1718	3679	5160	7267	5792	5184	4880	5386	5494
Kimikate, kv	14810	14750	17630	16300	22700	17737	18036	23609	22570	22070	17342
Mekaniz u/ha	52428	42444	52285	56872	61251	62100	66169	79275	65752	45700	51427
Trakt. 15 kf, c	241	240	191	191	180	202	203	217	198	193	185
-Me goma	49	46	57	57	57	57	57	57	56	53	56
Kombajna	4	4	5	9	9	11	11	11	13	13	13
P.P.Bujqësor ^{iv}	10112	13372	11866	13143	16133	14162	14698	16539	17070	17000	15975
-Bimët e arave	8223	10577	9793	10434	12781	9688	10530	12551	11743	11626	10584
-Pemëtaria	459	767	129	382	291	1281	685	964	1273	932	829
-Blegësoria	1429	2028	1944	2327	2695	3193	3484	3224	4053	4441	4562
Tokë,30.6,ha	3527	3556	3711	3747	3720	3700	3721	3754	3775	3783	3779
-Arë	3227	3245	3388	3410	3366	3342	3352	3358	3329	3332	3315
-Pemëtores	285	285	297	311	316	319	321	341	365	385	398
-Vreshta	15	26	26	26	38	39	48	55	61	66	66
Toka të reja, ha	53	40	83	26	45	15	21	23	48	3	23
l.Drithëra,ha	2556	2436	2473	2395	2754	2505	2247	2323	2095	1793	2022
-Korrur, ha	2200	2314	2473	2395	2754	2437	2212	2298	1928	1641	1862
-Rend.kv/ha	13.7	15.6	13.6	16.1	17.4	13.3	16.6	16.9	20.3	24.2	15.2
-Prodhimi, kv	30197	36174	33583	38991	47877	32518	36635	38655	39260	39798	28308
a.Grurë,ha	1499	1599	1618	1694	1951	1591	1352	1542	1250	783	1051
-Korrur,ha	1466	1563	1615	1694	1951	1568	1327	1542	1083	783	1051
-Rend.kv/ha	14.2	15.1	14.1	16.1	14.6	13.6	14.0	13.2	16.1	21.1	14.3
-Prodhimi kv	20825	23670	22847	28150	28604	21386	18607	20372	17426	16499	14980
b.Thekër, ha	53	16	10	31	20	12	10	81	85	185	285
-Korrur,ha	53	16	8	31	20	12	8	68	85	185	285
-Rend.,kv/ha	14.4	9.4	17.5	9.0	8.3	10.2	6.5	6.5	10.2	11.6	5.9
-Prodhimi kv	763	158	143	280	165	133	43	444	866	2149	1676
c.Misër,ha	1004	735	848	670	783	912	885	700	760	825	686
-Korrur,ha	681	735	848	670	783	857	877	688	760	673	526
-Rend., kv/ha	12.6	16.8	12.5	15.2	24.4	12.8	20.4	25.9	27.6	31.4	22.3
-Prodhimi,kv	8609	12345	10593	10361	19108	10999	17985	17838	20967	21150	11572
2. Patate, ha	10	16	15	20	15	21	20	20	20	30	55
-Rend.,kv/ha	50	120	77	26	155	63	122	121	97	87	40
-Prodhimi kv	510	1915	1161	919	2328	1328	2444	2424	1938	2610	2203

2) Fondi i pagave, të ardhurat, shpenzimet, humbja, dëmet, investimet, prodhimi bujqësor janë në mijë lekë.

3) Dëmet nga fuqi madhore, të cilat rimbursoheshin nga sigurimet shtetërore.

4) Prodhimi i Përgjithshëm Bujqësor.

Emërtimi	1975	1976	1977	1978	1979	1980	1981	1982	1983	1984	1985
3.Perime,ha	37	36	41	44	51	40	49	50	58	50	50
-Rend,kv/ha	54	68	90	56	84	70	89	123	113	137	147
-Prodhimi kv	1842	2450	3640	2463	4294	2813	4370	6154	6633	6833	7368
4.Tagj.foragj.ha	350	352	394	401	351	536	756	729	1131	1029	956
-Rend.kv/ha	27	72	43	45	59	68	51	54	37	58	77
-Prodhimi,kv	947	2452	1694	1804	2083	3654	3876	3907	4185	5969	7338
5.Pemë, rrënjë	46716	52275	52950	54482	56598	56970	58460	61956	70696	81276	66933
-Në prodhim	28615	28615	28728	29119	27130	26370	26817	28000	31000	37000	30660
-Rend.kg/rrënjë	5.8	1.6	1.4	2.2	0.2	13.4	0.7	4.0	11.0	2.4	2.8
-Prodhimi,kv	1682	465	404	642	487	3534	200	1133	3451	883	874
6.Krerë											
Gjedhë	853	901	911	940	1085	1175	1349	1377	1364	1390	1537
Lopë ^v	213	290	304	307	314	347	395	411	408	418	436
Të leshta	1495	1756	2016	2043	2300	2453	2550	2555	2831	3198	3145
-Dele	1060	1222	1295	1295	1441	1602	1661	1890	1907	2080	2304
Të dhirta	1256	1638	1622	1724	1065	1694	3253	3341	3695	3937	3975
-Dhi	650	911	1075	1045	1198	1322	1778	1999	2087	2279	2476
Shpendë	6023	4164	4042	3995	5161	6253	7558	6268	2744	2020	1533
-Pula	3634	4164	3000	3995	5161	6253	7558	6268	2744	1711	1533
7.Rend.,kg/kr											
Qumësht lope	1277	1250	1340	1271	1504	1697	1301	1157	1492	1901	1931
Qumësht deleje	20	25	26	31	39	36	37	40	49	51	48
Qumësht dhie	71	50	44	49	82	78	79	63	98	92	101
Lesh deleje	1.15	1.33	1.30	2.00	1.60	1.50	1.30	1.49	1.37	1.67	1.48
Vezë, kok/kr	28	51	35	64	85	55	36	32	31	46	25
8.Prodhime											
- Mish, kv	425	501	334	728	650	841	618	814	1053	1289	1499
- Qumësht, kv	3381	4398	4879	4824	6273	7343	7177	6757	9073	11104	12029
- Lesh, kv	21	22	26	45	37	42	39	44	46	54	55
- Vezë,000/k	91	215	96	207	240	105	120	118	63	80	40

5) Numri i krerëve të lopëve foragjere është mesatar vjetor, ndërsa numri i krerëve të deleve dhe të dhive është gjendje në fillim të çdo viti dhe numri i krerëve të të leshtave dhe të dhirtave është gjendje në fund.

STATISTIKA DEMOGRAFIKE NDËRKOMBËTARE

Lista e vendeve sipas numrit të popullsisë në botë

Në tabelën në vijim është një listë e vendeve të renditura sipas madhësisë së popullsisë në botë, nga vendi me popullsi më të madhe te vendi me popullsi më të vogël. Të dhënat e tabelës kanë dalë nga një publikim i Bankës Botërore që mban datën 17 janar 2024.¹⁾ Secili ka mundësi të bëjë vetë krahasimet dhe analizat për ecurinë e popullsisë në botë dhe sipas shteteve, por nga këto të dhëna, në mënyrë të përmbledhur, dalin disa përfundime kryesore.

India është vendi më i populluar në botë, me rreth 1.442 miliardë njerëz nga 1 korriku 2024. India pasohet ngushtë nga Kina, që ka një popullsi prej mbi 1.425 miliardë. Vetëm këto dy vende kanë kaluar mbi një miliard, të tjerat janë nën 500 milionë banorë. Pesë vendet e tjera që kanë një numër banorësh mbi 200 milionë janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Indonezia, Pakistani, Nigeria dhe Brazili.

Selia e Shenjtë (Qyteti i Vatikanit) me 526 banorë është vendi më i vogël në botë, i vetmi vend me një popullsi nën 1 mijë banorë.

Nga fillimi i vitit 2024 vlerësohet që 15 vende kanë një popullsi mbi 100 milionë banorë secili. Prej tyre, 7 janë në Azi, 4 në Afrikë, 2 në Amerikën e Veriut dhe 1 në Europë dhe Amerikën e Jugut. Republika Demokratike e Kongos është vendi më i fundit që e ka kapërcyer 100-milionëshin.

29 vende kanë një popullsi prej më se 50 milionë banorë, ndërsa 94

1) Burimi: World Bank, The World Factbook. Date: 17 janar 2024. UN (World Population Prospects 2022). Countries by population 2024 - StatisticsTimes.com

kanë së paku 10 milionë secili. Pesë vendet e para përbëjnë rreth 46% të popullsisë globale; dhjetë shkojnë mbi 57%. Njëzet vendet e para arrijnë rreth 70%. 105 vendet/territoret më të vogla kontribuojnë vetëm me 1 % të popullsisë globale dhe 177 të renditura më ulët përbëjnë vetëm 10 % të popullsisë botërore gjithsej.

India do të jetë kontribuesi më i madh i rritjes së popullsisë botërore gjithsej më 2024. India llogaritet për 17.81 për qind të rritjes globale gjithsej. Popullsia indiane vlerësohet të rritet me 13.09 milionë, pasuar nga Nigeria me 5.35 milionë. Me 4.72 milionë, 3.36 milionë dhe 3.19 milionë Pakistani, RD e Kongos dhe Etiopia, janë përkatësisht kontribuesit më të mëdhenj për rritjen neto të popullsisë.²

Nga 237 vende/territore të projektuara nga Kombet e Bashkuara, popullsia e 45 vendeve do të vijë në ulje më 2024 krahasuar me 2023. Ulja e kombinuar e popullsisë e këtyre 45 rajoneve është 3,881,415. Këto 45 vende/territore llogariten për 25.87% të popullsisë globale. Polonia mund të regjistrojë rënien më të thellë të popullsisë me 804 mijë, pasuar nga Japonia, Kina, Federata Ruse dhe Rumania me rënie prej mbi 200 mijë secila.

Azia është kontinenti më i populluar në botë, me 4.64 miliardë njerëz, llogaritur për rreth 60% të popullsisë botërore nga viti 2020. Afrika është kontinenti i dytë më i madh, me rreth 1.34 miliardë njerëz, ose 17% të popullsisë botërore. Vetëm këto dy kontinente kanë kapërcyer kufirin prej një miliard. Azia dhe Afrika së bashku zënë rreth 77% të popullsisë globale.

Lista e vendeve sipas popullsisë në botë

Nr.	Vendet (dhe territoret)	Popullsia		%	Ndryshimi	
		2023	2024		Popullsia	Në %
1.	India	1,428,627,663	1,441,719,852	17.8	13,092,189	0.92
2.	Kina	1,425,671,352	1,425,178,782	17.6	-492,570	-0.03
3.	SHBA-ja	339,996,563	341,814,420	4.21	1,817,857	0.53
4.	Indonezia	277,534,122	279,798,049	3.45	2,263,927	0.82
5.	Pakistani	240,485,658	245,209,815	3.02	4,724,157	1.96
6.	Nigeria	223,804,632	229,152,217	2.82	5,347,585	2.39
7.	Brazili	216,422,446	217,637,297	2.68	1,214,851	0.56
8.	Bangladeshi	172,954,319	174,701,211	2.15	1,746,892	1.01

2) <https://statisticstimes.com/demographics/countries-by-population.php>

Nr.	Vendet (dhe territoret)	Popullsia		%	Ndryshimi	
		2023	2024		Popullsia	Në %
9.	Rusia	144,444,359	143,957,079	1.77	-487,280	-0.34
10.	Meksika	126,527,060	129,719,719	1.60	3,192,659	2.52
11.	Etiopia	128,455,567	129,388,467	1.59	932,900	0.73
12.	Japonia	123,294,513	122,631,432	1.51	-663,081	-0.54
13.	Filipinet	117,337,368	119,106,224	1.47	1,768,856	1.51
14.	Egjypti	112,716,598	114,484,252	1.41	1,767,654	1.57
15.	RD e Kongos	102,262,808	105,625,114	1.30	3,362,306	3.29
16.	Vietnami	98,858,950	99,497,680	1.23	638,730	0.65
17.	Irani	89,172,767	89,809,781	1.11	637,014	0.71
18.	Turqia	85,816,199	86,260,417	1.06	444,218	0.52
19.	Gjermania	83,294,633	83,252,474	1.03	-42,159	-0.05
20.	Tajlanda	71,801,279	71,885,799	0.885	84,520	0.12
21.	Tanzania	67,438,106	69,419,073	0.855	1,980,967	2.94
22.	Britania e Madhe	67,736,802	67,961,439	0.837	224,637	0.33
23.	Franca	64,756,584	64,881,830	0.799	125,246	0.19
24.	Afrika e Jugut	60,414,495	61,020,221	0.752	605,726	1.00
25.	Italia	58,870,762	58,697,744	0.723	-173,018	-0.29
26.	Kenia	55,100,586	56,203,030	0.692	1,102,444	2.00
27.	Mianmari	54,577,997	54,964,694	0.677	386,697	0.71
28.	Kolumbia	52,085,168	52,340,774	0.645	255,606	0.49
29.	Rep. e Koresë	51,784,059	51,741,963	0.637	-42,096	-0.08
30.	Uganda	48,582,334	49,924,252	0.615	1,341,918	2.76
31.	Sudani	48,109,006	49,358,228	0.608	1,249,222	2.60
32.	Spanja	47,519,628	47,473,373	0.585	-46,255	-0.10
33.	Argjentina	45,504,560	46,523,657	0.573	1,019,097	2.24
34.	Algjeria	45,606,480	46,278,751	0.570	672,271	1.47
35.	Iraku	45,773,884	46,057,866	0.567	283,982	0.62
36.	Afganistani	42,239,854	43,372,950	0.534	1,133,096	2.68
37.	Polonia	41,026,067	40,221,726	0.495	-804,341	-1.96
38.	Kanadaja	38,781,291	39,107,046	0.482	325,755	0.84
39.	Maroku	37,840,044	38,211,459	0.471	371,415	0.98
40.	Ukraina	36,744,634	37,937,821	0.467	1,193,187	3.25
41.	Angola	36,684,202	37,804,634	0.466	1,120,432	3.05

Nr.	Vendet (dhe territoret)	Popullsia		%	Ndryshimi	
		2023	2024		Popullsia	Në %
42.	Arabia Saudite	36,947,025	37,473,929	0.462	526,904	1.43
43.	Uzbekistani	35,163,944	35,673,804	0.439	509,860	1.45
44.	Jemeni	34,449,825	35,219,853	0.434	770,028	2.24
45.	Peruja	33,897,354	34,858,402	0.429	961,048	2.84
46.	Malajzia	34,121,985	34,777,522	0.428	655,537	1.92
47.	Gana	34,352,719	34,683,444	0.427	330,725	0.96
48.	Mozambiku	34,308,525	34,671,895	0.427	363,370	1.06
49.	Nepali	30,896,590	31,240,315	0.385	343,725	1.11
50.	Madagaskari	30,325,732	31,056,610	0.383	730,878	2.41
51.	Bregu i Fildishtë	28,873,034	29,603,302	0.365	730,268	2.53
52.	Venezuela	28,838,499	29,395,334	0.362	556,835	1.93
53.	Kameruni	28,647,293	29,394,433	0.362	747,140	2.61
54.	Nigeria	27,202,843	28,238,972	0.348	1,036,129	3.81
55.	Australia	26,439,111	26,699,482	0.329	260,371	0.98
56.	Koreja e Veriut	26,160,821	26,244,582	0.323	83,761	0.32
57.	Tajvani	23,227,014	24,348,053	0.300	1,121,039	4.83
58.	Mali	23,293,698	24,015,789	0.296	722,091	3.10
59.	Burkina Faso	23,923,276	23,950,214	0.295	26,938	0.11
60.	Siria	23,251,485	23,840,247	0.294	588,762	2.53
61.	Sri Lanka	21,893,579	21,949,268	0.270	55,689	0.25
62.	Malavi	20,931,751	21,475,962	0.265	544,211	2.60
63.	Zambia	20,569,737	21,134,695	0.260	564,958	2.75
64.	Rumania	19,606,633	19,828,165	0.244	221,532	1.13
65.	Kili	19,629,590	19,658,839	0.242	29,249	0.15
66.	Kazakistani	19,892,812	19,618,996	0.242	-273,816	-1.38
67.	Çadi	18,278,568	18,847,148	0.232	568,580	3.11
68.	Ekuadori	18,143,378	18,706,922	0.230	563,544	3.11
69.	Somalia	18,190,484	18,377,367	0.226	186,883	1.03
70.	Guatemala	18,092,026	18,358,430	0.226	266,404	1.47
71.	Senegali	17,763,163	18,221,567	0.224	458,404	2.58
72.	Holanda	17,618,299	17,671,125	0.218	52,826	0.30
73.	Kamboxhia	16,944,826	17,121,847	0.211	177,021	1.04
74.	Zimbabve	16,665,409	17,020,321	0.210	354,912	2.13
75.	Guineja	14,190,612	14,528,770	0.179	338,158	2.38

Nr.	Vendet (dhe territoret)	Popullsia		%	Ndryshimi	
		2023	2024		Popullsia	Në %
76.	Ruanda	14,094,683	14,414,910	0.178	320,227	2.27
77.	Benini	13,712,828	14,080,072	0.173	367,244	2.68
78.	Burundi	13,238,559	13,591,657	0.167	353,098	2.67
79.	Bolivia	12,388,571	12,567,336	0.155	178,765	1.44
80.	Tunizia	12,458,223	12,564,689	0.155	106,466	0.85
81.	Haiti	11,724,763	11,867,030	0.146	142,267	1.21
82.	Belgjika	11,686,140	11,715,774	0.144	29,634	0.25
83.	Rep. Dominikane	11,332,972	11,434,005	0.141	101,033	0.89
84.	Jordania	11,337,052	11,384,922	0.140	47,870	0.42
85.	Sudani i Jugut	11,088,796	11,277,092	0.139	188,296	1.70
86.	Kuba	11,194,449	11,174,587	0.138	-19,862	-0.18
87.	Hondurasi	10,593,798	10,759,406	0.133	165,608	1.56
88.	Suedia	10,612,086	10,673,669	0.131	61,583	0.58
89.	Papua Guineja e re	10,329,931	10,515,788	0.130	185,857	1.80
90.	Çekia	10,495,295	10,503,734	0.129	8,439	0.08
91.	Azerbajxhani	10,412,651	10,462,904	0.129	50,253	0.48
92.	Taxhikistani	10,143,543	10,331,513	0.127	187,970	1.85
93.	Greqia	10,341,277	10,302,720	0.127	-38,557	-0.37
94.	Portugalia	10,247,605	10,223,349	0.126	-24,256	-0.24
95.	Hungaria	10,156,239	9,994,993	0.123	-161,246	-1.59
96.	Emiratet e Bashk. Arabe	9,516,871	9,591,853	0.118	74,982	0.79
97.	Bjellorusia	9,498,238	9,455,037	0.116	-43,201	-0.45
98.	Izraeli	9,174,520	9,311,652	0.115	137,132	1.49
99.	Togoja	9,053,799	9,260,864	0.114	207,065	2.29
100.	Sierra Leone	8,791,092	8,977,972	0.111	186,880	2.13
101.	Austria	8,958,960	8,977,139	0.111	18,179	0.20
102.	Zvicra	8,796,669	8,851,431	0.109	54,762	0.62
103.	Laosi	7,633,779	7,736,681	0.0953	102,902	1.35
104.	Hong Kongu	7,491,609	7,496,681	0.0923	5,072	0.07
105.	Nikaragua	7,046,310	7,142,529	0.0880	96,219	1.37
106.	Serbia	7,149,077	7,097,028	0.0874	-52,049	-0.73

Nr.	Vendet (dhe territoret)	Popullsia		%	Ndryshimi	
		2023	2024		Popullsia	Në %
107.	Libia	6,888,388	6,964,197	0.0858	75,809	1.10
108.	Paraguai	6,861,524	6,947,270	0.0856	85,746	1.25
109.	Kirgistani	6,735,347	6,839,606	0.0842	104,259	1.55
110.	Bullgaria	6,687,717	6,618,615	0.0815	-69,102	-1.03
111.	Turkmenia	6,516,100	6,598,071	0.0813	81,971	1.26
112.	El Salvadori	6,364,943	6,396,289	0.0788	31,346	0.49
113.	Kongoja	6,106,869	6,244,547	0.0769	137,678	2.25
114.	Singapori	6,014,723	6,052,709	0.0746	37,986	0.63
115.	Danimarka	5,910,913	5,939,695	0.0732	28,782	0.49
116.	Rep. Afrikane Qendrore	5,742,315	5,915,627	0.0729	173,312	3.02
117.	Sllovakia	5,795,199	5,702,832	0.0702	-92,367	-1.59
118.	Finlanda	5,545,475	5,549,886	0.0684	4,411	0.08
119.	Liberia	5,418,377	5,536,949	0.0682	118,572	2.19
120.	Norvegjia	5,474,360	5,514,477	0.0679	40,117	0.73
121.	Palestina	5,371,230	5,494,963	0.0677	123,733	2.30
122.	Zelanda e Re	5,228,100	5,269,939	0.0649	41,839	0.80
123.	Kosta Rika	5,212,173	5,246,714	0.0646	34,541	0.66
124.	Libani	5,353,930	5,219,044	0.0643	-134,886	-2.52
125.	Irlanda	5,056,935	5,089,478	0.0627	32,543	0.64
126.	Mauritania	4,862,989	4,993,922	0.0615	130,933	2.69
127.	Omani	4,644,384	4,713,553	0.0581	69,169	1.49
128.	Panamaja	4,468,087	4,527,961	0.0558	59,874	1.34
129.	Kuvajti	4,310,108	4,349,380	0.0536	39,272	0.91
130.	Kroacia	4,008,617	3,986,627	0.0491	-21,990	-0.55
131.	Eritreja	3,748,901	3,817,651	0.0470	68,750	1.83
132.	Gjeorgjia	3,728,282	3,717,425	0.0458	-10,857	-0.29
133.	Mongolia	3,447,157	3,493,629	0.0430	46,472	1.35
134.	Uruguai	3,423,108	3,423,316	0.0422	208	0.01
135.	Moldavia	3,435,931	3,329,865	0.0410	-106,066	-3.09
136.	Porto-Rikoja	3,260,314	3,268,802	0.0403	8,488	0.26
137.	Bosnja dhe Hercegovina	3,210,847	3,194,378	0.0393	-16,469	-0.51
138.	Gambia	2,773,168	2,841,803	0.0350	68,635	2.47

Nr.	Vendet (dhe territoret)	Popullsia		%	Ndryshimi	
		2023	2024		Popullsia	Në %
139.	Shqipëria	2,832,439	2,826,020	0.0348	-6,419	-0.23
140.	Xhamajka	2,825,544	2,824,738	0.0348	-806	-0.03
141.	Armenia	2,777,970	2,777,979	0.0342	9	0.00
142.	Katari	2,716,391	2,737,061	0.0337	20,670	0.76
143.	Botsvana	2,675,352	2,719,694	0.0335	44,342	1.66
144.	Lituania	2,718,352	2,692,798	0.0332	-25,554	-0.94
145.	Namibia	2,604,172	2,645,805	0.0326	41,633	1.60
146.	Gaboni	2,436,566	2,484,557	0.0306	47,991	1.97
147.	Lezotoja	2,330,318	2,356,083	0.0290	25,765	1.11
148.	Guineja-Bisau	2,150,842	2,197,149	0.0271	46,307	2.15
149.	Sllovenia	2,119,675	2,118,965	0.0261	-710	-0.03
150.	Maqedonia e Veriut	2,085,679	2,082,706	0.0257	-2,973	-0.14
151.	Letonia	1,830,211	1,810,240	0.0223	-19,971	-1.09
152.	Guineja Ekuatoriale	1,714,671	1,754,993	0.0216	40,322	2.35
153.	Kosova ⁱⁱⁱ	1,663,594	1,667,483	0.0205	3,889	0.23
154.	Trinidad dhe Tabakoja	1,534,937	1,538,200	0.0189	3,263	0.21
155.	Bahrejni	1,485,509	1,498,712	0.0185	13,203	0.89
156.	Timori Lindor	1,360,596	1,379,883	0.0170	19,287	1.42
157.	Estonia	1,322,765	1,319,041	0.0162	-3,724	-0.28
158.	Mauritius	1,300,557	1,301,978	0.0160	1,421	0.11
159.	Qiproja	1,260,138	1,268,467	0.0156	8,329	0.66
160.	Esvatini	1,210,822	1,222,075	0.0151	11,253	0.93
161.	Xhibuti	1,136,455	1,152,329	0.0142	15,874	1.40
162.	Reunion	981,796	989,350	0.0122	7,554	0.77
163.	Fixhi	936,375	943,072	0.0116	6,697	0.72
164.	Komoros	852,075	867,605	0.0107	15,530	1.82
165.	Guyana	813,834	819,594	0.0101	5,760	0.71
166.	Butani	787,424	792,382	0.00976	4,958	0.63
167.	Ishujt Solomon	740,424	756,673	0.00932	16,249	2.19

3) Under UNSC res. 1244.

Nr.	Vendet (dhe territoret)	Popullsia		%	Ndryshimi	
		2023	2024		Popullsia	Në %
168.	Makaoja	704,149	713,082	0.00878	8,933	1.27
169.	Luksemburgu	654,768	661,594	0.00815	6,826	1.04
170.	Surinami	623,236	628,785	0.00774	5,549	0.89
171.	Mali i Zi	626,485	626,102	0.00771	-383	-0.06
172.	Kepi i Gjellbër	598,682	604,461	0.00745	5,779	0.97
173.	Saharaja Perëndimore	587,259	598,385	0.00737	11,126	1.89
174.	Malta	535,064	536,740	0.00661	1,676	0.31
175.	Maldivet	521,021	517,887	0.00638	-3,134	-0.60
176.	Brunei	452,524	455,858	0.00561	3,334	0.74
177.	Belize	410,825	416,656	0.00513	5,831	1.42
178.	Bahamasi	412,623	415,223	0.00511	2,600	0.63
179.	Guadalupe	395,839	396,346	0.00488	507	0.13
180.	Islanda	375,318	377,689	0.00465	2,371	0.63
181.	Martinike	366,981	366,416	0.00451	-565	-0.15
182.	Majote	335,995	345,996	0.00426	10,001	2.98
183.	Vanuatu	334,506	342,325	0.00422	7,819	2.34
184.	Guiana Franceze	312,155	319,796	0.00394	7,641	2.45
185.	Polinezia Franceze	308,872	311,383	0.00384	2,511	0.81
186.	Kaledonia e re	292,991	295,966	0.00365	2,975	1.02
187.	Barbadosi	281,995	282,309	0.00348	314	0.11
188.	Sao-Tome-e- Principe	231,856	236,381	0.00291	4,525	1.95
189.	Samoa	225,681	228,966	0.00282	3,285	1.46
190.	Kuraçao	192,077	192,965	0.00238	888	0.46
191.	Shën Luçia	180,251	180,805	0.00223	554	0.31
192.	Guami	172,952	174,114	0.00214	1,162	0.67
193.	Kiribati	133,515	135,763	0.00167	2,248	1.68
194.	Grenada	126,183	126,887	0.00156	704	0.56
195.	Mikronezia	115,224	116,300	0.00143	1,076	0.93
196.	Xhersej	111,802	112,843	0.00139	1,041	0.93

Nr.	Vendet (dhe territoret)	Popullsia		%	Ndryshimi	
		2023	2024		Popullsia	Në %
197.	Tonga	107,773	108,683	0.00134	910	0.84
198.	Sejshelles	107,660	108,263	0.00133	603	0.56
199.	Aruba	106,277	106,177	0.00131	-100	-0.09
200.	Saint Vinsent dhe Grenadines	103,698	103,683	0.00128	-15	-0.01
201.	Ishujt Virxhin të US	98,750	98,055	0.00121	-695	-0.70
202.	Antigua dhe Barbuda	94,298	94,816	0.00117	518	0.55
203.	Ishulli i Njeriut	84,710	84,904	0.00105	194	0.23
204.	Andora	80,088	80,341	0.00099	253	0.32
205.	Dominicia	73,040	73,368	0.00090	328	0.45
206.	Ishujt Kajman	69,310	69,885	0.00086	575	0.83
207.	Bermuda	64,069	63,935	0.00079	-134	-0.21
208.	Guernsej	63,544	63,788	0.00079	244	0.38
209.	Grinland	56,643	56,789	0.00070	146	0.26
210.	Ishujt Faroe	53,270	53,444	0.00066	174	0.33
211.	Ishujt Veriorë Mariana	49,796	50,025	0.00062	229	0.46
212.	Saint Kitts dhe Nevis.	47,755	47,847	0.00059	92	0.19
213.	Ishujt Turks dhe Kaicos	46,062	46,431	0.00057	369	0.80
214.	Sint Marten (Holandeze)	44,222	44,309	0.00055	87	0.20
215.	Samoa Amerikane	43,914	43,544	0.00054	-370	-0.84
216.	Ishujt Marshall	41,996	42,415	0.00052	419	1.00
217.	Lihtenshtajni	39,584	39,822	0.00049	238	0.60
218.	Monakoja	36,297	36,157	0.00045	-140	-0.39
219.	San Marinoja	33,642	33,614	0.00041	-28	-0.08
220.	Gjibraltari	32,688	32,718	0.00040	30	0.09
221.	Shën Martin (Pjesa franceze)	32,077	32,337	0.00040	260	0.81
222.	Ishujt Britanikë Virxhin	31,538	31,763	0.00039	225	0.71
223.	Bonaire etj.	27,148	27,272	0.00034	124	0.46
224.	Palau	18,058	18,051	0.00022	-7	-0.04
225.	Ishujt Kook	17,044	17,072	0.00021	28	0.16
226.	Anguilla	15,899	15,936	0.00020	37	0.23
227.	Nauru	12,780	12,884	0.00016	104	0.81

Nr.	Vendet (dhe territoret)	Popullsia		%	Ndryshimi	
		2023	2024		Popullsia	Në %
228.	Tuvalu	11,396	11,478	0.00014	82	0.72
229.	Ishujt Vallis dhe Futuna	11,502	11,439	0.00014	-63	-0.55
230.	Shën Barthelemy	10,994	11,019	0.00014	25	0.23
231.	Shën Pierr dhe Miquelon	5,840	5,815	0.00007	-25	-0.43
232.	Shën Helena	5,314	5,253	0.00006	-61	-1.15
233.	Montserrat	4,386	4,372	0.00005	-14	-0.32
234.	Ishujt Falkland	3,791	3,803	0.00005	12	0.32
235.	Niue	1,935	1,935	0.00002	0	0.00
236.	Tokelau	1,893	1,915	0.00002	22	1.16
237.	Vatikani	518	526	0.00001	8	1.54
	Bota	8,045,311,447	8,118,835,999		73,524,552	0.91

KRITERET PËR BOTIME NË REVISTËN “STUDIME DEMOGRAFIKE”

Të nderuar bashkëpunëtorë,

Në përputhje me programin e Qendrës për Studime Demografike, temat që trajton revista janë kryesisht të karakterit demografik, social dhe ekonomik, si: rritja e popullsisë, migracioni dhe remitancat, statistikat jetësore, familja, mirëqenia dhe varfëria, punësimi dhe papunësia, të ardhurat dhe pabarazia, zhvillimi i qëndrueshëm, mjedisi etj.

Me qëllim që të ruajmë cilësinë shkencore të revistës, redaksia u rekomandon autorëve që të përgatisin artikuj për botim duke iu përmbajtur kriterëve që vijojnë:

1. Artikulli duhet të jetë fryt i punës së autorëve, duke përdorur të dhëna nga publikimet më të fundit apo nga pyetësorë dhe teknika të tjera, që i kryejnë apo drejtojnë vetë.
2. Artikulli duhet të respektojë rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, përfshirë përdorimin e shkronjave ë dhe ç.
3. Artikulli duhet të ketë një strukturë standarde: hyrje, analiza në kapituj dhe nënkapituj dhe në mbyllje përfundimet dhe rekomandimet.
4. Artikulli të shkruhet në MSWord, nga 8 deri në 14 faqe A4, me Times New Roman, p.p. 12, me largësi 1 midis rreshtave, në vartësi me numrin e tabelave dhe grafikëve.
5. Artikulli duhet të përmbajë një përmbledhje (*abstract*) në gjuhën angleze, nga 200-250 fjalë dhe me 5-6 fjalë kyçe (*key words*).

6. Footnotes duhet të jenë pp 10, duke cituar më parë emrin dhe pastaj mbiemrin e autorit.

7. Referencat apo literatura që përdoret për përgatitjen e artikullit të përmbajë më parë mbiemrin dhe pas emrin e autorit.

8. Artikulli i nënshtrohet më parë një shqyrtimi nga anëtarë të redaksisë që janë specialistë të fushës përkatëse. Rekomandimet e tyre me shkrim do të mbahen parasysh në vendimin që do të marrë redaksia e revistës.

9. Artikujt të dërgohen në adresën e e-mail-it: **lshahollari@yahoo.com**.

10. Artikujt e revistës “Studime Demografike” mund të lexohen online në sitin **www.revistademografia.al**

11. Studiuesit e ndryshëm mund të përdorin të dhëna nga revista në punimet e tyre, por duke përmendur burimin e këtyre të dhënave.

Redaksia e revistës “Studime Demografike”